



BANKA QENDRORE E REPUBLIKES SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti i Stabilitetit Financiar

Numër 21

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti i Stabilitetit Financiar

Numër 21

Janar-Dhjetor 2024

BOTUES

© Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe Analizave Ekonomike
33 Garibaldi, Prishtinë 10000
Tel: +383 38 222 055
Fax: +383 38 243 763

Faqja e internetit

www.bqk-kos.org

Adresa elektronike

economic.analysis@bqk-kos.org

KRYEREDAKTOR

Zana GJOCAJ

REDAKTORË

Krenare MALOKU BAKIJA
Bejtush KIÇMARI

AUTORË

Arta NUSHI
Arta HASHIMI
Taulant SYLA
Tringa NIKA
Blerta HYSENI
Albion MAZREKU
Shqipe ÇERKINI GRAINCA

REDAKTOR TEKNIK

Butrint BOJAJ

SHKURTESAT:

AJN	Asetet e Jashtme Neto
APR	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATM	Bankomatë (<i>anglisht: Automated Teller Machines</i>)
ATP	Agjensionet për Transferimin e Parave
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQE	Banka Qendrore Evropiane
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
FKPK	Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
FKGK	Fondi Kosovar për Garanci Kreditore
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IMF	Institucionet Mikro-Financiare
KJP	Kreditë jo-performuese
KMA	Kthimi Mesatar në Asete
KMK	Kthimi Mesatar në Kapital
KTD	Korporatat Tjera Depozituese
MFPT	Ministria e Financave Punës dhe Transfereve
MNI	Margjina Neto e Interesit
POS	Pika të Shitjes (<i>anglisht: Point of Sales</i>)
pp	Pikë Përqindje
PPT	Përgjegjësia ndaj Palës së Tretë
TMK	Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Vërejtje:

Përdoruesit e këtyre të dhënave kërkohen të citojnë burimin.
Citimi i sugjeruar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (2025),
Raporti i Stabilitetit Financiar Nr. 21, Prishtinë.
Çdo korrigjim i nevojshëm bëhet në versionin elektronik.

Përmbajtja:

1. Fjala hyrëse e Guvernatorit -----	8
Kutia 1. Harta e Stabilitetit Financiar -----	11
3. Mjedisi i jashtëm dhe zhvillimet në ekonominë e brendshme -----	13
3.1 Ekonomia e brendshme-----	15
3.2. Pozicioni financiar i ndërmarrjeve -----	17
3.3. Pozicioni financiar i ekonomive familjare -----	18
4. Zhvillimet në sistemin financiar -----	20
4.1. Sektori bankar -----	23
Kutia 2. Ngarkesa me Borxh e huamarrësve individual në Kosovë-----	25
Kutia 3. Anketa e Kreditimit Bankar të Kosovës -----	33
5. Rreziqet e sektorit bankar -----	37
5.1. Rreziku kreditor -----	37
5.2. Qëndrueshmëria e profitit dhe rreziku i normave të interesit -----	39
5.3. Rreziku nga pozicioni në valuta të huaja -----	42
5.4. Qëndrueshmëria e sektorit - Kapitali-----	43
5.5. Financimi dhe Rreziku i Likuiditetit -----	46
Stress-test makrofinanciar për rrezikun kreditor -----	50
Stress Test për Rrezikun e Likuiditetit -----	60
Kutia 4. Mekanizmi i Korrigjimit të Kufirit të Karbonit (ang. CBAM): Ndikimet në Ekonominë e Kosovës dhe Stabilitetin e Sektorit Bankar -----	65
6. Institucionet financiare jo-bankare -----	68
6.1 Sektori Pensional-----	68
6.2 Sektori i Sigurimeve-----	69
7. Infrastruktura financiare në Kosovë-----	75
7.1. Sistemi i pagesave -----	75
8. Shtojca Statistikore -----	77

LISTA E GRAFIKËVE DHE FIGURAVE

Grafik 1. Indekset e luhatshmërisë në tregjet financiare -----	13
Grafik 2. Norma e rritjes së BPV-së reale dhe kontribuesit në rritje-----	15
Grafik 3. Inflacioni sipas origjinës dhe inflacioni bazë -----	16
Grafik 4. Ndryshimi vjetor në numrin e ndërmarrjeve të reja -----	17
Grafik 5. Borxhi i ndërmarrjeve -----	17
Grafik 6. Normat e interesit për ndërmarrjet -----	18
Grafik 7. Borxhi i ekonomive familjare -----	18
Grafik 8. Depozitat e ekonomive familjare -----	18
Grafik 9. Normat e interesit për ekonomitë familjare -----	18
Grafik 10. Peshat e sektorëve të sistemit financiar ndaj BPV-së -----	20
Grafik 11. Pjesëmarrja e sektorëve përkatës në asetet e sistemit financiar-----	20
Grafik 12. Pronësia e sektorëve përbërës të sistemit financiar-----	20
Grafik 13. Pjesëmarrja në strukturën e asetëve-----	23
Grafik 14. Pjesëmarrja në strukturën e detyrimeve dhe burimeve vetanake-----	23
Grafik 15. Stoku i gjithsej depozitave dhe depozitave të reja -----	24
Grafik 16. Pozicioni neto ndaj jo-rezidentëve -----	24
Grafik 17. Kontributi i zërave në ndryshimin vjetor të aktiviteteve me jorezidentët -----	24
Grafik 18. Rritja vjetore e kredive për ndërmarrje dhe ekonomitë familjare -----	31
Grafik 19. Stoku i gjithsej kredive dhe kredive të reja për ndërmarrje dhe ekonomitë familjare-----	31
Grafik 20. Stoku i kredive sipas sektorëve të ekonomisë -----	31
Grafik 21. Kreditë a aprovuara dhe të garantuara nga FKGK -----	32
Grafik 22. Kreditë e ndërmarrjeve, pjesëmarrja sipas maturitetit -----	32
Grafik 23. Kreditë e ekonomive familjare, pjesëmarrja sipas maturitetit -----	32
Grafik 24. Rritja vjetore e stokut të kredisë dhe kredive jo-performuese-----	37
Grafik 25. Kreditë sipas kalsifikimit të ri kreditor në tri shtylla-----	37
Grafik 26. Struktura e kredive sipas klasifikimit të vonesave -----	38
Grafik 27. Kreditë joperformuese -----	38
Grafik 28. Raporti i KJP-ve ndaj stokut të kredisë, sipas sektorëve-----	38
Grafik 29. Raporti KJP/gjithsej kreditë në vende të rajonit -----	38
Grafik 30. Ndryshimi vjetor i stokut të KJP-ve dhe mbulueshmëria me provizione -----	39
Grafik 31. Koncentrimi i rrezikut kreditor -----	39
Grafik 32. Struktura e profitit të sektorit bankar -----	40
Grafik 33. Kontribuesit kryesor në rritjen/zvogëlimin e profitit -----	40
Grafik 34. Të hyrat dhe shpenzimet e interesit -----	40
Grafik 35. Të hyrat dhe shpenzimet e jo-interesit-----	40
Grafik 36. Struktura e të hyrave të sektorit bankar -----	41
Grafik 37. Struktura e shpenzimeve të sektorit bankar -----	41
Grafik 38. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar -----	41

Grafik 39. Asetet dhe detyrimet e ndjeshme ndaj normave të interesit -----	42
Grafik 40. Pozicionet e hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë -----	43
Grafik 41. Kreditë dhe depozitat në valutë të huaj-----	43
Grafik 42. Kapitalizimi i sektorit bankar-----	44
Grafik 43. Kontributi i Kapitalit Rregullator dhe APR-ve në Raportin e Kapitalizimit -----	44
Grafik 44. Struktura e kapitalit rregullator -----	44
Grafik 45. Norma e levës -----	44
Grafik 46. Raporti i APR-ve ndaj gjithsej aseteve të sektorit-----	45
Grafik 47. Asetet e peshuara me rrezik kreditor-----	45
Grafik 48. Klasat e aseteve sipas peshës së rrezikut-----	45
Grafik 49. Struktura e APR-ve për rrezik kreditor -----	46
Grafik 50. Struktura e financimit-----	46
Grafik 51. Rritja e kredive dhe depozitave të sektorit bankar -----	47
Grafik 52. Struktura e depozitave-----	47
Grafik 53. Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit -----	47
Grafik 54. Struktura e afateve të maturimit të depozitave dhe kredive -----	47
Grafik 55. Treguesi i Mbulimit me Likuiditet-Liquidity Coverage Ratio (LCR)-----	48
Grafik 56. Indikatorët e likuiditetit -----	48
Grafik 57. Rezervat e likuiditetit -----	49
Grafik 58. Hendeku i likuiditetit -----	49
Grafik 59. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit -----	59
Grafik 60A1. Skenari bazë-Pozicionet ndikuese në nivelin e kapitalit TMK në T1 -----	59
Grafik 60A2. Skenari bazë-Pozicionet ndikuese në nivelin e kapitalit TMK në T1 -----	59
Grafik 61B. Kategoritë kryesore të ndikimit në raportin e kapitalit -----	59
Grafik 62. Treguesi mbulimit me likuiditet -----	64
Grafik 63. Asetet e sektorit pensional-----	68
Grafik 64. Performanca financiare e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës -----	68
Grafik 65. Struktura e investimeve të sektorit pensional -----	68
Grafik 66. Performanca financiare e Fondit Sllloveno-Kosovar të Pensioneve -----	69
Grafik 67. Indikatorët e zhvillimit të sektorit të sigurimeve-----	69
Grafik 68. Struktura e aseteve të sektorit të sigurimeve, sipas pronësisë -----	70
Grafik 69. Asetet e sektorit të sigurimeve -----	70
Grafik 70. Struktura e aseteve ndaj totalit-----	70
Grafik 71. Detyrimet dhe kapitali i sektorit të sigurimeve -----	71
Grafik 72. Primet bruto të arkëtuara -----	71
Grafik 73. Sigurimet e detyrueshme dhe vullnetare -----	71
Grafik 74. Primet e pranuar dhe dëmet e paguara-----	71
Grafik 75. Asetet e sektorit mikrofinanciar -----	72
Grafik 76. Struktura e aseteve të sektorit mikrofinanciar -----	72
Grafik 77. Kreditë e sektorëve ekonomik sipas maturitetit -----	72

Grafik 78. Struktura e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve ekonomik -----	73
Grafik 79. Rritja e kredive të sektorit mikrofinanciar ndaj korporatave jofinanciare-----	73
Grafik 80. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar-----	73
Grafik 81. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar -----	73
Grafik 82. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik-----	74
Grafik 83. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar -----	74
Grafik 84. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar-----	74
Grafik 85. Numri dhe vlera e pagesave të parasë elektronike -----	75
Grafik 86. Numri i llogarive të parave lektronike -----	76
Figura 1. Ndërlidhjet institucionale të Sistemit Financiar të Kosovës-----	22
Figura 2 . Ndërlidhjet bankare të sektorit bankar të Kosovës-----	23

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Borxhi ndaj bankave dhe performanca e ekonomive familjare -----	19
Tabela 2. Numri i institucioneve financiare -----	21
Tabela 3. Projeksionet-skenari bazë dhe skenarët e supozuar hipotetik-skenari i rënduar -----	52
Tabela 4. Skenarët dhe peshat (haircut) të përdorura në secilin skenar për kategoritë kryesore të TML – LCR -----	61
Tabela 5. Skenarët dhe rezultatet përkatëse -----	62
Tabela 6. Pjesëmarrja e instrumenteve të pagesave në gjithsej transaksionet e SPN-së-----	75
Tabela 7. Rrjeti i sektorit bankar-----	76

1. Fjala hyrëse e Guvernatorit

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës prezanton edicionin e 21-të të Raportit të Stabilitetit Financiar (RSF), publikim periodik që ka për synim të ofrojë një vlerësim të balancuar dhe të bazuar në rrezik mbi zhvillimet më të fundit në sistemin financiar të vendit dhe mbi sfidat me të cilat ai përballlet. Raporti kontribuon në përmbushjen e mandatit të BQK-së për ruajtjen e stabilitetit financiar, duke rritur transparencën dhe informimin e publikut, si dhe duke nxitur diskutimin profesional mbi çështje që kanë rëndësi për sistemin financiar dhe ekonominë reale.

Viti 2024 u karakterizua nga një stabilizim i aktivitetit të përgjithshëm ekonomik global, ndërkohë që përshkallëzimi i tensioneve tregtare dhe pasiguritë gjeopolitike kanë cenuar perspektivën për vitin 2025. Në të njëjtën periudhë, ekonomia e Eurozonës shënoi rritje modeste, në një mjedis të brishtë makroekonomik dhe të ekspozuar ndaj rreziqeve të reja - përfshirë tensionet tregtare dhe pasiguritë gjeopolitike, që mund të kenë implikime makrofinanciare si në eurozonë ashtu edhe në rajon. Ngadalësimi i Eurozonës dhe tensionet e vazhdueshme gjeopolitike ndikuan perspektivën e vendeve të Ballkanit Perëndimor, vende që operuan në një mjedis të jashtëm të brishtë dhe me kërkesë të dobësuar.

Në anën tjetër, ekonomia e Kosovës shënoi rritje të qëndrueshme prej 4.4 përqind në vitin 2024, mbështetur kryesisht nga konsumi privat, investimet dhe eksportet, ndërkohë që perspektiva për vitin 2025 mbetet pozitive me rritje rreth potencialit. Sfidat në mjedisin ndërkombëtar të përmendura më lartë paraqesin rreziqe potenciale për ritmin e rritjes dhe mund të ushtrojnë presione shtesë mbi inflacionin dhe balancat makroekonomike.

Gjatë vitit 2024, sistemi financiar në Kosovë vazhdoi të zgjerohej me ritme të larta, duke shënuar rritje më të shpejtë kundrejt rritjes reale të BPV-së. Kjo dinamikë ka ndikuar në rritjen e ndërmjetësimit financiar, duke përforcuar rolin e sistemit financiar në ekonominë e vendit.

Spektori bankar shënoi përsheptim të rritjes gjatë vitit 2024, duke reflektuar perspektivën e mirë makroekonomike në vend dhe kërkesën e qëndrueshme për financim nga ekonomitë familjare dhe bizneset.

Treguesit kryesorë të qëndrueshmërisë financiare mbeten brenda kufijve të kërkesave rregullatore. Rritja e shpejtë e kreditimit paraqet potencial për rritje të mundshme të akumulimit të rreziqeve ciklike, ndërkohë që qëndrueshmëria e sektorit është përforcuar nga masat makroprudenciale të zbatuara në vitin 2024, krahas vendimit të rritjes së kontributit të premiumeve të bankave në Fondin e Sigurimit të Depozitave, si një ndër mekanizmat e strukturës së sigurisë financiare (Safety Net).

Gjithashtu, rezultatet e stres-testit të solvencës tregojnë se sistemi bankar ka një nivel të lartë qëndrueshmërie ndaj tronditjeve makroekonomike dhe financiare, edhe nën skenarin e rënduar.

Analiza të fokusuara rreth dimensioneve të ndryshme të rreziqeve mbeten të kufizuara nga disponueshmëria e plotë e të dhënave, të cilat, në raste të caktuara (si: ngarkueshmëria me borxh) kanë kufizuar në mënyrë objektive rezultatin për një gjykim të plotë dhe objektiv, por në anën tjetër, kanë udhëzuar politikatat tona për të avancuar udhëzuesit metodologjikë për të përfshirë të dhëna shtesë për analizat e ardhshme.

Sistemi bankar mbetet i qëndrueshëm në aspektin e likuiditetit, me tregues kryesorë brenda kërkesave rregullative, duke u mbështetur kryesisht nga rritja e depozitave të sektorit privat.

Edhe sektorët tjerë financiar janë të qëndrueshëm, me performancë pozitive dhe brenda parametrave rregullativ, krahas avancimit të kornizës ligjore që vijon sipas planit strategjik.

Në përfundim konstatojmë se vlerësimi i përgjithshëm konfirmon qëndrueshmërinë dhe stabilitetin financiar të vendit, mbikëqyrjen rregullative prudente dhe praktikatat efektive të menaxhimit të rrezikut, të cilat sfidohen nga pasiguritë globale ekonomike dhe kërkojnë një vëmendje të vazhdueshme. BQK mbetet e përkushtuar të ushtrohet mandatin e saj të plotë në zbatimin e objektivave kushtetuese dhe ligjore.

Ahmet ISMAILI

Guvernator

Kryesues i Bordit Ekzekutiv

2. Përmbledhje

Aktiviteti ekonomik global shfaq shenja stabilizimi në vitin 2024, ndërkohë që përshkallëzimi i tensioneve tregtare dhe pasiguritë gjeopolitike e kanë cenuar perspektivën për vitin 2025. Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), rritja globale pritet të ngadalësohet, ndërkohë që perspektiva lidhur me shkallën e inflacionit – përkundër trendit rënës, shoqërohet me pasiguri të larta si pasojë e tensioneve tregtare, gjeopolitike apo përkeqësimit të kushteve klimatike.

Ekonomia e Eurozonës shënoi rritje modeste në vitin 2024, e mbështetur kryesisht nga konsumi privat, si rezultat i përmirësimit të të ardhurave reale dhe rënies së inflacionit. Në një mjedis të brishtë makroekonomik dhe të ekspozuar ndaj rreziqeve të reja - përfshirë tensionet tregtare dhe pasiguritë gjeopolitike - Banka Qendrore Evropiane (BQE) pret që rritja ekonomike të mbetet në nivele të ngjashme edhe në vitin 2025. Në të njëjtën kohë, si rezultat i çmimeve më të ulëta të energjisë dhe kushteve ende të shtrënguara financiare, inflacioni në Eurozonë u ngadalësua në vitin 2024, ndërsa BQE parashikon rënie të mëtejshme në 2.0 përqind gjatë vitit 2025. Banka Qendrore Evropiane (BQE) nisi lehtësimin e politikës monetare që nga qershori i vitit 2024, duke krijuar kushte më favorizuese financiare - ndërkohë që rritja e pasigurive për perspektivën e ardhshme si pasojë e rreziqeve të rritura mund të ketë implikime mbi stabilitetin e përgjithshëm makrofinanciar.

Në vitin 2024, ekonomitë e Ballkanit Perëndimor operuan në një mjedis të jashtëm të brishtë, të karakterizuar nga ngadalësimi i Eurozonës dhe tensione të vazhdueshme gjeopolitike.

Aktiviteti ekonomik në Ballkanin Perëndimor u mbështet kryesisht nga kërkesa e brendshme, ndërsa kontributi i sektorit të jashtëm mbeti i dobët për shkak të rënies së kërkesës së jashtme dhe barrierave tregtare. Lehtësimi i presioneve inflacioniste dhe përmirësimi i kushteve të financimit ndihmuan në ruajtjen e një trajektoreje pozitive të rritjes, por pasiguritë e mjedisit të jashtëm vazhdojnë të përbëjnë burim të rëndësishëm rreziku për stabilitetin makrofinanciar të rajonit.

Ekonomia e Kosovës shënoi rritje të qëndrueshme prej 4.4 përqind në vitin 2024, e mbështetur kryesisht nga konsumi privat, investimet dhe eksportet.

Rritja e konsumit, si kontribuesi kryesor në aktivitetin ekonomik, u përkrah nga inflacioni i ulët, rritja e pagave dhe rritja e ndërmjetësimit financiar. Për vitin 2025, perspektiva mbetet pozitive, me një rritje të parashikuar prej 4.1 përqind, e mbështetur kryesisht nga konsumi privat dhe investimet publike e private. Megjithatë, sfidat në mjedisin ndërkombëtar - përfshirë pasiguritë gjeopolitike, ngadalësimin e ekonomive kryesore evropiane, barrierat tregtare dhe plotësimin e nevojave shtesë për energji me çmime më të larta në vend - paraqesin rreziqe potenciale për ritmin e rritjes dhe mund të ushtrojnë presione shtesë mbi inflacionin dhe balancat makroekonomike.

Inflacioni në vend ra në 1.6 përqind në vitin 2024, kryesisht për shkak të uljes së presioneve të jashtme në çmimet e ushqimit dhe mallrave të importuara. Megjithëse kërkesa e brendshme për shërbime mbeti e moderuar, inflacioni bazë qëndroi i lartë për shkak të qëndrueshmërisë së çmimeve të shërbimeve dhe mallrave jo-sezonale. Indekset e kostos së prodhimit dhe ndërtimit u rritën përkatësisht me 4.6 përqind dhe 3.4 përqind, duke sinjalizuar presione të mundshme inflacioniste të brendshme. Për më tepër, presionet mbi çmimet e konsumit janë në rritje në vitin 2025, me projeksionet e BQK-së që parashikojnë një rritje prej 3.3 përqind për gjithë vitin.

Sektori fiskal në Kosovë tregoi rritje të qëndrueshme të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore, duke rezultuar në një deficit primar minimal prej -0.1 përqind të BPV-së. Në të njëjtën periudhë, borxhi publik arriti në 1.74 miliardë euro, rritje prej 4.6 përqind, ndërkohë që rritja më e lartë e aktivitetit ekonomik u përkthye në rënie të raportit ndaj BPV-së në 16.5 përqind.

Në vitin 2024, bilanci i pagesave u karakterizua me thellim të dukshëm të deficitit në llogarinë rrjedhëse, i ndikuar kryesisht nga zgjerimi i deficitit tregtar dhe rënia e të ardhurave dytësore.

Pavarësisht rritjes së eksportit të mallrave dhe shërbimeve, përqendrimi i tyre sektorial dhe ndikimet e faktorëve të jashtëm si tensionet gjeopolitike dhe çmimet ndërkombëtare, kufizuan efektin pozitiv në bilancin e pagesave. Remitenat dhe investimet e huaja direkte vazhduan të luajnë rol të rëndësishëm në financimin e deficitit, por luhatjet në këto burime mbeten rrezik për stabilitetin afatmesëm.

Gjatë vitit 2024, sistemi financiar në Kosovë vazhdoi të zgjerohej me ritme të larta, duke shënuar rritje më të shpejtë kundrejt rritjes reale të BPV-së. Kjo dinamikë ka ndikuar në rritjen e ndërmjetësimit financiar, duke përforcuar rolin e sistemit financiar në ekonominë e vendit.

Struktura e sistemit mbetet e karakterizuar nga dominimi i kapitalit të huaj, veçanërisht në sektorin bankar, atë mikrofinanciar dhe të sigurimeve. Megjithatë, sistemi vazhdon të ketë nivel të kufizuar të ndërlidhjeve mes segmenteve përbërëse, një faktor që mund të veprojë si mbrojtës ndaj përhapjes së rreziqeve në rast krizash sistematike. Në këtë kontekst, sektori bankar ruan rolin kyç si nyja më e rëndësishme e ndërlidhjeve financiare dhe është përqendrimi kryesor i stabilitetit të përgjithshëm financiar.

Sektori bankar shënoi përsheptim të rritjes gjatë vitit 2024, duke reflektuar përmirësimin e kushteve makroekonomike dhe kërkesën e qëndrueshme për financim nga ekonomitë familjare dhe bizneset.

Aktiviteti kreditues i sektorit bankar ka vazhduar rritjen dyshifrore vjetore prej 18.3 përqind në dhjetor 2024, duke financuar si konsumin ashtu edhe investimet në vend. Dinamika në kreditim rezulton të jetë nxitur nga kërkesa e lartë për kredi nga ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare, veçanërisht për kredi për investime në inventarë dhe kapital punues, për investime fikse, si dhe kërkesa për kredi konsumuese. Lehtësime të moderuara janë evidentuar edhe në ofertën kreditore, shprehur kryesisht përmes rritjes së nivelit të aprovimeve, dhe në masë më të vogël, përmirësimit të kushteve të kreditimit si zgjatja e maturitetit, ulja e kërkesave për kolateral dhe rritja e madhësisë së kredisë. Në kuadër të segmentit të ekonomive familjare, segment që u karakterizua me rritje të shpejtë të kreditimit përgjatë gjithë vitit, niveli i ndërmjetësimit financiar – vlerësuar si raport mes numrit të kredi marrësve ndaj

numrit të të punësuarve, rezulton në 40 përqind, ndërkohë që edhe ngarkesa me borxh në këtë segment paraqitet e qëndrueshme me disa dallime ndërmjet bankave.

Treguesit kryesorë të qëndrueshmërisë financiare mbeten brenda kufijve të kërkesave rregullatore. Rritja e shpejtë e kreditimit paraqet potencial për rritje të mundshme të akumulimit të rreziqeve ciklike dhe mundësinë e koncentrimin të rreziqeve në sektorë apo segmente të caktuara, në rrethana të një mjedisi me pasiguri makroekonomike dhe konkurrencë në rritje.

Qëndrueshmëria e sektorit është përforcuar nga masat makroprudenciale, me të gjitha bankat që plotësojnë kërkesat minimale duke rritur shkallën e kapitalizimit të profitit. Gjithashtu, rezultatet e stres-testit të solvencës tregojnë se sistemi bankar ka një nivel të lartë qëndrueshmërie ndaj tronditjeve makroekonomike dhe financiare, edhe nën skenarin e rënduar. Kjo qëndrueshmëri mbështetet kryesisht në fitimet e realizuara dhe të mbajtura gjatë viteve, si dhe në nivelin e lartë të provizioneve të ndara, të cilat përkundër skenarit të rënduar të stres testit mundësojnë që disa banka të vazhdojnë të operojnë me fitim edhe në kushte të vështira. Përveç këtyre faktorëve, struktura e bilancit të bankave luan një rol kyç: pjesëmarrja e lartë e aseteve që gjenerojnë të ardhura interesi u jep bankave mundësinë të përfitojnë nga normat e interesit të aplikueshme (fikse ose variabile), ndërsa pjesëmarrja relativisht më e ulët e detyrimeve me kosto interesi ndikon në rritjen më të ulët relative të kostove të financimit. Si pasojë, rritja e normave të interesit në kredi me normë variabile përmirëson marginën neto të të ardhurave për disa banka, duke zvogëluar ndjeshmërinë e kapitalit ndaj tronditjeve dhe duke forcuar stabilitetin e sektorit bankar.

Sistemi bankar mbetet i qëndrueshëm në aspektin e likuiditetit, me tregues kryesorë brenda kërkesave rregullative, duke u mbështetur kryesisht nga rritja e depozitave të sektorit privat. Megjithatë, rritja e normave të interesit gjatë vitit ka sjellë sfida për kostot e financimit dhe ruajtjen e pozicionit likuid, veçanërisht gjatë periudhës së përsheptimit të aktivitetit kreditor. Rezultatet e stres-testit të likuiditetit sugjerojnë për aftësi të sektorit për përballim të nivelit të lartë të tërheqjeve përgjatë 30 ditëve kalendarike të periudhës stresuese, si dhe nivel të mjaftueshëm të likuiditetit për përballim të tërheqjes së depozitorëve të mëdhenj në nivel sektori.

Kutia 1. Harta e Stabilitetit Financiar¹

Harta e stabilitetit financiar² paraqet tendencat në treguesit kryesorë të qëndrueshmërisë dhe rreziqeve ndaj stabilitetit financiar kundrejt vlerave mesatare historike (Grafik 1). Në vitin 2024, rreziqet ndaj stabilitetit financiar ishin lehtësisht më të larta se në vitin paraprak, por më të ulëta krahasuar me mesataren historike. Në përgjithësi, krahasuar me një vit më parë, ka tendencë të lehtë të rritjes së notave të rrezikut në treguesit e pozicionit financiar të ekonomive familjare, ndërmarrjeve dhe qeverisë. Kurse, niveli i rreziqeve të cilat burojnë nga mjedisi makroekonomik mbeten kryesisht të pandryshuara: mjedisi i brendshëm ekonomik më i favorshëm ka neutralizuar rrezikun lehtësisht më të lartë nga sektori i jashtëm.


Treguesi i kapitalizmit dhe profitabilitetit shënoi përmirësim të theksuar, duke u karakterizuar me rënie vjetore të konsiderueshme të rrezikut kurse treguesi i ekonomive familjare shënoi rritjen më të lartë të rrezikut. Ndërsa treguesi i likuiditetit dhe financimit shënoi rritje të lehtë rreziku dhe vazhdoi të ketë notën më të lartë kundrejt dimensioneve tjera të rrezikut. (Grafik 2).³

Treguesi i **ekonomisë së jashtme** për vitin 2024 shënoi rritje të rrezikut, ndikuar kryesisht nga ecuria e çmimeve të naftës në nivel global, të cilat shënuan rënie më të ngadalësuar krahasuar me një vit më parë. Tutje, në rritje të notës së rrezikut ndikuan zhvillimet si: ngadalësimi i BPV-së së ekonomive që janë partnerët kryesorë tregtar të vendit tonë, niveli më i lartë i papunësisë në vendet ku është e përqendruar diaspora jonë, si dhe niveli më i lartë i normave ndërkombëtare të interesit, pavarësisht trendit rënës që kishin nga tremujori i dytë i vitit 2024. Kurse, prej nën tregueseve përbërës, kontribut në zbutje të lehtë të rrezikut kishte vetëm ai i sentimentit pozitiv prej ndërmarrjeve.

Rreziku nga **ekonomia e brendshme** në vitin 2024 ka shënuar ulje të lehtë, kryesisht si pasojë e rënies më të theksuar të rrezikut nga çmimet e konsumit, duke reflektuar një stabilizim gradual të inflacionit. Hendeku i prodhimit, megjithëse pak më i ulët krahasuar me vitin 2023, mbetet në nivele të

qëndrueshme, duke sugjeruar që ekonomia po operon afër potencialit të saj, çka ndihmon në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik. Kurse, rritja e lehtë e rrezikut nga bilanci i llogarisë rrjedhëse dhe borxhi i jashtëm në raport me BPV-në kanë vepruar si faktorë neutralizues, duke kufizuar përmirësimin e këtij treguesi.

Grafik 1. Harta e stabilitetit financiar



Burimi: BQK.

Treguesi i **sektorit të ndërmarrjeve** shënoi rritje të lehtë të rrezikut i nxitur kryesisht nga rënia e indeksit të shitjeve neto në sektorin e shërbimeve si dhe rënien e vlerës së shtuar në BPV nga tregtia. Ndërkohë, indeksi i qarkullimit industrial, që pasqyron gjendjen e ndërmarrjeve prodhuese, si dhe nën treguesi i regjistrimit të ndërmarrjeve të reja, dhanë kontribut neutralizues, pasi shënuan përmirësim krahasuar me një vit më parë, duke ndihmuar në kufizimin e rritjes së mëtejshme të rrezikut për këtë tregues. Sa i përket komponentëve financiarë, hendeku i kreditimit dhe niveli i kredive me probleme për ndërmarrjet shënuan rritje të lehtë të rrezikut, por mbetën në nivele jo të larta, duke reflektuar një qëndrueshmëri të përgjithshme financiare të këtij segmenti ekonomik.

Treguesi i **sektorit të ekonomive familjare** për vitin 2024 shënoi rritje më të theksuar të rrezikut krahasuar me vitin paraprak, i ndikuar kryesisht nga ngadalësimi i rritjes së dërgesave të emigrantëve, të cilat përbëjnë një nga burimet kryesore të financimit për një pjesë të konsiderueshme të familjeve. Hendeku i huamarrjes u zgjerua konsiderueshëm si pasojë e rritjes së shpejtë të kreditimit gjatë vitit duke kontribuar në rritjen e notës së rrezikut, bashkë me rritjen e vlerës së kredive me probleme. I vetmi nën tregues që

¹ Kalkulimi i treguesve bazohet në vlerën e BPV-së deri në muajin mars 2021, dhe nuk përfshinë revidimin e fundit të BPV-së në prill 2021.

² Harta e Stabilitetit Financiar (HSF) prezanton në mënyrë grafike lëvizjen e shkallës së rrezikut në kategoritë kryesore të rrezikut ndaj stabilitetit financiar në sektorin bankar të Kosovës, si dhe mundëson krahasimin me notën mesatare historike të rrezikut për kategoritë përkatëse. Rritja e distancës nga qendra e hartës për treguesit

reflekton rritje të rrezikut dhe zvogëlim të aftësisë për përballimin e goditjeve ndaj stabilitetit financiar, dhe anasjelltas. Metodologjia e plotë e modelit të HSF-së për Kosovën, i cili ka pësuar revidime të vazhdueshme në tregues dhe mënyrën e tyre të llogaritjes, paraqitet në Materialin Studimor të BQK-së Nr. 6.

³ Ecuria e rrezikut nga treguesit e Hartës së Stabilitetit Financiar dhe kontributi i komponentëve përbërës në nivelin përkatës të rrezikut paraqitet në Shtojcën 1.

kontribuoi në zbutjen e pjesshme të rrezikut ishte ulja e normës së papunësisë.


Treguesi i **sektorit qeveritar** për vitin 2024 shënoi rritje të lehtë të rrezikut krahasuar me vitin paraprak, si rezultat i rritjes së primit të rrezikut sovran. Lehtësimi i politikave monetare në eurozonë ka çuar në ulje të normave të interesit në bonot e thesarit të qeverisë gjermane, ndërkohë që normat në bonot e qeverisë së Kosovës u rritën, duke shkaktuar zgjerim të dallimit ndërmjet tyre dhe për pasojë, rritje të primit të rrezikut sovran. Në rritjen e lehtë të rrezikut kontribuoi edhe rritja e kostos së borxhit publik dhe rënia e bilancit buxhetor ndaj BPV-së, ndërsa nën treguesit të cilët u përmirësuan duke zbutur rritjen e përgjithshme të rrezikut ishin ulja e borxhit publik ndaj BPV-së dhe rritja e të ardhurave tatimore ndaj BPV-së.

Kurse, në kuadër të tregueseve të rrezikut dhe qëndrueshmërisë së përbrenda sektorit bankar, **treguesi i kapitalizimit dhe profitabilitetit** për vitin 2024 shënoi përmirësim të dukshëm krahasuar me vitin 2023, duke reflektuar forcim të pozitës financiare dhe rritje të qëndrueshmërisë së sistemit bankar. Pesë nga gjashtë nën treguesit përbërës shënuan ulje të rrezikut, ndërsa vetëm kreditë jo-performuese shënuan rritje të lehtë. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit dhe kapitali aksionar shënuan përmirësime të dukshme dhe janë sinjal i mirë i konsolidimit të bazës së kapitalit dhe kapaciteteve absorbuese të humbjeve potenciale. Fitimi para tatimeve ndaj aseteve dhe të hyrat neto nga interesi ndaj aseteve, tregojnë përmirësim të qëndrueshmërisë në gjenerimin e të ardhurave. Kurse, përmirësimi më i theksuar u shënuar te ekspozimet e mëdha kreditore ndaj kapitalit të klasit të parë, që tregon për diversifikim më të mirë të riskut dhe ulje të varësisë nga klientët më të mëdhenj.

Treguesi i **likuiditetit dhe financimit** të sektorit për vitin 2024 shënoi rritje të rrezikut krahasuar me vitin paraprak, si rezultat i përkeqësimit të tre nga katër nën treguesit përbërës. nën treguesi i kredive

ndaj depozitave shënoi rritje për shkak të rritjes më të lartë të kreditimit krahasuar me rritjen e depozitave.

Grafik 2. Harta e stabilitetit financiar



Tutje, nën treguesi i depozitave të ekonomive familjare gjithashtu shënoi rritje të rrezikut, duke reflektuar ngadalësim të rritjes së depozitave, burimit kryesor financues bankar. Po ashtu, edhe treguesi i nivelit të likuiditetit shprehur përmes aseteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra shënoi rritje të rrezikut, duke sinjalizuar presione shtesë në kapacitetin likuid të sektorit. Në treguesi që shënoi përmirësim të lehtë ishte pesha e detyrimeve jo rezidentë në totalin e detyrimeve, i cili mbeti në nivel të ulët.

Treguesi i **strukturës së sektorit bankar** për vitin 2024 shënoi rritje të lehtë të rrezikut krahasuar me vitin paraprak, i ndikuar kryesisht nga rënia e diversifikimit të burimeve të financimit. Po ashtu, nën treguesi i matjes së koncentrimin të kreditimit për sektorin e ndërmarrjeve shënoi rritje të lehtë, përderisa niveli i koncentrimin të aseteve të 3 bankave më të mëdha ndaj aseteve të sektorit mbeti pothuajse e pandryshuar, me rritje marginale. Ndërkohë, përmirësime të vogla u shënuan në nën treguesin e devijimit të portofolit të kredive të bankave ndaj asaj të tregut dhe në devijimin negativ nga norma mesatare e kapitalizimit, duke sugjeruar rritje të diversifikimit në portfolion kreditore të bankave si dhe përafrim të normës së kapitalizimit të bankave me mesataren e sektorit.

3. Mjedisi i jashtëm dhe zhvillimet në ekonominë e brendshme

Aktiviteti ekonomik global shënoi rritje prej 3.3 përqind në vitin 2024, sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN). Megjithatë, pavarësisht shenjave të stabilizimit gjatë vitit 2024 me ngadalësimin e inflacionit dhe stabilizimin e tregjeve të punës, ekonomia globale në vitin 2025 vijoi të sfidohet nga pasiguritë e larta gjeopolitike dhe tensionet e intensifikuara tregtare. Vendosja e tarifave tregtare nga SHBA-të në prill shkaktoi luhajtje të theksuara në tregjet financiare dhe rriti pasiguritë në nivel global, sidomos për ekonomitë më të ekspozuara ndaj masave proteksioniste tregtare. Vendosja e tarifave, përkundër pezullimit të përkohshëm në disa raste, pritet të ndikojë negativisht në aktivitetin ekonomik global përmes rritjes së pasigurive rreth politikave tregtare dhe pengesave në procesin e vendimmarrjes nga ndërmarrjet dhe agjentët tjerë ekonomikë.


Në këto rrethana, FMN parashikon që rritja globale të ngadalësohet në 2.8 përqind në vitin 2025, me ndikimin më të madh në SHBA, Eurozonë dhe Kinë. Treguesit afatshkurtër - përfshirë shitjet me pakicë dhe sondazhet e sentimentit të ndërmarrjeve dhe konsumatorëve - konfirmojnë dobësimin e aktivitetit ekonomik në vitin 2025. Për më shumë, rritja e borxhit publik në shumë vende ka kufizuar hapësirën për politika fiskale stimuluese, duke rritur rrezikun e një ngadalësimi më të thellë ekonomik në rast të goditjeve të reja.

Ngadalësimi i aktivitetit ekonomik si rezultat i kushteve të shtrënguara të financimit dhe stabilizimi i tregjeve të punës dhe zinxhirëve global të furnizimit, ndikuan që inflacioni global të ngadalësohet në 5.8 përqind në vitin 2024. Megjithëse ecuria inflacioniste mbetet në kahjen e dëshiruar, ritmi i rënies është ngadalësuar dhe nuk është i njëtrajtshëm, me ekonomitë në zhvillim që përballen me vështirësi më të mëdha për ta rikthyer inflacionin në nivelet e synuara kundrejt ekonomive të zhvilluara. Sipas parashikimeve

të FMN-së, inflacioni global pritet të vazhdojë ecurinë rënëse dhe të arrijë në 4.3 përqind në vitin 2025. Megjithatë, rreziqet për një rikthim të presioneve inflacioniste mbeten të pranishme, veçanërisht në rast të përshkallëzimit të mëtejshëm të tensioneve tregtare, gjeopolitike apo përkeqësimit të kushteve klimatike. Në anën tjetër, ngadalësimi i aktivitetit ekonomik global mund të ushtrojë presione nga kahu rënës.

Në përgjigje të këtyre zhvillimeve, bankat qendrore në shumicën e ekonomive lehtësuan politikën monetare gjatë vitit 2024, ecuri që vazhdoi edhe gjatë vitit 2025. Megjithatë, tensionet tregtare dhe pasiguritë rreth tarifave kanë krijuar presione shtesë, të cilat pritet të ndikojnë në drejtimin e politikës monetare, në varësi të efektit të tyre në inflacionin global. Ankorimi i pritjeve inflacioniste mbetet thelbësor dhe është i varur nga besimi i agjentëve ekonomik në aftësinë e bankave qendrore për të menaxhuar inflacionin. Nëse këto pritje cenohen, mund të krijohen kompromise të vështira mes objektivit për stabilitet të çmimeve dhe mbështetjes së aktivitetit ekonomik.

Grafik 1. Indeksi i luhatshmërisë në tregjet financiare



Burimi: CBOE VIX (2025)

Viti 2024 u karakterizua me rritje të rreziqeve ndaj stabilitetit financiar global, për shkak të çmimeve të larta të aseteve, rritjes së levës financiare dhe uljes së premieeve të rrezikut, kundrejt perspektivës së dobësuar ekonomike. Në vitin 2025, këto rreziqe filluan të materializohen, pasi pasiguritë rreth politikave tregtare u pasqyruan në rritje të indeksit të luhatshmërisë në tregjet financiare globale (grafik 1), si pasojë e rënies së vlerës së aseteve dhe zgjerimit të premieeve të

rrezikut dhe rritjes së luhatshmërisë në tregjet financiare.

Sipas FMN-së, stabiliteti financiar global mbetet i brishtë për shkak të vlerësimeve ende të larta në tregjet e kapitalit dhe të borxhit që mund të përkeqësohen në rast të një korigjimi të papritur. Institucionet më të ekspozuara ndaj huamarrjes mund të përballen me vështirësi në kushte të mungesës së likuiditetit. Njëkohësisht, ekonomitë në zhvillim të ballafaquara me kosto të larta financimi, mund të përballen me nevoja për refinancim të borxhit me kosto të ngritur. Kurse, ndërmjetësit financiarë jo-bankarë, për shkak të mbikëqyrjes më të lehtë, mund të amplifikojnë këto rreziqe përmes ndërveprimit me sektorin bankar.

Ekonomia e Eurozonës dhe Ballkanit Perëndimor

Aktiviteti ekonomik në Eurozonë u përmirësua lehtësisht në vitin 2024, me rritje modeste prej 0.9 përqind, nxitur kryesisht nga konsumi privat si rezultat i përmirësimit të të ardhurave reale dhe rënies së inflacionit. Investimet mbetën të dobëta, ndërsa kërkesa e jashtme dhe aktiviteti prodhues u ngadalësuan, duke lënë sektorin e shërbimeve si mbështetësin kryesor të rritjes ekonomike. Në një ambient të brishtë makroekonomik dhe të ndjeshëm ndaj barrierave tregtare dhe rreziqeve tjera, BQE parashikon një rritje të përafërt prej 0.9 përqind në vitin 2025.

Inflacioni u ngadalësua ndjeshëm në 2.4 përqind në vitin 2024, si rezultat i çmimeve më të ulëta të energjisë, kostonë të ngritur të financimit që zbehu aktivitetin ekonomik, si dhe stabilizimit të tregut të punës dhe zinxhirëve të furnizimit. Presionet në sektorin e shërbimeve vazhduan, por me tendencë zbutjeje. Projeksionet e BQE-së (qershor 2025) sugjerojnë një rënie të mëtejshme të inflacionit në 2.0 përqind në 2025, por rreziqet si përshkallëzimi i tensioneve tregtare me SHBA-të, situata gjeopolitike, luhatjet e kursit të këmbimit dhe kushtet klimatike mund të rikthejnë presionet inflacioniste.

Në këto kushte, BQE-ja nisi uljen e normave të interesit në vitin 2024, duke lehtësuar kushtet financiare për të ringjallur rritjen ekonomike. Megjithatë, kreditimi mbeti i përmbajtur, me standardet e huadhënies për ndërmarrjet dhe kreditë konsumuese që u shtrënguan për shkak të perceptimit më të lartë të rrezikut, ndërsa kreditimi hipotekar u lehtësua, si rezultat i konkurrencës në tregun bankar. Kërkesa për kredi u përmirësua gradualisht gjatë vitit, me rritje më të theksuar në gjysmën e dytë, pas fillimit të lehtësimit të kushteve të financimit.

Gjatë vitit 2024, ekonomitë e Ballkanit Perëndimor (BP) shënuan rritje të moderuar, me normë mesatare të rritjes reale të BPV-së prej 3.4 përqind (3.7 përqind në vitin 2023). Kosova shënoi rritjen më të lartë ekonomike në rajon, me 4.4 përqind, pasuar nga Shqipëria me 4.0 përqind. Ndërsa, Bosnja dhe Hercegovina shënoi rritjen më të ulët prej 2.5 përqind. Aktiviteti ekonomik në rajon u mbështet kryesisht nga faktorë të brendshëm, përfshirë rritjen e konsumit privat, investimeve publike dhe rritjen e pagave. Këto zhvillime u ndikuan pozitivisht nga lehtësimi i presioneve inflacioniste dhe përmirësimi gradual i kushteve në tregun e punës, që ofruan mundësi më të mira për konsum dhe investime.

Në anën tjetër, kontributi i eksporteve neto ishte negativ në të gjitha vendet e rajonit si pasojë e rënies së kërkesës së jashtme, veçanërisht nga vendet e BE-së, që mbeten partneri kryesor tregtar dhe burim i rëndësishëm i financimit për rajonin. Po ashtu, rritja e importeve për të përmbushur kërkesën e brendshme ka pasur ndikim në zgjerimin e deficitit tregtar në shumicën e vendeve të BP-së.

Norma mesatare e inflacionit në rajon u ngadalësua ndjeshëm në 3.2 përqind në vitin 2024, nga 7.7 përqind në vitin paraprak. Ky ngadalësim erdhi si rezultat i stabilizimit të çmimeve të energjisë, përmirësimit të zinxhirëve të furnizimit dhe masave të kujdesshme të politikës monetare të ndërmarra nga bankat qendrore të rajonit. Kosova regjistroi normën më të ulët të

inflacionit (1.6 përqind), ndërsa Serbia shënoi normën më të lartë (4.8 përqind).

Sipas projeksioneve të fundit të FMN-së (prill 2025), ekonomitë e BP-së pritet të shënojnë rritje mesatare prej 3.4 përqind në vitin 2025, në një mjedis të sfiduar me pasiguri të vazhdueshme të ekonomisë globale dhe rritjes së tensioneve gjeopolitike. Një nga burimet kryesore të rrezikut mbeten tensionet tregtare me SHBA-të dhe implikimet direkte apo indirekte përmes vendeve të BE-së si partnerët kryesor tregtar për vendet në BP.


Aktiviteti kredi-dhënës në Ballkanin Perëndimor u përshpejtua ndjeshëm gjatë vitit 2024, me normën mesatare të rritjes prej 12.3 përqind, duke reflektuar kushte të favorshme financimi nga sektori bankar dhe rritje të kërkesës. Rritja më e lartë e kreditimit u shënuar në Kosovë (18.3 përqind), e ndjekur nga Shqipëria (13.3 përqind) dhe Maqedonia e Veriut (12.8 përqind). Këto shifra pasqyrojnë dinamika pozitive në sektorin bankar dhe përmirësim në cilësinë e portofolit kreditor në të gjitha vendet e rajonit. Megjithatë, rritja e përshpejtuar e kreditimit në vendet e rajonit mund të sinjalizojë për akumulim të rreziqeve në sistemin financiar. Në këtë kontekst, bankat qendrore me qasje pro-aktive ndërmorën reforma kyçe dhe masa specifike për forcimin e stabilitetit financiar, duke përfshirë aplikimin e masave makroprudenciale dhe avancimin e integritimit rajonal në sistemin e pagesave. Këto masa synojnë rritjen e qëndrueshmërisë së sektorit financiar përballë pasigurive globale dhe përafrimin e sistemeve financiare me standardet e BE-së.

3.1 Ekonomia e brendshme

Ekonomia e Kosovës shënoi rritje të qëndrueshme dhe përmirësim të dinamikave të përgjithshme makroekonomike në vitin 2024. Sipas vlerësimeve tremujore të ASK-së, BPV-ja reale shënoi rritje prej 4.4 përqind në vitin 2024, mbështetur nga rritja e shënuar në konsum, investime dhe eksport të mallrave dhe shërbimeve, ndërkohë që importi i mallrave dhe shërbimeve

pati ndikim të theksuar negativ në aktivitetin ekonomik (Grafik 2).

Grafik 2. Norma e rritjes së BPV-së reale dhe kontribuesit në rritje



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK.

Konsumi, si komponenta kryesore e kërkesës së brendshme kontribuoi me 4.8 pikë përqindje në rritjen reale të BPV-së, mbështetur kryesisht nga përmirësimi i pozicionit të të ardhurave të disponueshme si rezultat i rënies së shkallës së inflacionit, rritjes së pagës mesatare, rritjes së kredive konsumuese si dhe rritjes së burimeve të jashtme të financimit si remitancat dhe kompenzimi i punonjësve. Në të njëjtën periudhë, investimet kontribuan me 2.0 pikë përqindje në rritjen reale të BPV-së, mbështetur si nga pozicioni i përmirësuar i investimeve publike ashtu edhe nga rritja e kredive investuese dhe deri në një masë, e IHD-ve. Ndërkohë, eksportet neto kontribuan negativisht në llogaritjen e BPV-së me 2.4 pikë përqindje në vitin 2024, dinamikë që kryesisht i atribuohet rritjes së nevojave për financim të konsumit të brendshëm që u shoqërua me rritje të importit të mallrave – si dhe, liberalizimit të vizave me BE-në që u përkthye në rritje të importit të shërbimeve të udhëtimit.


Perspektiva makroekonomike për vitin 2025, bazuar në projeksionet e BQK-së si dhe informacionet e reja të publikuara përgjatë vitit, rezulton të jetë pozitive por me tendenca ngadalësimi. Ndërkohë që projeksionet tona sugjerojnë një rritje reale të BPV-së prej 4.1 përqind (4.4 përqind në vitin 2024), edhe të dhënat e tremujorit të parë të vitit 2025 të publikuara nga ASK sugjerojnë për rritje reale të BPV-së prej 3.6 përqind (5.6 përqind në tremujorin e parë të vitit 2024). Rritja ekonomike në vitin 2025 pritet të vazhdojë të mbështetet nga konsumi dhe investimet, si rezultat i rritjes së burimeve

kryesore të financimit të të dy komponentëve, ndërkohë që ngadalësimi i observuar në vitin 2025 pasqyron një dinamikë më të dobët në burimet e komponentës së konsumit dhe pritjeve për rënien e eksportit të mallrave.

Tensionet gjeopolitike dhe rritja e pasigurive kanë krijuar një mjedis me paqartësi të shtuara si për perspektivën globale ashtu edhe atë rajonale, duke e vështirësuar formulimin e projeksioneve dhe parashikimin e rreziqeve. Në të njëjtën kohë, perspektiva ekonomike e vendit është sfiduar edhe nga dinamika të brendshme dhe rritja e çmimeve të energjisë dhe ushqimeve, si zhvillime me implikime potenciale në ciklin fiskal dhe ekonomik.

Inflacioni në vend shfaqti ecuri rënëse përgjatë vitit 2024, me normën mesatare vjetore që rezultoi 1.6 përqind, krahasuar me 4.9 përqind në vitin 2023 (Grafik 3). Ky ngadalësim u ndikua kryesisht nga zbutja e presioneve të jashtme inflacioniste në çmimet e ushqimit dhe mallrave tjera të importuara. Edhe pse pati luhajtje në gjysmën e parë të vitit, çmimet e energjisë gjithashtu kontribuan në ngadalësimin e inflacionit në përgjithësi. Përkundër dinamizimit të aktivitetit ekonomik në vitin 2024, nuk u vërejtën presione domethënëse të kërkesës së brendshme në shërbime. Kjo reflekton rritjen më të theksuar të investimeve dhe rolin dominues të mallrave të importuara në shportën e konsumit, duke nënvizuar ndikim dominues të faktorëve të jashtëm në formimin e inflacionit në vitin 2024.

Grafik 3. Inflacioni sipas origjinës dhe inflacioni bazë



Inflacioni bazë, ndonëse gjithashtu në trajektore rënëse, mbeti më i lartë se inflacioni i përgjithshëm, me një normë mesatare prej 2.6 përqind krahasuar me 4.4 përqind në vitin 2023. Kjo pasi çmimet e shërbimeve dhe mallrave jo të ndjeshme ndaj luhajtjeve

sezonale ruajtën presione inflacioniste përgjatë vitit 2024, pasi dinamikat në këto kategori janë më graduale.

Struktura e ndjeshme e konsumit në Kosovë ndaj çmimeve të mallrave të importuara, sidomos atyre të ushqimit dhe naftës, përbën një kanal të rëndësishëm të transmetimit të goditjeve të jashtme në ekonominë vendore. Në vitin 2024, inflacioni i importuar kontribuoi me 1.2 pikë përqindje në normën e përgjithshme prej 1.6 përqind, ndërsa ai i brendshëm me 0.4 pikë përqindje.

Megjithatë, përshpejtimi i indekseve të kostos së prodhimit (ICP) dhe ndërtimit (IKN) gjatë vitit 2024 - respektivisht me 4.6 përqind dhe 3.4 përqind, sinjalizojnë rreziqe potenciale për presione të brendshme inflacioniste në periudhën afatmesme, me implikime potenciale edhe në çmimet e konsumit. Për më shumë, zhvillimet në fillim të vitit 2025 sinjalizojnë rikthim të presioneve inflacioniste. Në periudhën janar-maj 2025 u evidentua rritje e presioneve inflacioniste prej 2.5 përqind, si pasojë e rritjes së çmimeve të importit kryesisht të disa artikujve ushqimor. Kjo ndikoi që BQK të rishikojë projeksionet e inflacionit për lartë në 3.3 përqind për vitin 2025.

Gjatë vitit 2024, sektori fiskal u karakterizua me rritje të qëndrueshme të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore, ndërkohë që performanca pozitive rezultoi në një deficit primar buxhetor minimal prej -0.1 përqind të BPV-së. Në të njëjtën periudhë, borxhi publik arriti në 1.74 miliardë euro, një rritje prej 4.6 përqind. Megjithatë, rritja më e shpejtë e BPV-së kundrejt ritmit të rritjes së borxhit rezultoi me ulje të raportit të borxhit ndaj BPV-së në 16.5 përqind

Bilanci i pagesave gjatë vitit 2024 u karakterizua me thellim të deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe financiare, ndërsa bilanci i llogarisë kapitale shënoi rënie të bilancit pozitiv. Deficiti i llogarisë rrjedhëse u thellua në 914.8 milionë euro (8.9 përqind e BPV-së), duke shënuar rritje vjetore prej 25.4 përqind. Thellimi i bilancit të llogarisë rrjedhëse kryesisht i atribuohet thellimit të


deficitit tregtar të mallrave për 7.1 përqind, si pasojë e rritjes së shpejtë të importeve dhe bazës ende të ulët të eksporteve megjithë rritjen, si dhe i rënies prej 1.9 përqind të të ardhurave dytësore si pasojë e rritjes më të ngadalëshme të remitancave. Rritja e bilancit pozitiv të shërbimeve prej 9.9 përqind dhe përmirësimi i të ardhurave parësore me 9.7 përqind zbutën deri në një masë zgjerimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse.

3.2. Pozicioni financiar i ndërmarrjeve

Bazuar në të dhënat e qarkullimit të ndërmarrjeve, dinamizimit në iniciativën ndërmarrëse dhe dinamikës në ndërmarrjen e borxhit shtesë, ndërmarrjet rezultojnë të kenë vepruar në një mjedis më aktiv përgjatë vitit 2024. Në sektorin e tregtisë, qarkullimi shënoi një rritje vjetore prej 6.2 përqind, një ngadalësim kundrejt rritjes prej 10.3 përqind të shënuar në vitin 2023, ndërkohë që vlera e shtuar në këtë sektor u rrit me 3.2 përqind në të njëjtën periudhë.

Në sektorin e industrisë përpunuese, qarkullimi u rrit me 3.3 përqind, ndërsa vlera e shtuar shënoi rritje lehtësisht më të lartë prej 3.9 përqind, indikacion i zgjerimit të kapaciteteve prodhuese dhe rritjes graduale të kërkesës për produkte të përpunuara.

Grafik 4. Ndryshimi vjetor në numrin e ndërmarrjeve të reja




Iniciativa ndërmarrëse ka ndjekur një trend pozitiv gjatë vitit, me 12,051 ndërmarrje të reja të regjistruara - një rritje prej 5.6 përqind krahasuar me vitin paraprak. Kjo dinamikë pasqyron një klimë më të favorshme për zhvillimin e biznesit dhe nxitjen e investimeve të reja. Në të njëjtën kohë, rezultojnë të jenë mbyllur 1,637 ndërmarrje, që përbën një rritje

të lehtë prej 2.2 përqind në raport me vitin 2023 (Grafik 4).

Borxhi i ndërmarrjeve ndaj institucioneve financiare ka vazhduar të rritet, duke shënuar një zgjerim vjetor prej 12.1 përqind dhe duke arritur në 47.0 përqind të BPV-së (Grafik 5).

Grafik 5. Borxhi i ndërmarrjeve




Kjo rritje është mbështetur kryesisht nga borxhi i brendshëm, i cili u rrit me 15.7 përqind si rezultat i zgjerimit të kreditimit nga sektori bankar (14.9 përqind), dhe kredive nga ndërmjetësit tjerë financiar të cilat shënuan rritje të konsiderueshme prej 31.7 përqind. Borxhi i jashtëm, ndërkohë, u rrit në një shkallë më të moderuar prej 2.9 përqind, duke zbritur pjesëmarrjen e tij në totalin e borxhit të ndërmarrjeve në 25.9 përqind, nga 28.2 përqind një vit më parë.

Rritja e kreditimit nga sektori bankar për sektorin e ndërmarrjeve ka ndikuar në rritjen shkallës së ndërmjetësimit financiar, me raportin kredi/BPV që arriti në 33.0 përqind, nga 30.7 përqind në vitin 2023. Si rezultat, pozicioni neto debitor i ndërmarrjeve ndaj sektorit bankar shënoi rritje prej 18.2 përqind, ritëm më i lartë se rritja prej 9.6 përqind në vitin 2023. Depozitat shënuan rritje prej 12.3 përqind, ndërsa kreditimi ndaj ndërmarrjeve shënoi rritje prej 15.7 përqind. Kjo dinamikë e rritjes më të lartë të kredive në raport me depozitat, ka ndikuar në rritjen e pozicionit debitor të ndërmarrjeve.

Kostoja e huamarrjes për ndërmarrjet ka shënuar rënie të lehtë, duke zbritur në një mesatare prej 6.4 përqind, faktor që bashkë me kushtet tjera të kreditimit mund të ketë incentivizuar huamarrjen shtesë nga ky segment. Në anën tjetër, rritja e interesit për

depozitat e afatizuara ka stimuluar rritjen e depozitave në sektorin bankar (Grafik 6).

Grafik 6. Normat e interesit për ndërmarrjet




Burimi: BQK.

3.3. Pozicioni financiar i ekonomive familjare

Borxhi i ekonomive familjare është rritur me ritme më të shpejta krahasuar me sektorin e ndërmarrjeve, duke arritur në 25.1 përqind të BPV-së në vitin 2024, një rritje vjetore prej 21.4 përqind. Borxhi i brendshëm ndaj sektorit bankar dhe institucioneve mikrofinanciare shënoi rritje prej 22.0 përkatësisht 20.1 përqind, ndërsa borxhi i jashtëm, që përbën vetëm 2.1 përqind të gjithë borxhit të ekonomive familjare, shënoi rritje prej 5.7 përqind (Grafik 7).

Grafik 7. Borxhi i ekonomive familjare




Burimi: BQK.

Kreditë e reja për ekonomitë familjare shënuan rritje prej 27.9 përqind, si rezultat i rritjes së dy segmenteve: kredive konsumuese që shënuan rritje prej 27.1 përqind dhe kredive hipotekare që shënuan rritje prej 37.9 përqind.

Pozicioni kreditor i ekonomive familjare është përmirësuar si rezultat i rritjes së depozitave, të cilat arritën vlerën prej 4.5

miliardë euro, me një rritje vjetore prej 11.1 përqind (Grafik 8).


Grafik 8. Depozitat e ekonomive familjare



Burimi: BQK.

Rritja e normave të interesit për depozitat e afatizuara ka nxitur rritjen e depozitave të afatizuara me 24.2 përqind, duke bërë që depozitat e pa afatizuara (kursimet) të shënojnë rënie prej 13.1 përqind. Kostoja e huamarrjes për ekonomitë familjare shënoi rënie me normën mesatare të interesit për kreditë e reja konsumuese që ra në 6.1 përqind, ndërsa për kreditë hipotekare në 5.0 përqind (Grafik 9).

Grafik 9. Normat e interesit për ekonomitë familjare



Burimi: BQK.

Të ardhurat e ekonomive familjare shënuan rritje, mbështetur në të dhënat për përmirësimin e kushteve në tregun e punës dhe rritjes së burimeve të financimit në ekonomi. Në vitin 2024, paga mesatare bruto arriti në 639 euro, një rritje vjetore prej 12.1 përqind, me pagën mesatare bruto në sektorin privat që arriti në 598 euro dhe shënoi rritje vjetore prej 16.1 përqind. Gjithashtu, transferet sociale, që përfshijnë ndihmat dhe pensionet, shënuan rritje prej 20.3 përqind, ndërsa kompensimi i punëtorëve⁴ shënoi rritje vjetore prej 20.6

⁴ Të ardhurat nga kompensimi i punëtorëve - të ardhurat e punëtorëve sezonal jashtë vendit si dhe punëtorëve kosovarë jashtë kufirit për një periudhë më pak se një vit.

përqind. Remitencat, në anën tjetër, shënuan rritje më të lehtë prej 1.4 përqind.

Treguesit tjerë të tregut të punës sugjerojnë për rritje të pjesëmarrjes së fuqisë punëtore në 43.2 përqind, një rritje prej 2.5 pikë përqindje. Tutje, shkalla e punësimit arriti në 38.6 përqind, që është për 2.3 pikë përqindje më e lartë krahasuar me vitin 2023. Ndërkohë,

shkalla e papunësisë mbeti pothuajse e pandryshuar në 10.8 përqind. Treguesi i varësisë ekonomike, që paraqet raportin ndërmjet popullsisë joaktive (mbi 15 vjeç) dhe punësimit, është përmirësuar, duke rënë në 191 përqind nga 211 përqind në vitin 2023.

Tabela 1. Borxhi ndaj bankave dhe performanca e ekonomive familjare


Përshkrimi	2020	2021	2022	2023	2024
Borxhi i ekonomive familjare ndaj bankave (në milionë)	1,822.2	1,401.2	1,634.1	1,915.3	2,336.0
prej të cilave në valutë të huaj (në milionë)	2.3	2.2	1.7	1.3	-
Depozitat e ekonomive familjare në banka (në milionë)	2,937.1	3,366.1	3,643.5	4,056.8	4,506.4
prej të cilave në valutë të huaj (në milionë)	155.4	176.1	115.1	155.7	159.7
Neto pozicioni ndaj bankave (Pozicioni kreditor) në milionë	1,754.9	1,964.9	2,009.4	2,141.5	2,170.4
Mesatarja e vlerës së kredisë për të punësuar	3,406.3	3,655.7	4,046.6	4,433.2	5,663.3
Shkalla e varësisë ekonomike	275.0%	248.0%	230.0%	211.0%	193.0%

Burimi: BQK.

4. Zhvillimet në sistemin financiar

Në vitin 2024, sistemi financiar në Kosovë vazhdoi të zgjerohet me ritme të larta, duke shënuar rritje vjetore prej 14.8 përqind të aseteve totale. Rritja përtej shkallës së rritjes së BPV-së nominale është reflektuar në zgjerimin e mëtejshëm të ndërmjetësimit financiar në 123.4 përqind të BPV-së - rritje vjetore për 8.8 pikë përqindje. Kjo dinamikë tregon për fuqizimin e rolit të sistemit financiar në financimin e ekonomisë, por njëkohësisht ngritë nevojën për monitorim të kujdesshëm të qëndrueshmërisë së këtij zgjerimi (Grafik 10).


Grafik 10. Peshat e sektorëve të sistemit financiar ndaj BPV-së



Rritja e përshpejtuar e sektorit bankar – që përfaqëson mbi dy të tretat e aseteve të sistemit – mbetet faktori kyç në zgjerimin e sistemit financiar, duke rritur peshën sistematike të këtij sektori. Në të njëjtën kohë, sektori pensional shënoi rritje të lartë të aseteve dhe kontribuoi në forcimin e bazës së kursimeve afatgjata, megjithëse kërkon vëmendje ndaj rreziqeve në tregjet ndërkombëtare për shkak të peshës së investimeve në këto tregje dhe pasigurive të larta gjeopolitike. Ndërkaq, sektorët mikrofinanciar dhe financiar jo-bankar si dhe ai i sigurimeve shënuan ngadalësim të rritjes vjetore, pas ritmit të zgjerimit të shpejtë në dy vitet paraprake. Sektor i ndihmësve financiarë, megjithëse me peshë të ulët në sistem, shënoi rritje të lartë vjetore të aseteve


pas ri-klasifikimeve strukturore në vitin e kaluar (Grafik 11).⁵

Grafik 11. Pjesëmarrja e sektorëve përkatës në asetet e sistemit financiar



Karakteristikë strukturore e sistemit financiar në Kosovë mbetet dominimi i theksuar i kapitalit të huaj, sidomos në sektorin bankar, mikrofinanciar dhe atë të sigurimeve (Grafik 12).

Grafik 12. Pronësia e sektorëve përbërës të sistemit financiar, dhjetor 2024



Në fund të vitit 2024, bankat me origjinë nga vendet e BE-së përfaqësonin pjesën më të madhe të sektorit bankar, ndërkohë që kapitali vendor kishte pjesëmarrje modeste prej vetëm 16.4 përqind – rritje vjetore prej 0.7 pikë përqindje. Ndërkohë, bankat me origjinë nga Shqipëria dhe Turqia zënë pjesë të konsiderueshme të tregut, përkatësisht 17.9 përqind dhe 14.8 përqind, duke reflektuar rritje të rolit të kapitalit rajonal në sektor.

⁵ Riklasifikimi i dy operatorëve nga ndihmës financiarë në IMF/IFJB, në vitin 2023.

Edhe sektori mikrofinanciar dhe financiar jo-bankar vijoi të mbështetet kryesisht në kapital të huaj - me rënie vjetore prej 4.8 pikë përqindje në favor të kapitalit vendor, ndërsa tri institucionet më të mëdha zotëronin mbi gjysmën e aseteve të këtij sektori. Në sigurime, kapitali i huaj përbënte 53.6 përqind të aseteve, me origjinë kryesisht nga Austria, Sllovenia dhe Shqipëria.

Përkundër diversifikimit gradual të pronësisë së sistemit, dominimi i kapitalit të huaj, mbetet një kanal i mundshëm për transmetimin e zhvillimeve nga vendet e origjinës përmes ndryshimit të strategjive nga banka mëmë. Specifikisht, struktura e pronësisë mund të ndikojnë në bartjen e efekteve nga sjellja financiare e grupeve që operojnë në tregun vendor, veçanërisht në rast të krizave në vendet mëmë apo përkeqësimit të kushteve ekonomike në vendin e origjinës.

Një tjetër rrezik strukturor vjen nga niveli relativisht i lartë i koncentrimin në sektorët

kredi dhënës. Në sektorin bankar, ndonëse konkurrenca është rritur me hyrjen e bankave të reja dhe rritjen graduale të peshës së bankave më të vogla, tri bankat më të mëdha vazhdojnë të mbajnë peshën kryesore në treg. Gjithashtu, në sektorin mikrofinanciar dhe financiar jo-bankar, tri institucione zotërojnë mbi gjysmën e aseteve të sektorit. Kjo rritë ndjeshmërinë e sistemit financiar ndaj goditjeve idiosinkratike veçanërisht në bankat e mëdha me rëndësi sistemike.


Në dhjetor 2024, numri i institucioneve financiare arriti në 139 nga 136 sa ishte një vit më parë. Gjatë vitit u shtuan katër ndihmës financiar, ndërsa një bankë me kapital të huaj ka përfunduar vullnetarisht veprimtarinë bankare, por këto ndryshime nuk kanë prodhuar ndikim material në strukturën e përgjithshme për shkak të peshës së ulët të institucioneve (tabela 2).

Tabela 2. Numri i institucioneve financiare

Përshkrimi	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Bankat komerciale	10	10	10	11	11	12	12	11
Siguruesit	15	14	13	13	12	12	12	12
Fondet pensionale	2	2	2	2	2	2	2	2
Ndihmësit financiar	43	50	50	57	53	59	61	65
Ndërmjetësuesit në sigurime	16	16	18	18	19	16	17	17
Institucionet mikrofinanciare dhe financiare jobankare	25	29	29	29	30	30	32	32

Burimi: BQK.

Figura 1. Ndërlidhjet institucionale të Sistemit Financiar të Kosovës



Burimi: BQK.

Pavarësisht rritjes së përgjithshme të sistemit financiar, struktura e tij mbetet kryesisht e fragmentuar - me ndërlidhje të ulëta ndër sektoriale - gjë që të mund të jetë faktor mbrojtës në rast të krizave sistemike. Sektori bankar, për shkak të përmasës dhe rolit të tij qendror, mbetet nyja më e rëndësishme e ndërlidhjeve financiare.

Gjatë vitit 2024, ndërlidhjet ndër sektoriale nuk shënuan ndryshime strukturore të rëndësishme, por u evidentuan disa dinamika me rëndësi. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj Qeverisë Qendrore u rrit, përmes blerjes së shtuar të letrave me vlerë, si përgjigje ndaj ofertës më të lartë të qeverisë për financim të brendshëm (figura 1). Gjithashtu, u shënuar rritje e ndërlidhjes ndërmjet sektorit bankar dhe fondit pensional, përmes rritjes së investimeve në certifikata depozite nga ana e këtij të fundit.

Nga perspektiva e rrezikut të përhapjes së goditjeve, ekspozimi i sektorëve të tjerë financiarë ndaj bankave komerciale mbetet faktor i rëndësishëm. Institucionet mikrofinanciare dhe financiare jo-bankare, siguruesit dhe fondet pensionale mbajnë pjesë të konsiderueshme të mjeteve të tyre në formë depozitash në sektorin bankar, duke i bërë kështu të ndjeshëm ndaj zhvillimeve eventuale në këtë sektor. Përkundrazi, ekspozimi i bankave ndaj sektorëve të tjerë financiarë mbetet i kufizuar - vetëm 0.5 përqind të aseteve të sektorit bankar - dhe


nuk paraqet rrezik të drejtpërdrejtë për stabilitetin e sektorit bankar.

Në fund të vitit 2024, sektori pensional zvogëloi ekspozimin me BQK-në përmes reduktimit të parasë së gatshme të mbajtur në këtë institucion, si rrjedhojë e riorientimit të investimeve drejt instrumenteve më të leverdishëm si letrat me vlerë dhe certifikatat e depozitës. Kurse, kompanitë e sigurimeve shënuan rritje të ndërlidhjes me BQK-në, Qeverinë Qendrore dhe bankat komerciale, për dallim nga viti paraprak ku shënuar rënie.

Ndërlidhjet ndërbankare janë të fokusuara kryesisht tek transaksionet afatshkurtra në formë të depozitave dhe linjave kreditore. Në periudhën raportuese, është vënë re rritje e ndërveprimit ndërmjet bankave me kapital të huaj që operojnë në Kosovë dhe bankave vendore, si dhe rritje e ndërveprimit ndërmjet bankave me origjinë nga vendi mëmë brenda tregut vendor, duke kontribuar në rritjen e ndërlidhjeve brenda sektorit bankar si dhe ndërlidhje më të theksuara brenda grupeve të njëjta të kapitalit. Ndërkohë, ndërlidhjet e drejtpërdrejta me bankat amë, e cila mbetet forma dominuese e ndërlidhjeve ndër bankarë, u intensifikuan në të dy drejtimet – si në huadhënie nga bankat vendore ndaj bankave amë, por veçanërisht në huamarrje. Këto zhvillime përforcojnë rëndësinë e monitorimit të marrëdhënieve me subjektet jashtë vendit, për shkak të rrezikut të transmetimit të goditjeve financiare nga jashtë përmes këtyre kanaleve (figura 2).

Në terma të përgjithshëm, ndërlidhjet në sistemin financiar mbeten të ulëta, por zhvillimet në kanalet kryesore të transmetimit të rrezikut – përmes ekspozimeve ndër bankarë, marrëdhënieve me sektorët tjerë financiarë dhe ekspozimeve ndaj bankave amë – kërkojnë vëmendje të shtuar në kuadër të mbikëqyrjes makroprudenciale dhe vlerësimit të rreziqeve të përhapjes.

Figura 2. Ndërlidhjet bankare të sektorit bankar të Kosovës



Burimi: BQK.

Shënim: madhësia e secilës nyje (rrethi) reflekton totalin e aseteve të secilit institucion bankar, përjashtuar bankat amë ku është marrë për bazë gjithsej kërkesat që i kanë bankat amë në formë të linjave kreditore apo borxhit të ndërvarur ndaj bankave përkatëse në vend. Drejtimi i shigjetave nënkupton kërkesa ndaj institucionit bankar të cilit i drejtohet shigjeta ndërsa trashësia e vizë-lidhëses dhe shigjetës reflekton nivelin apo madhësinë e ndërlidhjes. Gjendja është me dhjetor 2024.


4.1. Sektori bankar

Sektori bankar shënoi përsheptim të rritjes gjatë vitit 2024, duke reflektuar përmirësimin e kushteve makroekonomike dhe kërkesën e qëndrueshme për financim nga ekonomitë familjare dhe bizneset. Asetet e sektorit arritën në 8.56 miliardë euro, me rritje vjetore prej 13.5 përqind (nga 11.5 përqind në 2023), e udhëhequr nga zgjerimi i aktivitetit kreditues me normë vjetore të rritjes prej 18.3 përqind nga 13.0 përqind rritje në vitin paraprak.

Rritje u shënuar edhe në kategorinë e mjeteve likuide (para dhe bilanc me BQK-në), ndërsa investimet në letra me vlerë u ngadalësuan, kryesisht si rrjedhojë e tkurrjes së investimeve në tregjet e jashtme. Investimet në letra me vlerë të qeverisë së Kosovës shënuan kthesë pozitive pas rënies në dy vitet e mëparshme. Në të kundërt, bilancet me banka të tjera komerciale pësuan rënie, duke reflektuar riorientim të burimeve likuide në funksion të mbështetjes së kreditimit (Grafik 13).

Financimi i veprimtarisë së sektorit bankar vazhdon të mbështetet nga depozitat (Grafik 14), të cilat u karakterizuan me rritje vjetore të përsheptuar prej 13.0 përqind nga 10.4 përqind në dhjetor 2023.


Grafik 13. Pjesëmarrja në strukturën e aseteve



Burimi: BQK.

Të gjithë sektorët kontribuan në rritjen e përgjithshme të depozitave, me theks të veçantë korporatat financiare dhe publike – të përfaqësuara nga institucione me bazë të gjerë asetesh si fondet pensionale dhe ndërmarrjet publike.

Grafik 14. Pjesëmarrja në strukturën e detyrimeve dhe burimeve vetanake




Burimi: BQK.

Segmenti i depozitave të reja, përkatësisht depozitat e afatizuara, u karakterizua me rritje të përsheptuar, si reflektim i normave më atraktive të interesit dhe konkurrencës ndër bankarë për mbajtjen e depozitorëve të mëdhenj dhe klientëve institucional (Grafik 15).

Në fund të vitit 2024, gjithsej depozitat përfaqësuan 80.9 përqind të burimeve të financimit të sektorit bankar. Brenda kësaj strukture, depozitat e ekonomive familjare përbëjnë kategorinë më të madhe – me

pjesëmarrje prej 65.1 përqind – duke kontribuar në një bazë solide dhe më të qëndrueshme të financimit të sektorit.


Grafik 15. Stoku i gjithsej depozitave dhe depozitave të reja, në milionë euro



Burimi: BQK.

Por, tendenca e rritjes së përqendrimit te klientët institucional rritë ndjeshmërinë e sektorit ndaj zhvendosjeve të papritura të depozitave të mëdha, duke e bërë të nevojshme monitorimin e vazhdueshëm të profilit të peshës së depozitorëve dhe maturitetit të depozitave.


Grafik 16. Pozicioni neto ndaj jorezidentëve



Burimi: BQK.

Ekspozimi neto i sektorit bankar ndaj sektorit të jashtëm pësoi rënie për herë të parë pas dy viteve të rritjes, duke zbritur në 786.3 milionë euro (Grafik 16). Kjo rënie pasqyron tkurrjen e plasmanëve – depozitave dhe investimeve - jashtë vendit dhe njëkohësisht rritje të huamarrjes nga jashtë (Grafik 17).

Grafik 17. Kontributi i zërave në ndryshimin vjetor të aktivitetit me jorezidentët



Burimi: BQK.

Pavarësisht kësaj, ekspozimi ndaj sektorit të jashtëm mbetet i ulët dhe i përqendruar në instrumente me rrezik të ulët dhe në valutë euro, duke kufizuar potencialin për transmetim të rreziqeve nga jashtë. Kërkesat ndaj jo rezidentëve përfaqësuan 14.5 përqind të gjithsej aseteve të sektorit bankar, ndërsa detyrimet ndaj jo rezidentëve vetëm 5.3 përqind të gjithsej detyrimeve të sektorit bankar.

Kutia 2. Ngarkesa me Borxh e huamarrësve individual në Kosovë

Ngarkesa me borxh për huamarrësit në Kosovë është vlerësuar duke u bazuar në të dhënat për të gjithë klientët individualë që posedojnë së paku një produkt kreditor aktiv⁶, të raportuara në Regjistrin e Kredive të Kosovës (RKK) nga të gjitha institucionet bankare dhe mikrofinanciare deri në fund të dhjetorit 2024. Të dhënat përfshijnë 365,209 klientë me gjithsej 651,766 kredi aktive. Krahasuar me vitin e kaluar, numri i huamarrësve është rritur me 5.1


përqind, ndërsa numri i kredive aktive me 7.4 përqind. Analiza është zhvilluar sipas metodologjisë ekzistuese, duke përdorur tregues si: raporti i borxhit ndaj të ardhurave, vonesat në pagesa dhe përdorimi i shpeshtë i kredive (Tabelën 1).

Tabela 1. Rezultatet e treguesve objektiv të ngarkesës me borxh

Kategoria	Treguesi	Vlerësimi/Treguesi	Rezultati
Kosto e servisimit të borxhit: Borxhi ndaj të hyrave	Huamarrësit që shpenzojnë më shumë se 50% të hyrave bruto mujore në pagesën e borxhit (të siguruar dhe të pasiguruar)	<i>Indeksi i Ngarkesës me Borxh (shuma e kësteve mujore të të gjitha produkteve kreditore =>50% e të hyrave mujore të huamarrësit); (i kalkuluar për 282,771 huamarrës)</i>	29.5% e huamarrësve shfrytëzojnë mbi 50% të të hyrave në pagesën e kësteve kreditore
		<i>Indeksi i Ngarkesës me Borxh të Huave (shuma e kësteve mujore të huave aktive =>50% e të hyrave mujore të huamarrësit); (i kalkuluar për 225,500 huamarrës)</i>	27.4% e huamarrësve me hua aktive shfrytëzojnë mbi 50% të të hyrave në pagesën e kësteve kreditore vetëm për hua
Vonesat	Huamarrësit me vonesa më shumë se 2 muaj në pagesën e kontratave kreditore	<i>Huamarrësit me vonesa më shumë se 60 ditë (gjithsej 365,209 huamarrës)</i>	11.9% e huamarrësve kanë vonesa më shumë se 1 muaj në pagesën e kësteve kreditore. Ndërsa nga 197,366 huamarrës që kanë vetëm nga një kontratë kreditore 14.0% e tyre (apo 7.5% e gjithsej popullacionit të huamarrësve) janë në vonesë mbi 2 muaj .
Numri i kontratave kreditore	Ekonomitë familjare =>4 kontrata aktive kreditore	<i>Huamarrësit =>4 kontrata aktive kreditore (gjithsej 365,209 huamarrës)</i>	7.1% e huamarrësve kanë 4 apo më shumë se 4 kontrata aktive kreditore


Treguesi kryesor për vlerësimin e ngarkesës me borxh është Indeksi i ngarkesës me borxh, përlogaritur si raport i shumës së kësteve mujore ndaj të hyrave mujore të huamarrësit. Për të siguruar një matje sa më reale të ngarkesës, janë aplikuar trajtime përkatëse mbi të dhënat e të hyrave dhe kësteve mujore në disa observime ku këto informacione kanë munguar, duke ndjekur të njëjtën qasje si në analizat e mëparshme.

Grafik 1. Shpërndarja e huamarrësve fizik sipas indeksit të ngarkesës



Burimi: BQK.

Grafik 2. Huamarrësit sipas produkteve kreditore (323,029 huamarrës me llogari të shfrytëzuara)
Gjithë numri i huamarrësve që posedojnë produktet e mëposhtme:



Rrjedhimisht, bazuar në disponueshmërinë e të dhënave dhe trajtimet e aplikuar përkatëse, është arritur të vlerësohet niveli i ngarkesës me borxh për 77.4 përqind të gjithsej huamarrësve në regjistër të kredive (RKK)⁷.

⁶ Me produkt kreditor nënkuptojmë të gjitha produktet që përfaqësojnë borxh/huamarrje, përfshirë këtu kreditkartelat dhe mbitërheqjet

⁷ Mungesat e informacionit mbi këstet kreditore janë trajtuar në mënyrë të diferencuar sipas llojit të produktit kreditor. Pas këtyre

trajtimeve, informacioni mbi këstet ishte i disponueshëm për 88.4% të huamarrësve, ndërsa në 11.6% të rasteve kësti rezultoi zero, duke reflektuar bilancet e pasfrytëzuara të produkteve si kartelat kreditore dhe mbitërheqjet. Si rezultat i mungesës së informacionit për të hyrat e disa huamarrësve dhe bilanceve zero të kësteve kreditore në raste të tjera, indeksi i ngarkesës mungon për 13.1% të

Rezultatet e këtij vlerësimi sugjerojnë se 29.5 përqind e këtyre huamarrësve⁸, janë të mbingarkuar me borxh. Nga ta, 17.33 përqind ndodhen në fazën e parë të mbingarkesës, pra, në rrezik për mbingarkesë ku kësti mujor përbën 50 deri në 75 përqind të të hyrave mujore. Ndërkohë, 7.67 përqind e huamarrësve ndodhen në fazën kritike, ndërsa 4.53 përqind janë në gjendje jo-solvente, ku këstet mujore tejkalojnë tërësisht të hyrat mujore bruto (grafik 3).

Megjithatë, ky vlerësim bazohet vetëm në të hyrat individuale të huamarrësit dhe nuk merr parasysh të hyrat e njësisë familjare, të bashkë huamarrësit apo burime të tjera të mundshme të të hyrave. Si rrjedhojë, kjo qasje nuk pasqyron plotësisht aftësinë reale paguese të huamarrësve. Andaj, përqindja e raportuar e huamarrësve të mbingarkuar mund të jetë e mbivlerësuar dhe nuk duhet interpretuar si tregues i drejtpërdrejtë dhe i paanshëm i aftësisë për shlyerjen e borxhit. Përkundrazi, ky vlerësim duhet konsideruar si një tregues orientues dhe indikativ, dhe aktualisht si treguesi më me potencial në dispozicion, që informon mbi nivelin e ngarkesës me borxh të huamarrësve. Treguesishfaq konsistencë ndër vite, me një tendencë të lehtë rritëse, dhe njëkohësisht nënvizon nevojën për të dhëna më gjithëpërfshirëse dhe për një qasje më të integruar për vlerësim sa më përmajtësor të ngarkesës.

(Grafik 3).




Tabela 3. Mesatarja dhe mediana e të hyrave, këstit, shumës së aprovuar dhe të mbetur të huave

Të hyrat dhe kësti (në euro)	Mesatarja			Mediana		
	2022	2023	2024	2022	2023	2024
Të hyrat	787	829	881	488	508	550
Kësti gjithsej	203	242	251	127	141	153
Kësti hua	169	203	209	106	117	132
Shuma e aprovuar në hua	11,498	12,612	14,254	5,600	6,150	7,200
Shuma e mbetur aktive në hua (outstanding amount)	8,334	9,377	10,767	3,432	4,000	4,604

Ndër faktorët socio-demografikë me ndikim në mbingarkesën me borxh, statusi martesor doli i rëndësishëm statistikisht, ku huamarrësit e martuar janë më të mbingarkuar, që mund të jetë kryesisht për shkak të kredive me bashkë huamarrje që nuk janë plotësisht të

Probabiliteti i mbingarkesës rezulton më i lartë te huamarrësit që kanë tri apo më shumë kontrata aktive kreditore (51.5 përqind e tyre), si dhe te ata që kanë kredi njëkohësisht në të dy sektorët, bankar dhe mikrofinanciar. Kjo sugjeron se huamarrja e shumëfishtë, pra posedimi i disa kontratave aktive kreditore në institucione të ndryshme, asocohet me nivelin më të lartë të mbingarkesës (tabela 2). Pjesëmarrja e huamarrësve me më shumë se një kontratë është rritur për 1.7 pikë përqindje krahasuar me vitin e kaluar (tabela 2). Huamarrësit me kredi në institucione të ndryshme përbënin 47.7 përqind të rasteve të mbingarkesës, krahasuar me 40.2 përqind të huamarrësve që kanë disa kontrata kreditore, por vetëm brenda një institucioni. Në vitin e kaluar, këto raporte ishin përkatësisht 45.9 dhe 39.7 përqind.

Duke analizuar nivelin e ngarkesës sipas sektorëve, mbingarkesa rezulton më e lartë në mesin e huamarrësve me kredi aktive në sektorin bankar, ku 29.2 përqind e tyre janë të mbingarkuar, krahasuar me 20.2 përqind të huamarrësve me kredi vetëm në sektorin mikrofinanciar, me rritje më të theksuar në këtë të fundit prej 2.2 pikë përqind nga viti i kaluar (rritje prej 0.6 pikë përqind në sektorin bankar).

Të pasurit histori kreditore dhe kontrata të mbështetura me kolateral janë të ndërlidhura me nivele më të larta të ngarkesës me borxh. Po ashtu, performanca më e dobët e pagesave të kësteve mund të reflektojnë ngarkesën e lartë, meqë pjesa më e madhe e rasteve të mbingarkesës paraqitet tek huamarrësit që kanë vonesa në pagesën e kësteve prej 90–180 ditë dhe mbi 180 ditë (tabela 3).

reflektuara në të dhëna. Mbingarkesa është më e lartë edhe në rajonet e Prizrenit dhe Prishtinës, te grupmoshat 41–60 vjeç dhe te huamarrësit me të hyra 170–250 euro. Në të gjitha këto kategori, pjesëmarrja e të mbingarkuarve është rritur nga viti i kaluar (tabela 3).

rasteve ose merr vlerë zero për 9.4% të rasteve (që përfaqësojnë bilancet e pashfrytëzuar).


⁸ Për të cilët është vlerësuar treguesi i ngarkesës me borxh.

Tabela 3. Ngarkesa me borxh e huamarrësve sipas karakteristikave socio-demografike dhe socio-ekonomike si dhe të modeleve të huamarrjes

Karakteristikat	Të pa ngarkuar (kësti mujor < 50% e të hyrave të EF)	Të mbingarkuar (kësti mujor > 50% e të hyrave të EF)		
		Në rrezik (borxh/të hyra = 50%-75%)	Në fazë kritike (borxh/të hyra = 75%-100%)	Josolvent (borxh/të hyra = mbi 100%)
NGARKESA ME BORXH SIPAS KARAKTERISTIKAVE SOCIO-DEMOGRAFIKE DHE SOCIO-EKONOMIKE TË HUAMARRËSIT INDIVIDUAL				
Gjinia e huamarrësit				
Grua	70.9%	17.3%	7.7%	4.1%
Burrë	70.2%	17.4%	7.7%	4.7%
Statusi martesor i huamarrësit respektiv				
Ve martuar	67.8%	18.5%	8.6%	5.1%
Ve ndarë	73.6%	15.7%	6.4%	4.4%
Ve pamartuar	75.2%	15.3%	6.1%	3.4%
Lloji i huamarrësit				
Fizik rezident	70.5%	17.3%	7.7%	4.5%
Fizik jo-rezident	78.9%	10.5%	4.8%	5.8%
Rajoni i huamarrësit respektiv				
Ferizaj	71.5%	16.2%	8.1%	4.2%
Gjakovë	71.7%	16.7%	7.5%	4.1%
Gjilan	71.1%	17.0%	7.4%	4.5%
Mitrovicë	71.3%	16.7%	7.8%	4.2%
Pejë	72.3%	17.0%	6.7%	4.0%
Prishtinë	70.6%	17.2%	7.8%	4.5%
Prizren	69.1%	18.2%	7.8%	4.9%
Mosha e huamarrësit respektiv				
< 30 vjet	77.3%	13.9%	5.7%	3.2%
30 - 40 vjet	68.1%	18.8%	8.3%	4.9%
40 - 50 vjet	67.2%	19.0%	8.7%	5.2%
50- 60 vjet	67.7%	18.8%	8.6%	4.9%
> 60 vjet	81.9%	8.8%	4.6%	4.7%
Niveli i të hyrave të huamarrësit				
deri në 170 euro	29.5%	22.6%	21.4%	26.5%
170-249 euro	57.4%	18.5%	13.4%	10.7%
250-449 euro	66.2%	18.8%	9.8%	5.2%
450-749 euro	67.6%	20.8%	8.0%	3.6%
750-999 euro	75.1%	16.7%	5.5%	2.7%
1000-2000 euro	82.2%	11.2%	3.6%	3.0%
mbi 2000 euro	90.0%	5.6%	1.9%	2.5%
MODELET E HUAMARRJES				
Ngarkesa me borxh sipas numrit të kontratave kreditore				
Një kontratë aktive kreditore	87.7%	7.2%	3.1%	2.0%
Dy kontrata aktive	67.4%	20.9%	7.5%	4.2%
Tri kontrata aktive	51.5%	29.7%	12.7%	6.1%
Katër e më shumë kontrata aktive kreditore	33.0%	31.4%	21.0%	14.7%
Ngarkesa sipas llojit të kontratave kreditore				
Hua, lizing, kredi hipotekare	63.9%	21.3%	9.4%	5.5%
Mbitërheqje me bilanc të shfrytëzuar	51.9%	25.4%	13.6%	9.1%
Kreditkartelë me bilanc pozitiv të shfrytëzuar	66.8%	19.8%	8.7%	4.7%
Ngarkesa sipas llojit të institucionit huadhënës				
Bankë	70.8%	18.9%	6.8%	3.5%
Mikrofinancë	79.8%	10.5%	5.7%	4.0%
Bankë dhe Mikrofinancë njëkohësisht	48.6%	24.7%	16.3%	10.4%
Ngarkesa sipas huamarrjes së shumefishtë dhe në institucione të ndryshme				
Shumë kontrata - një institucion kredidhënës	59.8%	26.8%	9.0%	4.4%
Shumë kontrata - disa institucione kredidhënëse	52.3%	24.3%	14.3%	9.1%
Ngarkesa sipas historisë kreditore				
Asnjë kontratë të mbyllur	81.8%	11.1%	4.3%	2.7%
Të paktën një kontratë të mbyllur	66.0%	19.8%	9.0%	5.2%
Ngarkesa sipas kontratave të kolateralizuara				
Asnjë kontratë aktive të kolateralizuar	80.0%	12.5%	5.0%	2.6%
Të paktën një kontratë të kolateralizuar	58.9%	23.2%	11.0%	6.9%
Ngarkesa me borxh sipas klasifikimeve kreditore (vonesave në pagesën e obligimeve kreditore)				
Në kohë, apo me vonesë <30 ditë	70.3%	17.6%	7.7%	4.3%
Vonesë 30- 60 ditë	69.6%	16.1%	8.1%	6.2%
Vonesë 60-90 ditë	69.9%	16.1%	7.8%	6.2%
Vonesë 90 - 180 ditë	68.8%	16.3%	8.1%	6.8%
Vonesë > 180 ditë	72.0%	14.3%	7.0%	6.7%
Shlyerjet	79.1%	11.0%	6.6%	3.3%

Tendencat për vonesë në pagesën e kësteve ndjekin modele të ngjashme me ato të mbingarkesës, me përjashtim të **statusit martesor**, ku huamarrësit e pa-martuar shfaqin më shumë raste të vonesës. Po ashtu, vonesat janë më të shpeshta në grup-moshën 31–40 vjeç.


Grafik 4a. Performanca e pagesës së huamarrësve sipas numrit të



Burimi: BQK.


Ndër faktorët e modeleve të huamarrjes me ndikim në vonesat e pagesës, me rëndësi statistikore rezultojnë numri i kontratave, kolateralizimi, sektori huadhënës, historia kreditore dhe huamarrja e shumëfishtë. Vonesat janë më të shpeshta te huamarrësit me një ose dy kontrata, me rritje nga viti i kaluar, ndërsa pjesëmarrja e atyre me mbi tri kontrata është zvogëluar (Grafik 4a). Këtë vit, vonesat janë më të shpeshta në kontratat pa kolateral, ndryshe nga viti i kaluar kur dominonin ato të kolateralizuara (Grafik 4b). Po ashtu, huamarrësit me kredi vetëm në mikrofinanca shfaqin tendenca më të larta të vonesave (Grafik 4c).

Grafik 4b. Performanca e pagesës së huamarrësve sipas kolateralizimit



Burimi: BQK.


Grafik 4c. Performanca e pagesës së huamarrësve sipas llojit të institucionit huadhënës



Burimi: BQK.

Vonesat janë më të shprehura tek huamarrësit pa histori kreditore, pra ata që nuk kanë kontrata të mbyllura kreditore, duke treguar prirje të kundërt krahasuar me vitin e kaluar. Kjo sjellje dallon me modelin e mbingarkesës me borxh, ku numri më i lartë i huamarrësve të mbingarkuar rezultojnë tek ata me histori kreditore (Grafik 4d).


Grafik 4d. Performanca e pagesës së huamarrësve sipas historisë kreditore



Burimi: BQK.


Gjithashtu, vonesat janë më të shpeshta te huamarrësit me më shumë se një kontratë aktive dhe nga institucione të ndryshme (Grafik 4e). Rreth 16.9 përqind e huamarrësve me produkte kreditore në institucione të ndryshme janë në vonesë, krahasuar me vetëm 3.4 përqind të atyre me disa kontrata në të njëjtin institucion (Grafik 4e).

Grafik 4e. Performanca e pagesës sipas numrit të kontratave kreditore dhe institucioneve huadhënëse



Pjesëmarrja e huamarrësve që përdorin mbitërheqje është rritur lehtë, ndërsa ajo e përdoruesve të kreditkartelave është zvogëluar (Grafik 5). Gjithashtu, ngarkesa me borxh për produktin mbitërheqje është rritur lehtësisht krahasuar me vitin paraprak.

Grafik 5. Produktet tjera kreditore dhe bilancet e shfrytëzuara



Përfundimisht, mbingarkesa me borxh është vlerësuar përmes tre treguesve kryesorë: indeksi i ngarkesës, vonesat në pagesën e kësteve dhe numri i kontratave kreditore, të cilët së bashku japin pasqyrë të rëndësishme mbi ngarkesën me borxh të huamarrësve në Kosovë. Edhe pse rezultatet tregojnë lidhje mes mbingarkesës, numrit të produkteve kreditore dhe vonesave në pagesa, ky relacion shkak - pasojë ndërmjet këtyre faktorëve nuk është determinues, dhe mund të zhvillohet në kahje të ndryshme. Posedimi i më shumë kontratave mund të rrisë ngarkesën mujore, por vetë prania e disa kontratave apo vonesave në pagesa nuk duhet domosdoshmërisht të interpretohet edhe si mosaftësi paguese të huamarrësit për shlyerjen e borxhit.

Megjithëse rezultatet e analizës ofrojnë një pasqyrë të dobishme mbi zhvillimet e ngarkesës me borxh, ato mund të jenë të kufizuara për shkak të cilësisë së të dhënave dhe supozimeve të bëra si pasojë e mungesës së disa informacioneve. Sidoqoftë, këto çështje të lidhura me disponueshmërinë dhe cilësinë e të dhënave janë adresuar përmes udhëzuesit të ri metodologjik për raportim kreditor në Regjistrin e Kredive të Kosovës (RKK), i cili është në fuqi nga qershori 2025 dhe mbi bazën e të cilit bankat do të raportojnë tutje. Ky udhëzues përfshin përditësimin e metodologjisë së raportimit në RKK, duke trajtuar njëkohësisht si zgjerimin e përfshirjes, ashtu edhe përmirësimin e cilësisë së të dhënave. Këto zhvillime do të kontribuojnë drejtpërdrejt në avansim të analizave dhe më konkretisht rritje të kapacitetit statistikor për vlerësim më të plotë dhe më përmbajtësor e relevant të ngarkesës me borxh. Duke pasur parasysh natyrën komplekse dhe rëndësinë e çështjes së borxhit, përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë dhe plotësimi të të dhënave mbetet thelbësor dhe në fokus të BQK-së për informim real të gjendjes dhe të politikëbërjes.


Tabela 5. Karakteristikat socio-demografike dhe socio-ekonomike dhe të modelev e të huamarrjes

Karakteristikat socio-demografike dhe socio-ekonomike të huamarrësit individual	Pjesëmarrja(%)	Numri/Frekuenca
Numri i huamarrësve: 365,209		
Numri i kontratave aktive kreditore: 651,766		
KARAKTERISTIKAT SOCIO-DEMOGRAFIKE DHE SOCIO-EKONOMIKE TË HUAMARRËSIT INDIVIDUAL		
Gjinia e huamarrësit		
Grua	33.9%	122,304
Burrë	66.1%	238,418
Statusi martesor i huamarrësit respektiv		
I/e martuar	60.1%	217,241
I/e ndarë	0.5%	1,880
I/e pamartuar	39.4%	142,633
Lloji i huamarrësit		
Fizik rezident	99.7%	363,971
Fizik jo-rezident	0.3%	1,238
Rajoni i huamarrësit respektiv		
Ferizaj	3.6%	13,073
Gjakovë	15.2%	55,598
Gjilan	13.2%	48,031
Mitrovicë	6.1%	22,081
Pejë	1.7%	6,033
Prishtinë	30.1%	109,778
Prizren	30.2%	110,240
Mosha e huamarrësit respektiv		
< 30 vjet	24.8%	90,625
30 - 40 vjet	26.9%	98,116
40 - 50 vjet	22.2%	80,928
50- 60 vjet	22.6%	82,440
> 60 vjet	3.6%	13,098
Niveli i të hyrave të huamarrësit		
deri në 170 euro	1.6%	5,010
170-249 euro	5.5%	17,482
250-449 euro	28.7%	90,890
450-749 euro	33.5%	108,149
750-999 euro	10.8%	34,095
1000-2000 euro	13.7%	43,577
mbi 2000 euro	6.3%	19,986
MODELET E HUAMARRJES		
Numri huamarrësve sipas numrit të kontratave kreditore		
Një kontratë aktive kreditore	54.0%	197,368
Dy kontrata aktive	23.7%	88,499
Tri kontrata aktive	15.2%	55,343
Katër e më shumë kontrata aktive kreditore	7.1%	25,999
Numri huamarrësve sipas llojit të kontratave kreditore		
Hua, lizing, kredi hipotekare	71.3%	260,327
M bitërheqje me bilanc pozitiv	11.3%	41,123
Kreditkartelë me bilanc pozitiv	38.1%	139,247
Produkte tjera kreditore	0.01%	24
Numri huamarrësve sipas numrit të institucioneve		
Klient me kontratë në vetëm një institucion	79.7%	291,136
Klient me kontrata në disa institucione	20.3%	74,073
Numri huamarrësve sipas llojit të institucionit huadhënës		
Bankë	61.5%	224,554
Mikrofinancë	28.6%	104,445
Bankë dhe Mikrofinancë njëkohësisht	9.9%	36,206
Numri huamarrësve sipas historisë kreditore		
Asnjë kontratë të mbyllur	34.4%	125,619
Të paktën një kontratë të mbyllur	65.6%	239,590
Numri huamarrësve sipas kontratave të kolateralizuara		
Asnjë kontratë aktive të kolateralizuar	63.3%	231,043
Të paktën një kontratë të kolateralizuar	36.7%	134,166

4.1.1 Zhvillimet kreditore

Në vitin 2024, aktiviteti kreditues i sektorit bankar shënoi rritje nominale prej 18.3 përqind, duke përsheptuar ritmin e rritjes vjetore për 5.3 pikë përqindje. Kjo dinamikë u ndikua nga zhvillimet në gjysmën e dytë të vitit, e cila karakterizua me rritje më të lartë vjetore, përderisa në gjysmën e parë është shënuar ngadalësim i rritjes vjetore.


Grafik 18. Rritja vjetore e kredive për ndërmarrje dhe ekonomitë familjare



Burimi: BQK.

Rritja u mbështet nga kërkesa më e lartë për financim si nga ekonomitë familjare, ashtu edhe nga korporatat jo-financiare (Grafik 18 dhe 19), e përforcuar nga përmirësimi i besimit konsumator, rënia e normave të interesit (EURIBOR), dhe mbështetja institucionale për përfshirje më të gjerë financiare.

Grafik 19. Stoku i gjithsej kredive dhe kredive të reja për ndërmarrje dhe ekonomitë familjare, në milionë euro




Burimi: BQK.

Sipas Anketës së Kreditimit Bankar, kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare dhe NVM-të mbeti e lartë, ndërkohë që standardet e kreditimit u lehtësuan në disa segmente, por me ruajtje të një qasjeje të kujdesshme ndaj rrezikut nga bankat.

Segmenti i korporatave jofinanciare shënoi rritje vjetore të stokut të kredive prej 15.3 përqind, për 5.2 pikë përqindje më e lartë se vitin paraprak. Ky zhvillim u ndikua kryesisht nga rritja e kredive të reja investive, të cilat shënuan rritje prej 42.2 përqind nga 3.6 përqind një vit më parë. Në kuadër të këtyre kredive, me rritje u karakterizuan kreditë për sektorin e shërbimeve dhe industrisë, prej 51.4 përqind dhe 50.5 përqind, përkatësisht. Ndërsa, kreditë për qëllime jo-investive shënuan rënie prej 10.5 përqind nga rritja prej 15.6 përqind një vit më parë, dhe si rezultat kishin kontribut negativ në rritjen e gjithsej kredive të reja për korporatat jo-financiare.

Aktiviteti kreditues ndaj KJF-ve, sipas sektorëve ekonomik, u karakterizua me përsheptim të rritjes në sektorë të caktuar si tregtia me shumicë, shërbimet financiare dhe prodhimi, përkundër që aktiviteti ekonomik i këtyre sektorëve ka shënuar ngadalësim të rritjes reale. Ndërsa, kreditimi ndaj sektorit të bujqësisë ka shënuar rënie, përkundër rritjes së aktivitetit ekonomik të këtij sektori (Grafik 20).

Grafik 20. Stoku i kredive sipas sektorëve të ekonomisë




Burimi: BQK.

Një mbështetje e rëndësishme për kreditimin e NVM-ve ishte Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK), që në fund të vitit 2024 garantonte 23.4 përqind të stokut të kredive për korporatat jo financiare – rritje vjetore për 2.2 pikë përqindje. Struktura e kredive të garantuara nga FKGK mbetet përfaqësim i strukturës së përgjithshme të kredive të sektorit bankar me fokus në sektorë si tregtia (41.9 përqind), shërbimet (22.7 përqind) dhe

prodhimi (19.9 përqind). Pjesa e mbetur përbëhet nga sektori i ndërtimtarisë (7.5 përqind) dhe bujqësisë 8.0 përqind të gjithsej portofolios garantuese (Grafik 21).

Grafik 21. Kreditë e aprovuara dhe të garantuara nga FKGK



Burimi: FKGK.


Në segmentin e ekonomive familjare, kreditimi shënoi rritje të përshpejtuar, prej 22.0 përqind nga 17.3 përqind në vitin paraprak. Kreditë e reja konsumuese/personale shënuan përshpejtim të rritjes, në 27.1 përqind nga 23.2 përqind. Krahas tyre, ndryshe nga viti i kaluar, ndikim pozitiv në rritje dhanë edhe kreditë e reja hipotekare, të cilat e rikthyen trendin e rritjes, duke u rritur me 37.9 përqind, pas një rënieje prej 11.3 përqind në vitin paraprak. Gjithsej kreditë e reja për këtë segment shënuan rritje prej 27.9 përqind (Grafik 21).

Struktura e maturimit të stokut të gjithsej kredive u zhvendos më tej drejt kredive afatgjata⁹, të cilat përfaqësuan 55.6 përqind portofolios kreditore. Në këtë dinamikë ka ndikuar rritja vjetore e kredive të reja hipotekare prej ekonomive familjare si dhe rritja e kredive investive prej korporatave jo-financiare, pasi që kryesisht janë kredi me afat të gjatë maturiteti. Kreditë afatshkurtra gjithashtu shënuan rritje të theksuar vjetore dhe rritje të pjesëmarrjes. Kjo dinamikë është ndikuar nga rritja e kredive të reja konsumuese prej ekonomive familjare dhe e kredive të reja prej korporatave jo-financiare,

⁹ Periudha afatshkurter përfshinë maturitetin deri në 1 vit, afatmesme përfshinë maturitetin prej 1 deri në 5 vite, dhe periudha afatgjatë përfshinë maturitetin mbi 5 vite.

që reflekton kërkesë të shtuar për likuiditet afatshkurter (Grafik 22 dhe 23).


Grafik 22. Kreditë e ndërmarrjeve, pjesëmarrja sipas maturitetit



Burimi: BQK.

Rritja e përshpejtuar e kreditimit në vitin 2024, veçanërisht në segmentin e ekonomive familjare dhe përmes kredive afatgjata, ka ndryshuar gradualisht profilin e rrezikut të sektorit bankar.

Grafik 23. Kreditë e ekonomive familjare, pjesëmarrja sipas maturitetit



Burimi: BQK.

Zhvendosja drejt kredive me maturitet më të gjatë rrit ekspozimin e bankave ndaj rreziqeve të normave të interesit dhe cikleve të pasigurta ekonomike, ndërkohë që rritja e kredive konsumuese dhe hipotekare në segmentin e ekonomive familjare, tradicionalisht më të qëndrueshme, mbetet e nevojshme të vlerësohet nga këndvështrimi i aftësisë paguese në afat të gjatë. Kjo kërkon vigjilencë të shtuar në menaxhimin e rrezikut të kredisë dhe ruajtjen e standardeve prudente të huadhënies, në mënyrë që të garantohet qëndrueshmëria e zgjerimit kreditues në periudhën vijuese.

Kutia 3. Anketa e Kreditimit Bankar të Kosovës¹⁰


Rezultatet e Anketës së Kreditimit Bankar të Kosovës¹¹ pasqyrojnë zhvillimet në aktivitetin e kreditimit bankar gjatë periudhës TM1 2024 – TM4 2024 (referuar si viti 2024), si dhe pritjet për aktivitetin kreditues në periudhën janar - qershor 2025 (referuar si gjashtëmuajori i parë i vitit vijues - 6M1).

Bazuar në rezultatet e anketës, dinamikat e kreditimit gjatë vitit 2024 u ndikuan kryesisht nga kërkesa kreditore, ndërsa oferta kreditore kishte ndikim më të ulët. Ndërmarrjet e mëdha u karakterizuan me ofertë kryesisht të pandryshuar, ndërsa lehtësime marginale u aplikuan për NVM-të. Për ekonomitë familjare oferta u lehtësua në përgjithësi, veçanërisht për kreditë konsumuese. Në anën tjetër, kërkesa kreditore vazhdon të jetë e lartë

nga të dy segmentet, si nga ndërmarrjet edhe nga ekonomitë familjare.

Standardet kreditore për ndërmarrjet në përgjithësi mbeten të pandryshuara, veçanërisht për ndërmarrjet e mëdha dhe kreditë afatgjata, ndërsa për NVM-të dhe kreditë afatshkurtra kishte lehtësim marginal të standardeve të aplikuara (grafik 1). Në kahun lehtësues të ofertës kreditore ndikuan mbështetja nga FKGK-ja, rënia e normës së Euribor-it dhe pozita e mirë e likuiditetit. Ndërsa, në kahun shtrëngues deri në një masë ndikuan shqetësimet lidhur me perspektiven e tregjeve globale dhe toleranca më e ulët e bankave ndaj rrezikut. Për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2025, bankat deklaruan se do të aplikojnë shtrëngim marginal të standardeve për ndërmarrjet e mëdha, kurse lehtësim marginal për NVM-të.

Grafiku 1. Standardet kreditore të aplikuara për ndërmarrjet



Në kuadër të ofertës kreditore, kushtet dhe rregullat e aplikuara me rastin e dhënies së kredive për të dy segmentet e ndërmarrjeve kishin lëvizje pozitive në kërkesat për kolateral dhe madhësinë mesatare të kredisë, kurse shtrëngime marginale në maturitet. Ndërsa, sa i përket normës së interesit, kishte lehtësim marginal për NVM-të, kurse

shtrëngim marginal për ndërmarrjet e mëdha (grafik 2).

Në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2025, kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat pritet të kenë lëvizje në të dy kahjet. Konkretisht, pritet lehtësim për të dy kategoritë e ndërmarrjeve në kërkesën mbi kolateral, ndërsa shtrëngim në normën e interesit. Faktorët që pritet të


¹⁰ Anketa e Kreditimit Bankar të Kosovës realizohet nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës me 11 bankat që operojnë në Kosovë. Anketa realizohet në baza tremujore. Kjo anketë përfshinë të dhënat e agreguara të secilit kuartal të vitit 2024 si dhe pritjeve për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2025.

¹¹ Përgjigjet e bankave individuale janë agreguar duke përdorur peshën përkatëse të çdo banke në gjithsej portofolin kreditore të sektorit bankar. Vlerat pozitive e indeksit të standardeve kreditore tregojnë lehtësim dhe vlerat negative tregojnë shtrëngim. Gjithashtu, vlerat pozitive e indeksit të kërkesës për kredi tregojnë rritje të kërkesës dhe vlerat negative tregojnë rënie. Më gjerësisht metodologjinë e përdorur mund ta gjeni në Raportin e Anketës së Kreditimit Bankar në ëeb faqen e BQK.

mbështesin lehtësimin e kushteve janë mbështetja e FKGG-së, pozita e kënaqshme me likuiditet dhe konkurrenca nga institucionet bankare dhe jobankare. Kurse, toleranca më e ulët ndaj rrezikut pritet të ndikojnë deri në një masë në shtrëngim.

Gjatë vitit 2024, niveli i aprovimit për ndërmarrjet ka shënuar rritje të lartë, veçanërisht për NVM-të, në përputhje me rritjen e kërkesës kreditore.


Grafik 2. Kushtet dhe rregullat e aplikuara në standardet kreditore për ndërmarrjet



Burimi: BQK.

Sipas rezultateve të anketës, kërkesa për kredi nga ndërmarrjet ishte e lartë në përgjithësi, e nga NVM-të në veçanti (grafik 3).

Grafiku 3. Kërkesa për kredi nga ndërmarrjet




Burimi: BQK.

Kjo rritje e kërkesës u nxit kryesisht nga nevoja për financimin e kapitalit punues dhe investimeve fikse. Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2025, bankat presin që kërkesa për kredi nga segmenti i ndërmarrjeve të jetë e lartë, si nga NVM-të edhe nga ndërmarrjet e mëdha. Ashtu si në vitin paraprak, rritja e kërkesës për financimin e kapitalit punues dhe investimeve fikse, janë faktorët që do të përcaktojnë kërkesën për kredi.

Sa i përket cilësisë së portofolios kreditore të ndërmarrjeve, bankat raportuan për rënie të

lehtë të nivelit të kredive joperformuese. Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2025, presin që raporti i kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive të mbetet pothuajse i njëjtë, me tendencë të lehtë rënëse. Standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare u lehtësuan deri në një masë në përgjithësi, me theks të veçantë për kreditë konsumuese (grafik 4). Faktorët që ndikuan këtë dinamikë ishin përmirësimi i kushteve të tregut, konkurrenca e shtuar, rritja e besueshmërisë konsumatore, si dhe pozita e kënaqshme e likuiditetit.

Grafiku 4. Standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare




Burimi: BQK.

Pritjet e bankave për gjashtëmujorin e parë të vitit 2025 reflektojnë lehtësime në përgjithësi për segmentin e ekonomive familjare, si për kreditë konsumuese edhe për kreditë për blerje të shtëpive.

Kushtet dhe rregullat për kreditë e reja për ekonomitë familjare u lehtësuan deri në një masë (grafik 5). Konkretisht, bankat aplikuan

lehtësim të normës së interesit, rritje të madhësinë mesatare të kredisë, zgjatje të maturitetit dhe lehtësim të kërkesës për kolateral. Konkurrenca e shtuar mes bankave, perspektiva e tregut bankar dhe pozita e favorshme likuide ishin faktorët kryesor që kontribuuan në lehtësim të kushteve dhe rregullave për kreditë ndaj ekonomive familjare.

Grafik 5. Kushtet dhe rregullat e aplikuara në standardet kreditore për ekonomitë familjare




Burimi: BQK.

Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2025, bankat prisnin lehtësim në kushtet dhe rregullat e aplikuara, me theks të veçantë në maturitet dhe madhësinë mesatare të kredisë, si për kreditë për blerje të patundshmërive edhe për kreditë konsumuese. Ndërkohë, kushtet dhe rregullat e tjera pritet të kenë ndryshime marginale në të dy kahjet. Konkretisht, pritet

shtërngim në normën e interesit për kreditë për blerje të patundshmërive, ndërsa lehtësim në kërkesën për kolateral.

Gjatë vitit 2024, niveli i aprovimit të kredive për ekonomitë familjare ka shënuar rritje të lartë, veçanërisht për kreditë konsumuese.

Grafik 6. Kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare




Burimi: BQK

Bazuar në rezultatet e anketës, kërkesa për kredi shënoi rritje të konsiderueshme për të dy segmentet, me rritje më të theksuar për kreditë konsumuese (grafik 6). Nevoja për financim të shpenzimeve të tjera për konsum kishte kontributin kryesor në rritje të kërkesës për kredi, pasuar nga perspektiva pozitive e tregut të patundshmërive dhe rritja e besueshmërisë konsumatore.

Në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2025, kërkesa për kredi pritet të rritet tutje, si për kreditë konsumuese edhe ato për blerje të patundshmërive.

Sipas anketës, raporti i kredive jo-performuese ndaj gjithsej kredive për ekonomitë familjare shënoi rritje të lehtë, ndërsa për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2025 pritet të shënoi rënie.

Grafik 7. Ndryshimi në financimin e e sektorit bankar



Burimi: BQK

Sa i përket dinamikave në financim, bankat raportuan rritje të **qasjes në financim** gjatë vitit 2024, megjithatë me e ulët krahasuar me një vit më parë. Depozitat e ekonomive familjare kishin rritjen më të madhe, pasuar

financimi nga ndërmarrjet. Po ashtu, gjatë vitit 2024 rritje ka shënuar edhe financimi nga bankat amë dhe prej institucioneve financiare ndërkombëtare, për dallim nga viti paraprak ku financimi nga këto burime mbeti i pandryshuar nga një vit më parë.


5. Rreziqet e sektorit bankar

5.1. Rreziku kreditor

Rreziku kreditor mbeti i qëndrueshëm gjatë vitit 2024, me tregues të qëndrueshëm të cilësisë së portofolit në nivel të përgjithshëm, pavarësisht rritjes së vlerës nominale së kredive jo-performuese (KJP). Përshpejtimi i aktivitetit kreditues kundrejt rritjes së aktivitetit ekonomik ka rritur potencialin për akumulim të rrezikut kreditor, duke shtuar edhe pritjet për rritje të vlerës së KJP-ve. Megjithatë, raporti i KJP-ve ndaj totalit të portofolit kreditues u ul lehtë në 1.9 përqind në dhjetor 2024 nga 2.0 përqind në fund të vitit paraprak, çka sugjeron qëndrueshmëri të sektorit bankar përballë sfidave si inflacioni i lartë dhe flukset e pritura të migracionit, të cilat nuk materializuan dhe nuk u reflektuan në përkeqësim të cilësisë së portofolit.

Në vlerë, KJP-të arritën 109.3 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 11.0 përqind (Grafik 24). Rritja më e theksuar u regjistrua në tremujorin e dytë dhe të tretë (me 21.2 dhe 22.5 përqind rritje), periudha në të cilat rritja e vlerës së KJP-ve e tejkaloi edhe rritjen e stokut të kredive. Kjo rritje, megjithatë, u ndikua kryesisht nga faktorë idiosinkratikë të dy bankave, që kontribuan në mënyrë të pabarabartë në rritjen e KJP-ve, dhe nuk pasqyron një përkeqësim sistemik të cilësisë së portofolit.

Grafik 24. Rritja vjetore e stokut të kredisë dhe kredive joperformuese




Burimi: BQK.

Në aspektin e klasifikimit të portofolit sipas shtyllave, struktura ka shënuar

përmirësim krahasuar me vitin paraprak, kryesisht përmes rritjes së pjesëmarrjes së kredive në shtyllën e parë. Ndryshe nga viti 2023, kur u regjistrua një rritje më e theksuar e kredive të kategorizuara në shtyllën e dytë, gjatë vitit 2024 kjo kategori u zvogëlua, duke iu kthyer peshës së saj historike. Konkretisht, pjesëmarrja e kredive në shtyllën e parë u rrit në 91.6 përqind nga 89.7 përqind një vit më parë, ndërsa pjesëmarrja në shtyllën e dytë u ul në 6.5 përqind nga 8.2 përqind. Ky zhvillim reflekton përmirësimin e sentimentit të tregut dhe vlerësimet më të favorshme të rrezikut nga ana e bankave, të cilat gjatë vitit 2024 riklasifikuan në shtyllën e parë sektorë që më parë ishin trajtuar si më të ndjeshëm. Ndërsa, në linjë me rritjen e vlerës së KJP-ve gjatë tremujorit të dytë dhe të tretë, është vërejtur edhe rritje e pjesëmarrjes së kredive të kategorizuara në shtyllën e tretë (Grafik 25).

Grafik 25. Kreditë sipas klasifikimit të ri kreditor në tri shtylla




Burimi: BQK.

Në dhjetor 2024, ekspozimet kreditore pa vonesa (me vonesa më pak se 30 ditë) u rrit lehtë në 97.7 përqind nga 97.4 përqind. Përderisa, kreditë me vonesa mbi 90 ditë, që kanë probabilitet më të ulët ri-pagese, zbriti në 1.9 nga 2.0 përqind një viti më parë (Grafik 26).

Ekonomitë familjare shënuan rritje marginale të raportit të kredive jo-performuese, ndërsa segmenti i ndërmarrjeve shënoi rënie të këtij raporti. Rezultatet e Anketës së Kreditimit Bankar mbështesin këtë zhvillim, ku bankat


raportuan dobësim të aftësisë paguese të klientëve familjarë gjatë vitit (me përjashtim të TM4), ndërsa për ndërmarrjet raportuan përmirësim të saj në pjesën më të madhe të vitit.

Grafik 26. Struktura e kredive sipas klasifikimit të vonesave, metoda e re



Vlera e kredive jo-performuese për ekonominë familjare shënoi rritje vjetore më të theksuar, prej 35.9 përqind në dhjetor 2024, por me tendencë më të lartë të rritjes gjatë tremujorit të dytë të vitit në të cilin u evidentua rritje vjetore e KJP-ve prej 55.9 përqind.


Grafik 27. Kreditë joperformuese



Vlera nominale e KJP-ve për ekonominë familjare arriti në 35.7 milionë euro në dhjetor nga 26.6 milionë euro sa ishte një vit më parë, duke reflektuar rritje vjetore prej 35.9 përqind. Por, si rezultat i rritjes së lartë të kreditimit, kjo dinamikë u reflektua në rritje marginale të raportit të kredive jo-performuese për këtë segment, nga 1.4 përqind në 1.5 përqind (Grafik 34). Ndërkohë, për segmentin e ndërmarrjeve, raporti i kredive jo-performuese u ul nga 2.4 përqind në 2.2 përqind, përkundër


rritjes së lehtë të vlerës së KJP-ve, falë rritjes më të shpejtë të stokut të kredive.

Grafik 28. Raporti i KJP-ve ndaj stokut të kredisë, sipas sektorëve



Ndryshimet në raportin e kredive jo-performuese (KJP) të sektorëve ekonomikë ishin po ashtu marginale, të ndikuara kryesisht nga rritja e kreditimit në shumicën e sektorëve ekonomikë përkundër rritjes së vlerës së KJP-ve për një pjesë të sektorëve (Grafik 28).

Grafik 29. Raporti KJP/gjithsej kreditë në vende të rajonit




Sektori i energjisë rezultoi këtë vit me normën më të lartë të KJP-ve, prej 10.1 përqind, një rritje prej 0.7 pikë përqindje. Sektori i prodhimit shënoi rritje më të theksuar të kredive jo-performuese, por për shkak të zgjerimit të kreditimit, norma e KJP-ve mbeti relativisht e qëndrueshme, duke u rritur vetëm me 0.6 pikë përqindje në nivelin 2.8 përqind. Sektori i tregtisë -i cili përfaqëson sektorin më të kredituar- shënoi rritje të kreditimit prej 15.0 përqind dhe rënie të vlerës së kredive jo-performuese prej 9.9 përqind. Si rezultat, norma e KJP-ve për këtë sektor u zvogëlua në 1.5 përqind nga 1.9 përqind. Rënie të normës

së KJP-ve shënoi edhe sektori i patundshmërive.

Krahasuar me rajonin, sektori bankar në vend vazhdon të tregojë një performancë shumë më të mirë në ripagimin e kredive. Gjatë viteve, Kosova ka pasur raportin më të ulët të kredive jo-performuese në krahasim me vendet e rajonit (Grafik 29).

Mbulueshmëria e kredive jo-performuese me provizionet mbetet në nivele të larta, përkundër rënies së treguesit. Raporti i mbulueshmërisë me provizione të sektorit shënoi rënie prej 23.1 pikë përqindje në nivelin 123.9 përqind, e ndikuar nga rritja vjetore e vlerës së kredive jo-performuese por dhe rënia e provizioneve prej 6.5 përqind (Grafik 30). Shkalla e provizioneve specifike gjithashtu shënoi rënie, me mbulueshmërinë e kredive jo-performuese me provizionet e shtyllës së tretë që zbriti në 67.7 përqind nga 71.7 përqind përqind një vit më parë.


Grafik 30. Ndryshimi vjetor i stokut të KJP-ve dhe mbulueshmëria me provizione



Burimi: BQK.

Shkalla e ekspozimit të madh kreditor ndaj kapitalit të klasit të parë ka shënuar rënie, duke zbritur në 58.4 përqind nga 66.3 përqind një vit më parë, dhe vazhdon të jetë dukshëm nën nivelin maksimal rregullator. Rritja vjetore e vlerës së ekspozimeve të mëdha prej 10.9 përqind, krahas një rritje më të lartë të kapitalit të klasit të parë prej 26.0 përqind (vetëm për bankat në analizë, përjashtuar degët bankare të cilat kanë ekspozime të mëdha), ndikoi në këtë rënie (Grafik 31).

Grafik 31. Koncentrimi i rrezikut kreditor




Burimi: BQK.

Vlera mesatare e ekspozimeve të mëdha arriti në 9.6 milionë euro, nga 9.0 milionë euro një vit më parë. Raporti i tri ekspozimeve më të mëdha ndaj totalit të ekspozimeve të mëdha arriti në 54.7 përqind, nga 53.9 përqind një vit më parë. Ky ndryshim u ndikua nga rritja më e lartë vjetore e tri ekspozimeve më të mëdha prej 12.3 përqind, krahas rritjes së përgjithshme të ekspozimeve të mëdha. Ky nivel tregon se ekspozimet e mëdha janë relativisht të përqendruara në disa pozicione të rëndësishme, gjë që rrit potencialin e ekspozimit të sistemit ndaj goditjeve specifike në këto pozicione.

5.2. Qëndrueshmëria e profitit dhe rreziku i normave të interesit

Rritja e përshpejtuar e kreditimit ka kompensuar ndikimin e uljes së normave të interesit, duke mbështetur rritjen e profitit të sektorit. Aktiviteti i shtuar kreditor gjatë vitit 2024 kontribuoi ndjeshëm në rritjen e të hyrave të sektorit bankar, megjithëse u shoqërua me rritje të kostos për sigurimin e financimit. Për dallim nga viti paraprak, ku qëndrueshmëria e profitit ishte mbështetur kryesisht nga normat e larta të interesit, këtë vit volumi i lartë i kreditimit ka qenë faktori dominues në ruajtjen dhe përshpejtimin e rritjes së profitit neto, i cili u rrit për 17.3 përqind krahasuar me 10.7 përqind në vitin 2023 (Grafik 32).

Grafik 32. Struktura e profitit të sektorit bankar, në milionë euro




Burimi: BQK.

Të hyrat nga interesi në kredi dhe letra me vlerë mbetën burimi kryesor i fitimit, ndërkohë që rritja e shpenzimeve të interesit në depozita reflektoi presionin në rritje mbi koston e fondeve. Në total, të hyrat u rritën për 15.7 përqind, kryesisht për shkak të rritjes së të hyrave nga interesi në kredi dhe letra me vlerë. Konkretisht, të hyrat nga interesi u rritën për 18.1 përqind, ku të hyrat nga interesi në kredi u rritën për 17.4 përqind, ndërsa të hyrat nga investimet në letra me vlerë shënuan rritje vjetore prej 36.6 përqind (Grafik 33).

Neto të hyrat nga interesi mbetën faktor kyç në rritjen e profitit të sektorit, duke pasur peshë të konsiderueshme në strukturën e të ardhurave, ndërkohë që të hyrat neto nga jo-interesi gjithashtu shënuan rritje krahasuar me vitin e mëparshëm.

Grafik 33. Kontribuesit kryesor në rritjen / zvogëlimin e profitit




Burimi: BQK.

Konkretisht, të hyrat neto nga interesi u rritën me 14.6 përqind, ndërsa të hyrat neto nga jo-interesi u rritën me 34.7 përqind, ose 11.4 milionë euro. Në këtë kuadër, margjina neto e interesit mbeti e qëndrueshme, me një rritje të

vogël vjetore prej 0.2 pikë përqindje, duke arritur në 4.9 përqind (Grafik 34).


Grafik 34. Të hyrat dhe shpenzimet e interesit



Burimi: BQK.

Gjithashtu, të hyrat nga jo-interesi, përfshirë tarifën, komisionet dhe të ardhurat tjera operative, shënuan një rritje prej 8.4 përqind, më e lartë krahasuar me 3.2 përqindën rritje në vitin e mëparshëm (Grafik 35 dhe 36).

Grafik 35. Të hyrat dhe shpenzimet e jo-interesit




Burimi: BQK.

Rritja e shpenzimeve operacionale dhe e interesit mbi depozita ka ushtruar presion mbi koston, ndërsa ulja e provizioneve ka ndihmuar të ruhet dinamika e fitimit. Gjatë vitit 2024, të gjitha kategoritë e shpenzimeve shënuan rritje, përjashtuar shpenzimet për provizionet ndaj humbjeve nga kreditë.

Rritja vjetore e përgjithshme e shpenzimeve prej 14.9 përqind u ndikua kryesisht nga rritja e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative, si dhe nga shpenzimet e interesit në depozita (Grafik 37).


Grafik 36. Struktura e të hyrave të sektorit bankar



Burimi: BQK.

Megjithëse shpenzimet e jo-interesit u zvogëluan në terma të përgjithshëm për shkak të rënies së provizioneve, një rritje u vërejt në shpenzimet për tarifa dhe komisione. Shpenzimet për interesa në depozita, që përfaqësojnë një komponent të rëndësishëm të kostos së financimit, shënuan rritje vjetore prej 48.5 përqind — një ritëm më i ulët krahasuar me 58.7 përqind vitin paraprak. Ngadalësimi i rritjes së kësaj kategorie, së bashku me rënien e provizioneve, kontribuoi në ruajtjen e përsheptimit të rritjes së profitit të sektorit.

Grafik 37. Struktura e shpenzimeve të sektorit bankar




Burimi: BQK.

Treguesit e profitabilitetit mbeten në nivele të larta, por pritet të sfidohen nga ambienti me norma më të ulëta interesi dhe konkurrenca e shtuar për fonde. Kthimi mesatar në asete (RoA) u rrit lehtë në 2.6 përqind nga 2.5 përqind një vit më parë, ndërsa kthimi në kapital (RoE) mbeti i

pandryshuar në 22.0 përqind, pasi rritja e kapitalit ishte e përafërt me rritjen e fitimit (Grafik 38). Të dy treguesit mbeten mbi mesataren e rajonit, të cilat shënuan normë të kthimit në asete prej mesatarisht 2.5 përqind dhe normë të kthimit në kapital prej 18.0 përqind. Të gjitha vendet e rajonit shënuan rritje në treguesit e profitabilitetit gjatë këtij viti, gjë që ka zvogëluar dallimin mes mesatares së Kosovës dhe këtyre vendeve.¹²

Në vijim, qëndrueshmëria e fitimit pritet të vihet nën presion nga pasiguritë që lidhen me mjedisin e normave më të ulëta të interesit. Ndonëse rritja e lartë e kreditimit mund të kompensojë pjesërisht rënien e marzhës së interesit, ajo gjithashtu krijon nevojë për më shumë burime financimi, duke shtuar kostot për mbështetjen e aktivitetit të zgjeruar. Për më tepër, konkurrenca në rritje në tregun bankar pritet të intensifikojë presionin mbi kostot e financimit, duke krijuar sfida shtesë për ruajtjen e profitabilitetit në nivelet aktuale.

Grafik 38. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar



Burimi: BQK.

5.2.1 Rreziku ndaj luhatjeve të normave të interesit

Ekspozimi i sektorit bankar të Kosovës ndaj rrezikut nga ndryshimet në normat e interesit është rritur lehtësisht, si pasojë e zvogëlimit të peshës së kredive me normë të interesit variable dhe zgjerimit të hendekut të maturitetit. Ky

¹² Në vendet e rajonit përfshihen Shqipëria, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia Veriore dhe Mali i Zi. Burimi i informacionit

është databaza e Treguesve të Shëndetit Financiar të FMN-së dhe bankat qendrore përkatëse.

ndryshim ka reduktuar mundësinë e transferimit të këtij rreziku te klientët, duke rritur ekspozimin e drejtpërdrejtë të bankave. Njëkohësisht, ky ekspozim është thelluar për shkak të zgjerimit të hendekut kumulativ të maturitetit ndërmjet asetëve dhe detyrimeve që gjenerojnë interes, zhvillim që është ndikuar nga rritja e kreditimit afatgjatë, ndërkohë që sektori bankar vazhdon të mbështetet kryesisht në depozita me afat relativisht të shkurtër.

Hendeku kumulativ ndërmjet asetëve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normave të interesit në vitin 2023 është zgjeruar në 0.18 përqind të ekuitetit nga 0.17 përqind në vitin paraprak. Struktura e maturitetit tregon se asetet me ndjeshmëri ndaj normave të interesit mbizotërojnë në shumicën e kategorive kohore, përveç segmentit “1-5 vite”, ku detyrimet janë më të larta, veçanërisht në maturitetin 3-4 vjet. Ky zhvillim është ndikuar nga rritja e afatizimit të depozitave, të nxitur nga ofertat për norma më të larta interesi. Në përbërje të asetëve të ndjeshme ndaj normave të interesit, vërehet rritje më e lartë në segmentin “1-5 vite”, e nxitur nga kreditimi dhe investimet në letra me vlerë. Ndërkohë, detyrimet janë rritur më së shumti në periudhat “91-365 ditë” dhe “1-5 vite”, për shkak të zgjerimit të afatizimit të depozitave.


Gjatë vitit 2024 trendi i rritjes së peshës së kredive me norma variabile të interesit ndërroj kahje në favor të rritjes së kredive me norma fikse, ku pjesa e kredive me norma variabile zbriti nga 33.8 përqind në 29.7 përqind në vitin 2024. Por, bilanci i sektorit bankar dominohet nga pozicione me norma fikse interesi, që ndërlidhen me rrezikun e riinvestimit në kushte më pak të favorshme në rast të maturimit të asetëve me norma më të larta, dhe rënia e normave të interesit në kredi gjatë vitit 2024 deri në një masë rritë rrezikun për riinvestimin e asetëve në maturim. Rrjedhimisht, krahasuar me vitin paraprak, hendeku pozitiv ndërmjet asetëve dhe detyrimeve u zgjerua për afatet e maturimit “31-90 ditë” dhe “mbi 5 vite”, ndërsa hendeku në afat maturimi “1 – 30 ditë” dhe “91-365 ditë”

u ngushtua. Gjithashtu, hendeku negativ për kategorinë me afat maturimi “1 deri në 5 vite” u ngushtua si rezultat i rritjes më të lartë të asetëve me këtë afat maturimi krahasuar me rritjen e detyrimeve (Grafik 39).

Në përgjithësi, këto zhvillime nënkuptojnë rritje të ekspozimit të sektorit bankar ndaj luhatjeve të normave të interesit. Njëkohësisht, rritja e pjesëmarrjes së kredive me norma fikse kundrejt atyre variabile e bart një pjesë të rrezikut të normave të interesit nga huamarrësit tek bankat, duke e bërë sektorin bankar më të ndjeshëm ndaj rrezikut kreditor në mënyrë direkte.

Në periudhën në vijim, pritet që bankat të përballen me një rritje graduale të kostove të financimit, për shkak të nevojës për zgjerim të burimeve financiare në funksion të mbështetjes së aktivitetit kreditor dhe për shkak të rritjes së konkurrencës ndërbankare, gjë që mund të ndikojë në shtimin e shpenzimeve të sektorit. Në të njëjtën kohë, sfidat në sigurimin e financimit mund të kontribuojnë në një tendencë të moderuar të rritjes së normave të interesit për kredi dhe potencialisht të çojnë në një ngadalësim të aktivitetit kreditor gjatë pjesës së dytë të vitit 2025.

Grafik 39. Asetet dhe detyrimet e ndjeshme ndaj normave të interesit




Burimi: BQK.

5.3. Rreziku nga pozicioni në valuta të huaja

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut nga luhatjet valutore është rritur lehtë, megjithatë mbetet i ulët dhe nën kufijtë rregullatorë. Pozicioni i agreguar neto i hapur për të gjitha valutat e huaja u rrit në 7.4 milionë euro ekuivalente në fund të vitit 2024, nga 5.4 milionë euro një vit më parë, duke përfaqësuar 0.8 përqind të kapitalit të klasit të parë, krahasuar me 0.7 përqind në vitin 2023 (Grafik 40). Kjo rritje reflekton zgjerimin e pozicioneve në frank zviceran dhe dollar amerikan, si rezultat i rritjes së aseteve në këto valuta.

Pozicionet neto të hapura për dollarin amerikan dhe frankun zviceran mbetën në territor pozitiv, ndërsa pozicioni në funtën britanike mbeti si pozicioni i pa ndryshuar me vitin paraprak për shkak të lëvizjes margjiale pozitive në këtë pozicion. Të gjitha pozicionet neto valutore individuale vazhdojnë të mbesin mjaftë nën kufirin rregullator prej 15 përqind të kapitalit të klasit të parë, siç përcaktohet në rregulloren përkatëse. Rrjedhimisht, rreziku direkt nga luhatjet e kursit të këmbimit është marginal dhe nuk paraqet shqetësim për qëndrueshmërinë financiare të sektorit bankar.

Grafik 40. Pozicionet e hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë




Burimi: BQK.

Edhe rreziku kreditor i tërthortë nga ekspozimi në valutë mbetet i ulët, pasi kreditë në valutë të huaj përbëjnë një

pjesë minimale të portofolit. Në fund të vitit 2024, kreditë në valutë përbënin vetëm 0.02 përqind të totalit, me një rënie prej 11 milionë euro nga viti paraprak. Depozitat në valutë të huaj përfaqësuan 3.6 përqind të totalit të depozitave, duke shënuar rritje prej 39.9 milionë euro, por gjithsesi duke ruajtur një nivel të ulët të ekspozimit (Grafik 41).

Grafik 41. Kreditë dhe depozitat në valutë të huaj



Burimi: BQK.

5.4. Qëndrueshmëria e sektorit - Kapitali

Kapitalizimi i sektorit bankar mbeti i qëndrueshëm gjatë vitit 2024, me treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit¹³ (TMK) që u ruajt në 17.4 përqind, e njëjtë me vitin paraprak. Kjo reflekton ritmin e përpunur të rritjes së aseteve të peshura me rrezik dhe kapitalit rregullator, duke ruajtur stabilitetin e treguesit në nivel sektori. Në këtë kontekst, bankat me rëndësi sistemike vazhdojnë të kenë norma më të larta kapitalizimi sesa mesatarja e sektorit. Megjithatë, varianca ndërmjet bankave individuale është ngushtuar, duke treguar konvergjencë drejt një strukture më homogjene kapitali brenda sektorit (Grafik 42).


Rritja e aseteve me peshë rreziku kontribuoi me 2.31 pikë përqindje në rënie të treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit, ndërkohë që rritja e kapitalit rregullator kontribuoi në rritjen e TMK-së për 2.28 pikë përqindje (Grafik 43). Efekti më i lartë, mirëpo

¹³ Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit duhet të jetë në çdo kohë mbi nivelin 12 përqind ndaj Aseteve të peshuara me rrezik. Kapitali bazë i klasit të parë duhet të jetë në çdo kohë së paku 4.9 përqind të

APR-ve, ndërsa Kapitali rregullativ i klasit të parë duhet të qëndrojë minimalisht në 9 përqind në raport me APR-të.

margjinal, i rënies së kapitalit se i rritjes së aseteve të peshuara me rrezik dha kontribut më të lartë rënës në treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit, prej 0.02 pikë përqindje.


Grafik 42. Kapitalizimi i sektorit bankar



Burimi: BQK.

Masat makroprudenciale të miratuara në shtator 2024 – Shtesa Pozitive Neutrale Kundërciklike e Kapitalit dhe shtesat për Bankat me Rëndësi Sistemike (O-SII) – mbeten të pandryshuara dhe hyjnë plotësisht në fuqi në qershor 2025. Gjatë vitit 2024 bankat kanë vijuar të akumulojnë kapital të mbajtur, duke përmbushur gradualisht kërkesat tranzitore. Monitorimi i ecurisë së rreziqeve edhe gjatë vitit 2025, në baza tremujore sugjeron që kalibrimi aktual i buffer-eve mbetet adekuat.

Grafik 43. Kontributi i Kapitalit Rregullator dhe APR-ve në Raportin e Kapitalizimit




Burimi: BQK.

Kapitali rregullativ i sektorit bankar mbetet me cilësi të lartë dhe i mbështetur kryesisht nga fitimi i mbajtur dhe ai i realizuar, të cilët edhe gjatë vitit 2024 dhanë kontributin kryesor në rritjen e kapitalit. Fitimi i realizuar shënoi një rritje vjetore prej 38.5 përqind, ndërsa fitimi i

mbajtur u rrit me 15.6 përqind, duke shërbyer si burimi kryesor i kapitalizimit, i mbështetur gjithashtu nga rritja e të ardhurave tjera dhe fondeve rezervë (Grafik 44).


Grafik 44. Struktura e kapitalit rregullator



Burimi: BQK.

Brenda strukturës së kapitalit rregullativ, 89.3 përqind përbëhet nga kapitali i klasit të parë, ku fitimi i mbajtur zë 66.3 përqind – një komponent kyç për forcimin e qëndrueshmërisë së sektorit. Në fund të vitit, treguesi i kapitalit të klasit të parë ndaj aseteve të peshuara me rrezik qëndroi në 15.5 përqind, duke shënuar një rënie të lehtë prej 0.1 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë (Grafik 45).

Grafik 45. Norma e levës




Burimi: BQK.

Këto zhvillime reflektojnë kapacitetin e sektorit për të gjeneruar dhe akumuluar kapital me cilësi të lartë – element thelbësor për ruajtjen e stabilitetit financiar në një mjedis me rreziqe në rritje.

Treguesi i levës financiare shënoi rritje në 10.9 përqind nga 9.8 përqind një vit më parë, duke qëndruar dukshëm mbi pragun minimal prej 3.0 përqind të kërkesës me Rregulloren për

Treguesin e Leverazhit. Ky tregues përforcon më tej vlerësimin për cilësinë dhe kapacitetin mbrojtës të kapitalit në sektor, duke reflektuar strukturë dhe cilësi të mirë të kapitalit (Grafik 46).


Grafik 46. Raporti i APR-ve ndaj gjithsej aseteve të sektorit



Burimi: BQK.

Asetet e peshuara me rrezik (APR) vazhduan trendin rritës, kryesisht si rezultat i rritjes më të përshpejtuar të kreditimit. Në vitin 2024, APR-të për rrezik kreditor u rritën me 15.3 përqind nga 13.4 përqind në vitin paraprak, duke reflektuar një rritje më të përshpejtuar të kreditimit. Edhe APR-të për rrezik operacional shënuan rritje prej 14.7 përqind nga 12.6 përqind, ndërsa APR-të për rrezikun e tregut mbetën të papërfillshme. Struktura e APR-ve mbeti e ngjashme me vitin paraprak: 93.8 përqind për rrezik kreditor, 6.2 përqind për rrezik operacional dhe vetëm 0.001 përqind për rrezik të tregut (Grafik 47).¹⁴

Grafik 47. Asetet e peshuara me rrezik kreditor, pjesëmarrja




Burimi: BQK.

Në kuadër të aseteve të peshuara për rrezik kreditor, pjesëmarrjen më të

madhe e kanë kreditë individuale dhe NVM-ve me 53.2 përqind, pasuar nga kreditë ndaj korporatave me 13.7 përqind. Kreditë hipotekare të mbështetura me pronë të paluajtshme komerciale dhe me pronë të paluajtshme rezidenciale kanë pjesëmarrje prej 11.4 dhe 8.4 përqind, respektivisht. Ekspozimi ndaj bankave tjera, qeverive dhe bankave qendrore ishte relativisht i ulët prej 2.8 përqind dhe 1.5 përqind respektivisht. Ekspozimet e tjera, që përfshijnë autoritetet lokale, sektorin publik, bankat zhvillimore dhe organizatat ndërkombëtare, zënë 9.1 përqind të totalit (Grafik 48).

APR-të mbeten të përqendruara kryesisht në kategorinë me peshë më të lartë të rrezikut – 100 përqind – e cila shënoi rritjen më të lartë gjatë vitit, e ndjekur nga rritja e kredive hipotekare me peshë rreziku 50 përqind. Ky zhvillim pasqyron një intensifikim të aktivitetit kreditues në segmentet retail dhe hipotekar.

Grafik 48. Klasat e aseteve sipas peshës së rrezikut




Burimi: BQK.

Kategoria e peshuar me 100 përqind përbën 77.4 përqind të gjithsej APR-ve dhe shënoi rritjen më të madhe gjatë vitit, për 503.2 milionë euro. Rritje e theksuar u vërejt edhe në kategorinë 50 përqind (kreditë hipotekare rezidenciale dhe ekspozimi ndaj institucioneve financiare), me një rritje vjetore prej 30 përqind. Ndërkohë, kategoria me peshë 20 përqind (ekspozimet ndaj institucioneve financiare dhe autoriteteve publike) pati rritje më të moderuar, prej 2 përqind.

¹⁴ Asetet e peshuara për rrezik të tregut u raportuan për herë të parë me fillim nga vitin 2020, sipas formatit të ri të raportimit të kërkuar nga BQK.

Grafik 49. Struktura e APR-ve për rrezik kreditor, sipas peshës së rrezikut



5.5. Financimi dhe Rreziku i Likuiditetit

Sistemi bankar mbetet i qëndrueshëm në aspektin e likuiditetit, me tregues kryesorë brenda kërkesave rregullative, duke u mbështetur kryesisht nga rritja e depozitave të sektorit privat. Megjithatë, rritja e normave të interesit gjatë vitit ka sjellë sfida për kostot e financimit dhe ruajtjen e pozicionit likuid, veçanërisht gjatë periudhës së përshpejtimit të aktivitetit kreditor.


Depozitat e sektorit privat u zgjeruan gradualisht gjatë vitit 2024, me përshpejtim në fund të vitit, kryesisht për shkak të rritjes së depozitave të afatizuara nga individët dhe korporatat si pasojë e normave më të larta të interesit. Ndërkohë, depozitat e transferueshme, që mbajnë pjesën më të madhe të strukturës së depozitave, vazhduan të rriten me ritëm më të ngadalësuar.

Rritja e vazhdueshme e kreditimit afatgjatë, së bashku me pjesëmarrjen e lartë të depozitave me maturim relativisht të shkurtër, ka theksuar mospërputhjet midis afateve të aseteve dhe detyrimeve në disa kategori maturimi. Megjithatë, pjesëmarrja dominuese e depozitave të ekonomive familjare, të cilat karakterizohen nga një natyrë më stabile për shkak të qëllimit të tyre parësor si 'kursim/ruajtje' e mjeteve, kontribuojnë në qëndrueshmëri të sektorit. Gjithashtu, niveli të lartë i rezervave të likuiditetit në BQK dhe i aseteve likuide në

total e bëjnë sektorin rezistent ndaj ndikimeve negative që mund të vijnë nga këto mospërputhje. Bankat gjithashtu kanë hapsirë të përmbushin nevojat e mundshme për likuiditet përmes mekanizmave të tjerë, si menaxhimi i rezervave të likuiditetit, marrëveshjet ndër bankarë për likuiditet, dhe financimi nga bankat amë (Grafik 50).

Treguesit e likuiditetit në nivel sektori tregojnë qëndrueshmëri, megjithëse ekzistojnë dallime në tepricat e likuiditetit midis bankave individuale. Megjithë nivelin e lartë të likuiditetit në sektor, pjesa më e madhe e bankave kanë shënuar rënie të raportit të likuiditetit krahasuar me vitin e kaluar, përkundër se janë dukshëm mbi nivelin e kërkuar rregullator. Kjo rënie rrjedhë nga rritja më e lartë e detyrimeve afat shkurtër, e mbështetur edhe nga rritja më e përshpejtuar e depozitave gjatë vitit.

Grafik 50. Struktura e financimit




Katër banka kanë raportuar rritje të raportit të likuiditetit, ndërsa disa të tjera mbeten më të ndjeshme për shkak të strukturës së bilancit dhe burimeve më të kufizuara të financimit, duke qenë më pak fleksibile për të vepruar në një ambient me norma të rritura të interesit.

5.5.1 Financimi bankar

Gjatë vitit 2024, depozitat tejkaluan kreditë me 119.1 përqind, një tregues që u ul për 5.6 pikë përqindje krahasuar me vitin paraprak, për shkak të rritjes më të shpejtë të kreditimit në krahasim me depozitat. Rritja e gjithsej depozitave gjatë vitit 2024 ishte e përshpejtuar, ku depozitat e ekonomive familjare u zgjeruan më ngadalë,

ndërsa ato të ndërmarrjeve përshpejtuan rritjen, me një sezonalitet më të dukshëm në tremujorin e tretë dhe të katërt, sidomos gjatë muajve gusht dhe dhjetor (Grafik 51). Depozitat e institucioneve të tjera financiare gjithashtu u rritën, ndërsa depozitat e korporatave publike dhe qeverisë shënuan rënie.


Grafik 51. Rritja e kredive dhe depozitave të sektorit bankar



Burimi: BQK.

Struktura e depozitave sipas afateve të maturimit vazhdon të dominohet nga depozitat e transferueshme, me pjesëmarrje prej 62.6 përqind.

Grafik 52. Struktura e depozitave




Burimi: BQK.

Megjithatë, depozitat e afatizuara shënuan rritjen më të lartë prej 23.7 përqind, duke rritur pjesëmarrjen e tyre në total në 28.9 përqind, nga 26.1 përqind në vitin paraprak. Mospërputhjet ndërmjet afateve të maturimit të depozitave dhe kredive janë të theksuara veçanërisht në kategoritë ‘deri në 1 vit’ dhe ‘mbi 2 vite’. Depozitat me maturim mbi 2 vite zbritën në 37.8 përqind të strukturës së depozitave të afatizuara, ndërsa kreditë me

maturim 5-10 vjet përbëjnë 36.6 përqind të totalit të kredive (Grafik 52).

Grafik 53. Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit




Burimi: BQK.

Depozitat me maturim ‘deri në 1 vit’ shënuan rritjen më të madhe, duke arritur në 41.0 përqind nga 31.6 përqind në vitin paraprak.

Në fund të vitit, raporti i financimit të qëndrueshëm neto (NSFR) qëndroi në 136.0 përqind, duke treguar se sektori ka arritur të ruajë një nivel të financimit të qëndrueshëm mbi minimumin rregullator prej 100 përqind, me dallime të vogla midis bankave të mëdha dhe atyre më të vogla. Niveli i këtij treguesi ishte më i ulët në disa banka të reja ose të sfiduara nga konkurrenca për depozita.

Grafik 54. Struktura e afateve të maturimit të depozitave dhe kredive




Burimi: BQK.

Ndryshe nga viti paraprak, sektori ka reduktuar financimin përmes borxhit të ndërvarur. Duke qenë se financimi nga burime të jashtme mbetet në nivele të ulëta dhe konkurrenca për depozita është e lartë, kostot e financimit vazhdojnë të përbëjnë një sfidë për aktivitetin e bankave.

5.5.2 Reziku i Likuiditetit

Pozita e likuiditetit të sektorit bankar ruajti nivel të qëndrueshëm, përkundër trendit rënës të Treguesit të Mbulimit të Likuiditetit (TML-ang.LCR). Përkundër një rënieje të theksuar përgjatë vitit 2024, TML-LCR mbeti në nivele të larta dhe dukshëm mbi pragun rregullator prej 100 përqind, duke reflektuar një pozitë solide të likuiditetit në sektorin bankar. Konkretisht, ky tregues u ul për 68.9 pikë përqindje krahasuar me vitin paraprak, duke zbritur në 210.9 përqind (Grafik 55). Ky nivel i lartë mbështetet kryesisht nga rezerva e lartë e likuiditetit, e cila përbëhet në masë të madhe nga letrat me vlerë të qeverive vendore dhe të huaja (53.8 përqind), si dhe nga paraaja e gatshme dhe rezervat në bankën qendrore. Gjatë vitit, rezerva e likuiditetit u rrit me 5.1 përqind, ndërsa rrjedha dalëse neto, ku kryesisht përfshihen lëvizje të depozitave nga klientët, shënoi një rritje të theksuar prej 39.4 përqind krahasuar me vitin paraprak, duke kontribuar në luhatjet e raportit.

Grafik 55. Treguesi i Mbulimit me Likuiditet - Liquidity Coverage Ratio (LCR)




Burimi: BQK.

Gjithashtu, në vitin 2024 raporti i aseteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra zbriti në 32.6 përqind, nga 34.7 përqind në vitin 2023. Ky rezultat u ndikua nga rritja më e lartë e detyrimeve afatshkurtra krahasuar me rritjen e aseteve likuide, të cilat u rritën me 14.4 përqind, ndërsa asetet likuide u rritën me 7.6 përqind.

Raporti i ngushtë i likuiditetit, i cili përfshin vetëm asetet shumë likuide (paraaja e gatshme dhe ekuivalentët e saj, llogaritë rrjedhëse dhe plasmanet), në raport me detyrimet

afatshkurtra, zbriti lehtësisht në 27.0 përqind nga 27.6 përqind një vit më parë, për shkak të rritjes më të lartë të detyrimeve krahasuar me asetet shumë likuide. Raporti i aseteve likuide ndaj gjithsej aseteve zbriti në 23.9 përqind nga 25.6 përqind në vitin 2023, pasi asetet u rritën më shpejtë se asetet likuide (Grafik 56).

Grafik 56. Indikatorët e likuiditetit




Burimi: BQK.

Rritja e aseteve likuide gjatë periudhës u ndikua kryesisht nga rritja e investimeve në letra me vlerë të tregtueshme të qeverive të huaja për 134.1 milionë euro (një rritje prej 38.9 përqind) dhe balancave me BQK-në për 61.9 milionë euro. Gjithashtu, një kontribut të rëndësishëm dha edhe rritja prej 56.4 milionë euro e parasë së gatshme.

Ndërsa, efekt zbritës në mjete likuide pati kategoria e depozitave dhe plasmanëve në bankat vendore, që u zvogëluan për 53.7 milionë euro apo 97.6 përqind, investimeve në obligacione të qeverisë së Kosovës, e cila u zvogëlua për 30.8 milionë euro (rënie vjetore prej 16.0 përqind), si dhe llogaritë rrjedhëse me bankat, që u zvogëluan për 26.3 milionë euro apo 17.9 përqind.

Në fund të dhjetorit rezervat e likuiditetit të bankave vazhdojnë të jenë në nivele të larta, duke tejkaluar për 46.6 përqind shumën e rezervës së obliguar (10 përqind) që duhet të mbahet në formë likuide në Bankën Qendrore të Kosovës (BQK). Niveli i tepricës së rezervave bankare është zvogëluar në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (50.0 përqind) duke reflektuar dinamikat e rritjes së kreditimit dhe investimeve në letra me vlerë (Grafik 57).

Grafik 57. Rezervat e likuiditetit



Burimi: BQK.

BQK aplikon normë te depozitave për rezervat që bankat i mbajnë mbi rezervën minimale të kërkuar. Niveli i normës varet nga normat që bankat e eurozonës aplikojnë për BQK-në, si dhe nga kthimet e investimeve në portfolion aktuale të investimeve. Kjo normë qëndrojnë njëjtë prej Gushtit të vitit 2023, dhe është 0.3 përqind. Mospërputhjet e afateve të maturimit ndërmjet investimeve dhe financimit në disa kategori të afateve të maturimit u rriten më tej, përderisa afatet e maturimit të depozitave po zgjerohen, dhe kreditimi afatgjatë është në rritje.


Kjo lëvizje ka shtuar sfidat në menaxhimin e likuiditetit. Hendeku kumulativ i likuiditetit në vitin 2024 u zgjerua në 1,130.1 milionë euro, nga 963.6 milionë euro një vit më parë. Ky rezultat u ndikua kryesisht nga zgjerimi i hendekut pozitiv ndërmjet aseteve dhe detyrimeve në afatet e maturimit '1-3 muaj', '1-5 vite', si dhe 'mbi 5 vite'.

Hendek negativ më i lartë ndërmjet aseteve dhe detyrimeve mbetet në afatin e maturimit "1-7 ditë". Pjesëmarrja e lartë e depozitave të

transferueshme në gjithsej detyrimet e sektorit bën që 68.3 përqind e detyrimeve të kategorizohen në afatin "1-7 ditë," ndërsa asetet me këtë afat përbëjnë vetëm 16.9 përqind të gjithsej aseteve.

Ndërkohë, hendeku më i zgjeruar pozitiv mbetet në afatin e maturimit "1-5 vite," ku rreth 36.8 përqind e aseteve kategorizohen me këtë afat, në krahasim me detyrimet e këtij afati të maturimit që përbëjnë 13.0 përqind të gjithsej detyrimeve. Gjithashtu kjo kategori pati zgjerimin më të lartë krahasuar me kategoritë e tjera të maturimit.

Grafik 58. Hendeku i likuiditetit




Burimi: BQK.

Mospërputhjet e afateve të maturimit të zërave bilancor mbesin më të theksuara në kategoritë e maturimit "1-7 ditë" dhe "1-5 vite" (Grafik 58). Duke qenë se hendeku është zgjeruar në këto dy kategori krahasuar me vitin e kaluar, sfidat mbeten në sigurimin e financimit dhe atë më afatgjatë, në një ambient konkurrues për mbështetjen e kreditimit afatgjatë dhe të investimeve të tjera.

Stress-test makrofinanciar për rrezikun kreditor

Diagram 1. Infrastruktura e modelit Stress Test për rrezikun kreditor (rrezikun e solvencës)



Qëllimi i kornizës së stress test qëndron në vlerësimin e rezistencës së institucioneve financiare ndaj zhvillimeve të pafavorshme në treg. Në këtë kontekst analiza stress test përfaqëson instrument të rëndësishëm që përmes matjes dhe vlerësimit të ndjeshmërisë dhe qëndrueshmërisë së institucioneve financiare ndaj goditjeve të pafavorshme ekonomike dhe financiare kontribon në identifikimin e rreziqeve sistemike dhe në forcimin e politik bërjes makroprudenciale në funksion të menaxhimit të rrezikut të identifikuar sistematik.

Në këtë drejtim, korniza e stres testit makrofinanciar për rrezikun kreditor ka avansuar në një kornizë/modalitet të ri¹⁵, të mbështetur në një qasje më të strukturuar dhe më dinamike duke përdorur modele satelitore për të matur sensitivitetin e parametrave matës të rrezikut kreditor dhe të normave të interesit, ndaj faktorëve makroekonomik dhe financiar.

Korniza e re është ndërtuar mbi tri shtylla kryesore (**diagram 1**) që konsistojnë gjithë procesin e realizimit të një stress testi: **Shtylla e parë** e kornizës së re përfshin ndërtimin e skenarëve makrofinanciarë, **Shtylla e dytë** përbëhet nga "Modelet Satelitore", modele këto që përkthejnë skenarët makroekonomikë e financiar në projektimin e trajektores së probabilitetit të dështimit të kredive – PDs, si dhe projektimit të të ardhurave neto nga interesi (NII) përmes trajektorës së normave efektive të interesit. Fokusi i modeleve satelitore qëndron në vlerësimin e ndikimeve të tronditjeve makrofinanciare dhe pasqyrimin e efekteve të tyre në bilancet dhe pozitën kapitale të bankave. **Shtylla e tretë** prezanton "Qarkun e Reagimit" (feedback loop), që është procesi i fundit që në formë dinamike integron të gjitha komponentët me impakt në nivelin e kapitalit, më konkretisht përfshin kombinimin e fitimeve/humbjeve të pritura që rezultojnë nga modelet satelitore të

bazuara në skenarët makrofinanciarë duke rillogaritur pozicionin e ri të kapitalit. Gjithsesi ndërtimi i kësaj kornize mbetet një proces i hapur dhe në progres, që kërkon përmirësim të vazhdueshëm, avancim metodologjik dhe integrim më të plotë të faktorëve makro-financiar, në funksion të forcimit të qëndrueshmërisë së sektorit bankar në një ambient financiar gjithnjë e më sfidues.

Shtylla e parë: Ndërtimi i skenarëve makro-financiar

Ndërtimi i skenarëve makroekonomik dhe financiar është procesi i parë në gjithë kornizën/modelin e stress testit, mbi të cilin mbështetën modelet satelitore për të vlerësuar ndikimin e variablave të ndryshme ekonomike dhe financiare në probabilitetin e dështimit të kredive dhe normat efektive të interesit – margjinën neto të interesit, nën projeksione reale dhe skenarë hipotetik. Janë skenarët mbi bazën e të cilëve matet koeficienti i reagimit të parametrave të rrezikut kreditor dhe për pasojë kapaciteti rezistues i bankave ndaj këtyre zhvillimeve apo goditjeve negative në treg (Tabela 3)

Skenari makro-financiar bazë është bazuar në projeksionet reale të realizuara nga BQK për variablat makroekonomike si: rritja ekonomike në vend, inflacioni dhe remitencat për dy vitet në vijim, si dhe projeksionet e bankave për rritjen kreditore në tri vitet e ardhshme¹⁶. Ndërsa për variablat e tjera si: rritja ekonomike në eurozonë, inflacioni, papunësia, norma ndër bankarë e financimit në eurozone-Euribor 3 muaj, si dhe norma e kthimit në obligacione qeveritare, janë marrë për bazë projeksionet makroekonomike të Bankës Qendrore Evropiane (BQE-së).¹⁷

Skenari negativ bazohet në skenarë hipotetik, që përshkruan zhvillimin e variabileve kyç ekonomike dhe financiare në një situatë të pafavorshme, bazuar në

¹⁵ Mbështetur në asistencën teknike nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) në vitin 2023 dhe 2024.

¹⁶ Informacione që sigurohen nga bankat mbi parashikimet e tyre të pozicioneve bilancore, në baza vjetore.

¹⁷ Projeksionet makroekonomike të BQE-së - [Eurosystem staff macroeconomic projections for the euro area, June 2025](#)

supozimet hipotetike të rreziqeve ndaj të cilave do të ekspozohet sektori bankar. Stress testi përfaqëson një analizë të bazuar në skenarë, që matë se si do të reagojë sektori bankar përballë zhvillimeve hipotetike të pafavorshme ekonomike. Prandaj, nënkupton që ky skenar nuk duhet të konsiderohet si një parashikim i zhvillimeve negative në sistemin financiar, por si një vlerësim i mënyrës se si variablat priren të reagojnë ndaj goditjeve, bazuar në sjelljen e tyre historike.

Skenari negativ është bazuar në skenarët e publikuar nga Autoriteti Bankar Evropian (EBA) për vitin 2025¹⁸ që bankave në unionin evropian ju kërkohet ti aplikojnë gjatë ushtrimit të provës së rezistencës – stress testit makro-financiar të tyre. Në mungesë të një skenari negativ - tronditës makroekonomik (adverse shock), për variablat makroekonomike në vend, janë përdorur skenarët e publikuar nga ABE (EBA), si nivele referuese, ku për bazë është marrë ndryshimi i shokut nga niveli aktual, dhe e njejta magnitudë relative e goditjes është aplikuar mbi të dhënat aktuale për Kosovën. Ndërsa goditja në normën e rritjes reale të bruto produktit vendor për skenarin negativ është përcaktuar duke ndjekur një qasje pragmatike, e cila konsiderohet e përshtatshme për qëllime të stres testimit. Konkretisht, është përdorur

devijimi standard i normës së rritjes reale ekonomike gjatë 13 viteve të fundit, i shumëzuar me një koeficient prej 2.5, për të gjeneruar një skenar me rënie të theksuar të aktivitetit ekonomik. Kjo qasje synon të simulojë një situatë të rëndë nën kushte stresuese, pa u mbështetur drejtpërdrejt në modele parashikuese, por duke reflektuar një ndjeshmëri të lartë të ekonomisë ndaj goditjeve të jashtme.

Narrativa e skenarëve

Narrativa e skenarëve të rënduar (Tabela 3) nga Autoriteti Qendror Bankar dhe Bordi Evropian për Rrezikun Sistemik (ESRB) përqendrohet në rreziqet në rritje ndaj sektorit bankar të BE-së, të cilat janë nxitur kryesisht nga faktorë të jashtëm si tensionet e shtuara gjeopolitike dhe fragmentimi i tregtisë globale. Këta faktorë kanë ndikuar në tkurrjen e aktivitetit ekonomik dhe uljen e eksporteve të BE-së.

Përveç ndikimeve të jashtme, edhe faktorët e brendshëm – si pasiguritë për ecurinë ekonomike dhe prespektiva negative për tregun – kanë ndikuar në uljen e investimeve nga ana e bizneseve, reduktimin e vendeve të punës dhe rënien e besimit të konsumatorëve, çka në tërësi ka çuar në dobësim të kërkesës së brendshme.

Tabela 3. Projektionet-skenari bazë dhe skenarët e supozuar hipotetik-skenari i rënduar

Përshkrimi	SKENARËT BAZË TË PROJEKTUAR				SKENARËT E RËNDUAR HIPOTETIK			
	2024	2025	2026	2027	2024	2025	2026	2027
Norma e kthimit në instrumente qeveritare1vit	3.00%	3.80%	4.10%	4.30%	3.00%	4.90%	4.70%	4.60%
Norma e kthimit në obligacione qeveritare10vite	2.30%	3.10%	3.40%	3.60%	2.70%	4.60%	4.50%	4.30%
Norma referente e BQE-së	3.60%	2.10%	1.90%	2.20%	3.60%	3.80%	3.40%	3.30%
Euribor_1muaj	3.60%	2.10%	1.90%	2.20%	3.60%	3.80%	3.40%	3.30%
Euribor_3muaj	3.60%	2.10%	1.90%	2.20%	3.60%	3.40%	3.10%	3.00%
Euribor_6muaj	3.50%	2.00%	1.80%	2.10%	3.50%	4.40%	4.00%	4.00%
Rritja reale e BPV KS	4.40%	4.10%	4.20%	4.40%**	4.40%	-8.80%	-10.50%	-6.50%
Norma e inflacionit KS	1.60%	3.30%	3.00%	2.70%**	1.60%	3.70%	2.50%	1.20%
Papunësia KS*	10.90%	10.80%	10.70%	10.40%	10.90%	12.60%	15.10%	16.40%
Remitencat KS	1.44%	6.34%	6.48%	2.46%**	1.44%	-14.93%	6.48%	5.02%
Rritja reale e BPV_eurozonë	0.80%	0.90%	1.10%	1.30%	0.70%	-2.30%	-4.00%	0.00%
Norma e inflacioni_eurozonë	2.40%	2.00%	1.60%	2.00%	2.40%	4.50%	3.30%	2.00%
Papunësia_union evropian	6.40%	6.30%	6.30%	6.00%	6.40%	8.10%	10.60%	11.90%

*e përshtatur me rritjen e projektuar nga BQE

**variablat ekonomike për KS janë të projektuara vetëm për dy vite. Për vitin 2027 nuk janë të projektuara por të përshtatura me trendin

Burimi: BQK, BQE dhe ABE.

¹⁸ Këto skenarë dhe stress testi koordinohet nga Autoriteti Bankar Evropian (EBA), në përputhje me mandatin e saj, dhe në bashkëpunim

me Bordin Evropian për Rreziqe Sistemike (ESRB), iniciojnë dhe koordinojnë stress testin në nivel të BE-së.

Presionet inflacioniste pritet të ushqehen nga rritja e çmimeve të energjisë dhe shqetësimet për zinxhirët globalë të furnizimit, të lidhura me tensionet gjeopolitike, veçanërisht në Lindjen e Mesme. Këto efekte, megjithatë, zbuten pjesërisht nga kërkesa e dobësuar, me inflacionin që për rrjedhojë do të ndjekë një trajektore rënëse pas vitit 2025. Skenarët janë ndërtuar sipas parimit të “mos ndryshimit të politikave” (no policy change), duke supozuar se rritja fillestare e normave të interesit në vitin e parë reflekton reagimin e tregjeve ndaj presioneve inflacioniste ekzistuese dhe jo një shtrëngim të mëtejshëm të politikës monetare. Si rrjedhojë, kjo rritje e normave ndikon në çmimet e aseteve dhe detyrimeve, duke krijuar presione për rivlerësime. Gjithashtu, shqetësimet për nivelin dhe qëndrueshmërinë e borxhit të ndërmarrjeve jo-financiare pritet të reflektohen përmes rritjes së normave të kërkuara të kthimit në tregjet e obligacioneve të korporatave, duke ulur vlerën e tyre dhe rritur kostot e financimit për ndërmarrjet.

Shtylla II. Modelet satelitore

Shtylla e dytë e procesit të stress testit konsiston në ndërtimin e "Modeleve Satelitore," që përkthejnë ndikimin e këtyre skenarëve makro-financiare në portofolin kreditor, bilancin e gjendjes, performancën, nivelin e mjeteve me rrezik, dhe përfundimisht kapitalin bazë të bankave. Për të vlerësuar këtë transmetim të goditjeve dhe për të matur sensitivitetin e variablave të varura (Probabiliteti i Dështimit dhe Neto të Hyrat nga Interesi) janë ndërtuar dy modele satelitore për periudhë projektuese trevjeçare 2025-2027:

1) *modeli satelitor i probabilitetit të dështimit të kredive (PD satellite model)* që përkthen skenarët makroekonomikë dhe financiar në sjelljen/trajektoren e probabilitetit të dështimit të kredive me ndikim në rrezikun kreditor, profitin neto dhe rrjedhimisht nivelin e kapitalit të bankave, si dhe 2) *modeli satelitor*

i të hyrave neto nga interesi që vlerëson reagimin e normave efektive të interesit ndaj variablave makroekonomike dhe financiare me ndikim në të ardhurat neto nga interesi, duke afektuar kapitalin bazë të klasit të parë të bankave.

1) Modeli satelitor i probabilitetit të dështimit të kredive – PD satellite model

Modeli satelitor i probabilitetit të dështimit të kredive (PD satellite model) përkthen skenarët makroekonomikë dhe financiar në sjelljen/trajektoren e probabilitetit të dështimit të kredive me ndikim në rrezikun kreditor, profitin neto dhe rrjedhimisht nivelin e kapitalit të bankave. Variabla e varur – probabiliteti i dështimit - është definuar si raporti i tranzicionit/kalimit të ekspozimeve kreditore nga pozicionet aktuale performuese në kredi jo-performuese, të kategorizuara sipas klasifikimeve “A, B, C”-performuese dhe “D, E, W”-joperformuese, ndaj stokut të gjithëj kredive në tremujorin paraprak. Ky raport është proxy/zëvendësuesi më i përshtatshëm dhe më i përafërt për përkufizimin teorik të normave të dështimit (default rates). Kalkulimet e tranzicioneve janë realizuar për të gjitha bankat që nga viti 2010¹⁹, me të dhënat në dispozicion në regjistrin e kredive të Kosovës përmes formulës në vijim.

$$DR_t = \frac{KJP \text{ flow}_{[A,B,C] \rightarrow [D,E,W],t}}{EP \text{ stock}_{[A,B,C],t-1}}$$

DR_t: Norma e kalimit në kredi jo-performuese në periudhën t (Default Rate)

KJP flow_{[A,B,C]→[D,E,W],t+1} : Shuma e kredive që kalojnë nga kategorite performuese (kategoritë A, B dhe C) në kategorinë jo-performuese (kategoritë D, E dhe W) gjatë periudhës nga t në t+1.

EP stock_{[A,B,C],t} – Stoku i përgjithshëm i kredive performuese (kategoritë A, B dhe C) në fund të periudhës t në analizë.

Normat e kalimit të ekspozimeve kreditore nga kategoritë performuese në jo-performuese janë të llogaritura në baza tremujore të cilat pastaj

¹⁹ Të dhënat janë marrë për konsiderim nga viti 2010 përshkak se vlerësohen si më stabile/të sakta dhe për të eliminuar disa vlera ekstreme në periudhat fillestare të raportimit.

anualizohen për të qenë të barasvlershme në një normë vjetore. Këto norma transformohen në të ashtuquajturën formë logit (transformimi logaritmik i variablit të varur). Transformimi logaritmik siguron që probabiliteti i projektuar i dështimit të kredive (PD) të mbetet brenda kufijve 0 dhe 1. Do të thotë ky transformim logaritmik është i përshtatshëm kur variabli ka kufirin e poshtëm zero, dhe nuk mund të ketë vlera negative. Gjithashtu, ky transformim sjell jolinearitet në model - ashtu që ndryshimet në variablat makroekonomike apo financiare nuk sjellin gjithmonë ndryshime të njëtrajtshme në PD. p.sh sa më i lartë të jetë PD në pikën fillestare, aq më e theksuar do të jetë ndjeshmëria e tij ndaj goditjeve makro-financiare.

Transformimi i variablit PD bëhet përmes formulës:

$$Y_t = \ln\left(\frac{PD_t}{1 - PD_t}\right)$$

Pas regresionit të modelit, raportet logit të PD-ve rikthehen në gjendjen e tyre fillestare përmes formulës:

$$\widehat{PD}_t = \frac{1}{1 + e^{-\hat{Y}_t}}$$

Projeksionet e humbjeve të pritshme nga kreditë duke përdorur modelin satelitor të PD-ve bazohet në **tre ekuacione për tre segmente të ekspozimeve kreditore të bankave - ekspozimi kreditor ndaj institucioneve jo-financiare, ekspozimi ndaj ekonomive familjare me qëllim blerjeje të patundshmërive, si dhe ekspozimi ndaj ekonomive familjare për qëllime të financimit të konsumit**. Për segmentet e mbetura nuk janë zhvilluar modele satelitore, ato janë mbajtur në të njëjtin proporcion, dhe në rast të rritjes së kreditimit, segmentet e tjera janë thjeshtë të rregullueshme/adaptueshme ndaj ndryshimeve në portofolin kreditor, përkitazi me pjesëmarrjen e tyre paraprake në gjithsej asetet.

Metodat e regresionit të përdorura janë model linear me efekte fikse, që përfshin përzgjedhjen automatike të kombinatorikës së

modeleve dhe mesatarizon modelet më efektive. Elasticitetet e variablave vlerësohen përmes metodës së zakonshme të minimumit të katrorëve (OLS). Efektet fikse specifike për secilën bankë përfshihen përmes variablave dummy, për të kontrolluar për dallimet që nuk ndryshojnë me kohën, ndërmjet bankave. Ky model teston kombinime të ndryshme të variablave të pavarura përmes një procesi të zgjeruar të përzgjedhjes së modeleve (model dredging) dhe përzgjedh modelet më të mira bazuar në Kriterin e Informacionit të Akaike (AIC). AIC krijon një ekuilibër ndërmjet përshtatjes së modelit dhe kompleksitetit të tij, për të shmangur mbi përshtatjen (overfitting). **Analiza bazohet në një panel të të dhënave tremujore për 11 banka, për periudhën nga viti 2010 deri në vitin 2024.** Ky model mundëson po ashtu projeksionin e trajektoreve të variablave të varura të parashikuara për secilën bankë.

Modeli bazë satelitor për vlerësimin e koeficienteve të elasticitetit të variablave të varuara, është e shprehur në formën më poshtë

$$\ln\left(\frac{Y_{t,i}}{1 - Y_{t,i}}\right) = \beta_0 + \sum_{k=i}^K \beta_k X_{k,t,i} + \sum_b \gamma_b Bank_{b,i} + \varepsilon_{t,i}$$

$Y_{t,i}$: variabla e varur për bankën i në periudhën t në formë logaritmike

β_0 : konstantja

β_k : koeficienti për variablën “k” me rradhë, vlerëson se si ndryshimet në variablat X_k afektojnë variablën e varur.

$X_{k,t,i}$: variablat e pavarura (makroekonomike dhe financiare) për bankën i në periudhën t.

γ_b : koeficientët e efekteve fikse për bankën b, që kontrollojnë për efekte specifike të bankës që nuk ndryshojnë përgjatë periudhës.

$Bank_{b,i}$: variablat binare – dummy, për të kontrolluar për dallime të paobservueshme ndërmjet bankave.

$\varepsilon_{t,i}$: error term që kontrollojnë për variacionet e pashpjegueshme

Përzgjedhja e variablave të pavarura makrofinanciare X_i është bërë duke pasur parasysh ndjeshmërinë specifike të secilit segment kreditor ndaj kushteve makroekonomike dhe financiare. Fillimisht,

janë testuar një gamë e gjerë e variablave makroekonomike dhe financiare, si: rritjen reale të BPV-së, normën e inflacionit, papunësinë, remitencat, normat afatshkurtra dhe afatgjata të kthimit të obligacioneve qeveritare, normën referente të Bankës Qendrore Evropiane, normën Euribor, rritjen e kreditimit dhe koncentrimin bankar.

Për shkak të karakteristikave të ndryshme të secilit segment të portofolit të kredive, janë ndërtuar specifikime të ndara për tre kategori kryesore: kredi për individë, kredi për biznese dhe kredi hipotekare. Për secilin nga këto modele, përzgjedhja përfundimtare e variablave është bërë në bazë të rëndësisë statistikore dhe drejtimit ekonomikisht të justifikueshëm të koeficientëve.

Në modelin për kreditë hipotekare, variabla që rezultoi statistikisht e rëndësishme **përfshin euribor 6 muaj - norma e financimit ndër-bankar në eurozonë**, që reflekton ndjeshmërinë e këtij segmenti ndaj kostos së financimit. **Për kreditë konsumuese, variablat si remitencat dhe norma Euribor rezultuan si faktorë kyç**, ndërsa për kreditë për biznese, variabla **norma e kthimit afatgjatë të obligacioneve qeveritare** kishte ndikim të rëndësishëm statistikor. Përfundimisht, për secilin model është përzgjedhur ajo specifikë që ofronte përshtatshmëri më të mirë statistikore dhe interpretim ekonomik të besueshëm të rezultateve.

2) Modeli satelitor i të hyrave neto nga interesi - The NII satellite model

Në modelin satelitor për të ardhurat neto nga interesi, variabla të varura janë marrë normat efektive të interesit për segmentet specifike të aseteve dhe detyrimeve që bartin interes. Të dhënat për normat efektive janë mbledhur për të gjitha bankat nga viti 2010 deri në vitin 2024. Janë ndërtuar pesë ekuacione të ndara, që secili korrespondon me një segment specifik të bilancit të gjendjes: (i) norma e interesit për kreditë për ndërmarrje, (ii) kreditë hipotekare, (iii) kreditë konsumuese, (iv) letrat me vlerë, dhe (v) norma e interesit për depozitat.

Normat efektive të interesit janë regresuar ndaj një grupi variablash makroekonomikë dhe financiarë (X_t). Variablat makroekonomike përfshijnë, ndër të tjera, rritjen reale të bruto produktit vendor (BPV), papunësinë dhe remitencat. Nga ana tjetër, variablat financiare përfshijnë normën ndërbankare të financimit në eurozonë (Euribor 6-mujore), indeksin e përqendrimit bankar (i matur përmes indeksit Herfindahl-Hirschman – HHI në segmentet përkatëse, si kredi për ndërmarrje, kredi për ekonomi familjare dhe depozita), si dhe normën e kthimit të obligacioneve qeveritare.

Për vlerësimin përfundimtar janë përzgjedhur variablat që kanë rezultuar statistikisht të rëndësishme dhe me drejtim ekonomikisht të arsyeshëm për secilin ekuacion. Në rastin e normave të interesit për **kreditë e ndërmarrjeve**, variablat më të rëndësishme janë **norma ndërbankare e financimit në eurozonë-Euribor 6mujore dhe indeksi HHI i koncentrimin bankar në segmentin e kredive për ndërmarrje**. Për normat e interesit për **kreditë hipotekare**, variablat si **papunësia, norma Euribor 6 mujore dhe indeksi HHI i koncentrimin bankar në segmentin e kredive për ekonomi familjare** kanë treguar ndjeshmëri të lartë. Në segmentin e **kredive konsumuese**, variablat si **norma Euribor 6 mujore, indeksi HHI i koncentrimin bankar në segmentin e kredive për ekonomi familjare dhe remitencat** rezultuan faktorë të rëndësishëm statistikisht. Ekuacioni për letrat me vlerë është i ndikuar kryesisht nga **normat afatgjata të interesit - obligacionet qeveritare në eurozonë me maturitet 10 vite**. Ndërsa në rastin e normave të interesit në depozita, ndikim të konsiderueshëm patën **indeksi HHI për depozitat, norma ndërbankare e financimit në eurozonë-euribor 6mujore, remitencat dhe norma e rritjes së BPV-së**.

Shtylla III. Korniza e Kapitalit

Procesi i fundit konsiston në integrimin dinamik të të gjitha komponentëve dhe nën proceseve për të përcaktuar efektin e goditjeve

në pozicionin e kapitalit. Kjo realizohet përmes dy moduleve kryesore dhe moduleve ndihmëse:

- **Moduli i bilancit të gjendjes**, ku humbjet e pritura përpunohen në portfolion kreditor të bilancit të gjendjes dhe pasqyrohen në kapital përmes pasqyrës së të ardhurave;
- **Moduli i të ardhurave neto nga interesi (NII)**, ku të hyrat neto përpunohen në bilancin e të ardhurave dhe reflektohen drejtpërdrejt në kapital.

Efekti i parë në kapital ndikohet nga bilanci i gjendjes i ndërlidhur me probabilitetin e dështimit të kredive (PD), që llogaritet nga modelet satelitore për PD dhe reflektohet në humbjet e pritura kreditore. Këto shfaqen në bilancin e gjendjes përmes formulës: $ECL = EAD \times PD \times LGD$, ku:

- **EAD (Exposure at Default)** përfaqëson totalin e ekspozimeve kreditore të bankave;
- **PD (Probability of Default)** parashikohet nga modeli satelitor dhe përshkruan trajektoren e rrezikut të dështimit;
- **LGD (Loss Given Default)** tregon humbjet nga mospagesa, dhe për këtë përdoret vlera e humbjeve të parikuperueshme, e reflektuar përmes provizioneve të ndara për ekspozimet e kategorizuara si jo performuese (stage 3).

Procesi i përpunimit të humbjeve të pritura nga modeli satelitor deri në kapital përfshin disa nënprocese. Humbjet e pritura nga ekspozimet kreditore aplikohen në pasqyrën e të ardhurave të secilës bankë përmes ndryshimit të provizioneve: $\Delta Provisions = LGD \times (PD \times EAD + NPEAD)$, ku, për dallim nga versionet e mëparshme të stres testit²⁰, fitimi/humbja njihet plotësisht fillimisht në pasqyrën e të ardhurave dhe më pas reflektohet në kapitalin bazë.

Komponenta e aseteve të peshuara me rrezik (RWA) do të afektohej drejtpërdrejt, duke u rrikalkuluar mbi bazën e ekspozimeve të reja kreditore – nëse supozohet rritje e kreditimit – dhe duke u reduktuar për humbjet e pritura (përkatesisht provizionet e shtuara si rezultat

i rritjes së probabilitetit të mospagimit të kredive, PD).

Në skenarin bazë, rritja e kreditimit bazohet në projeksionet e bankave të ofruara në fillim të vitit 2025 për periudhën 2025–2027 ndërsa pozicionet e tjera të aseteve janë përshtatur rritjeve bazuar në proporcionin e tyre fillestar.

Në anën e detyrimeve, balancimi bëhet në këtë mënyrë: kapitali në periudhën T_1 ndikohet nga humbjet e pritura kreditore, të cilat pasqyrohen në detyrimet në periudhën T_2 . Duke supozuar mungesën e injektimit të kapitalit të jashtëm nga bankat, mbulimi i humbjeve të krijuara në kapital në T_1 duhet të sigurohet përmes burimeve të tjera financiare. Kjo rritje e financimit shoqërohet me një rritje të kostos, për shkak të normave më të larta të interesit, të nxjerra nga modelet satelitore të ndërtuara.

$Total\ detyrimet_{T1} = (Total\ Asetet_{T+1} - Total\ Asetet_{T0}) + (Kapitali\ vetanak_{T0} - Kapitali\ i\ goditur_{T1})$ Rrjedhimisht, në vitin e dytë, kapitali ndikohet nga dy module kyçe:

- rezultati i modelit për probabilitetin e dështimit të kredive (PD Satellite), dhe
- rezultati i modelit për të ardhurat neto nga interesi (NII Satellite).

Efekti i dytë në kapital vie nga neto të hyrave nga interesi. Pasqyra e të hyrave projektohet bazuar në ndërtimin e modeleve satelitore të të hyrave neto nga interesi (NII satellite model) për të gjeneruar efektet në pozicionet e të hyrave dhe shpenzimeve. Rezultatet e normave të interesit në baza tremujore janë të mesatarizuara ndërsa në kalkulimin e të hyrave nga interesi në T_1 do të përfshihen edhe të hyrat nga rikuperimi i kredive të humbura, bazuar në mesataren e katër tremujoreve të fundit të normave të rikuperimit (cured ratio) të cilat janë kalkuluar nga të dhënat e Regjistrisë të Kredive në të njëjtën metodologji si norma e tranzicionit për probabilitetin e dështimit të kredive (norma e tranzicionit apo raporti i

²⁰ Në verzionin e kaluar të ST humbjet e krijuara nga provizionet aplikoheshin direkt në nivelin e mjaftueshmerise se kapitalit, duke mos

u trajtuar fillimisht përmes pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve (profit&loss statement).

rikuperimit që shpreh tranzicionin të kredive nga kategoritë joperformuese në T_1 në kategorinë performuese në T_0). Gjithashtu, portofoli me norma fikse të interesit do të vazhdojë të ruajë të njëjtën normë interesi si në T_0 , ndërsa vetëm ekspozimet me norma variabile të interesit do të ndikohen nga normat e parashikuara të interesit që rezultojnë nga modeli satelitor. Ndërsa për pjesën tjetër të komponentëve të të ardhurave dhe shpenzimeve, si goditja në të hyrat nga jo interesi është realizuar ashtu që është marrë pjesëmarrja historike e raportit të secilës komponentë të të hyrave nga interesi, ndaj asetëve të secilës bankë, duke përdorur si scaling factor/factor reduktues ± 1 devijim standard, ndërsa janë përjashtuar shpenzimet e personelit dhe të tjera administrative të cilat janë supozuar se do mbesin konstante. Poashtu niveli aktual i tatimeve mbetet konstante dhe nuk konsiderohen ndryshimet në norma tatimore. Të hyrat nga interesi rikalkulohen si në vijim:

Të hyrat nga interesi

$$= (Eksp - KJP * (1 - CurR)) * (Eksp_{fikse} \cdot IR_{t0} + Eksp_{variabile} \cdot IR_{t1}^{satellite})$$

Eksp - gjithsej ekspozimet kreditore

KJP - ekspozimet jo-performuese kreditore

CurR - raporti i rikuperimit të ekspozimeve jo-performuese Cure ratio

Eksp_fikse - pjesëmarrja e ekspozimeve me norma fikse të interesit

Eksp_variabile - pjesëmarrja e ekspozimeve me norma variabile të interesit

IR_{t0} - norma efektive e interesit në vitin bazë (për ekspozimet me norma fikse)

IR_{t1}^{satellite} - norma efektive e interesit e projektuar nga modeli satelitor (për ekspozimet me norma variabile)

Shpenzimet e interesave rikalkulohen si në vijim:

Shpenzimet e Intersit_{t1}

$$= Ekspozimet_{t1} * IR_{t1}^{satellite} IR \text{ deposits}$$

Vlerësimi i efekteve në kapital përfshin gjithashtu edhe **rrezikun e tregut**. Në këtë drejtim, janë llogaritur humbjet e mundshme nga rivlerësimi i pozicioneve të investimeve “held for trading” që reflektohen në pasqyrën e të ardhurave (P&L), si dhe nga instrumentet “available for sale” që reflektohen në të hyra tjera gjithëpërfshirëse (Other Comprehensive Income – OCI). Trajektorja e normave të kthimit në treg është supozuar të rritet, në përputhje me praktikën e pranuar në stres skenarë, ku rritja e perceptimit të rrezikut dhe rënja e aktivitetit ekonomik (BPV) përkthehen në rritje të kthimeve (yields) të tregut dhe, rrjedhimisht, në rënie të vlerës së instrumenteve të mbajtura në portofol. Kapitali do të rikalkulohet duke ju shtuar kapitalit ekzistues, humbjet e pritura nga PD dhe fitimet e humbjet e pritura nga NII ekuacionet satelitore, shtuar të hyrat e tjera gjithëpërfshirëse nga instrumentet financiare të rivlerësuar nga rreziku i tregut (OCI), si në vijim.

Norma e Kapitalit_{T1}

$$= (Kapitali \text{ ekzistues}_{T0} + \Delta P\&L_{satellite} PDs\&NII + Rreziku \text{ i Tregut}_{\Delta FVOCI}) / RWA_{BGJ,PDs}$$

Rezultatet e ushtrimit të qëndrueshmërisë - Stress-Testit të solvencës

Në skenarin bazë, raporti i kapitalizimit pritët të jetë në nivelin 18.4 përqind në vitin 2025 dhe të arrijë 21.4 përqind në vitin 2027 (grafik 59). Rritja e kapitalit në këtë skenar është rezultat i projeksioneve pozitive për vitet në vijim, të cilat rezultojnë në koeficient reagimi shumë më të ulët të probabilitetit të dështimit të kredive. Gjithashtu, projeksionet për rritjen e kreditimit ndikojnë që të hyrat neto nga interesi të kenë një efekt dominues në rritjen e kapitalit. Për më tepër, APR (asetet e peshuara me rrezik) nuk rriten në të njëjtën shkallë/magnitudë me rritjen e kreditimit, pasi që këto ekspozime (APRtë) zbriten për vlerën e provizioneve më të larta që ndahen si

rezultat i rritjes së probabilitetit të dështimit të kredive dhe të vlerësimeve për mbulim të humbjeve të pritura. Provizionet zbriten nga ekspozimet në llogaritjen e aseteve të peshuara me rrezik (APR), pasi që përfaqësojnë mbulimin e humbjeve të pritura që njihen dhe ndahen përmes pasqyrës së të ardhurave, ndërsa kapitali mbetet si kapacitet i lirë absorbues për të mbuluar vetëm humbjet e papritura e të pidentifikuara, që hipotetikiqisht mund të ndodhin

Skenarët e rënduar në kontekstin vendor ndjekin të njëjtën narrativë si skenarët e përdorur nga bankat në unionin evropian, i elaboruar më lart. Efektet e këtyre skenarëve reflektohen në vend përmes rënies së remitencave, të ndikuara nga dobësimi i aktivitetit ekonomik në eurozonë. Duke qenë se tregu është i ekspozuar ndaj zhvillimeve të jashtme, rritja e presioneve inflacioniste në eurozonë dhe për pasojë edhe rritja e normave të interesit do të ndikojnë në inflacion dhe normat e interesit në tregun vendor duke ndjekur të njëjtin drejtim me zhvillimet jashtë vendit. Niveli i papunësisë supozohet të rritet në skenarin e rënduar, për shkak të rënies së aktivitetit ekonomik, rënies së konsumit të brendshëm, perspektivës së dobët ekonomike dhe rënies së besueshmërisë në treg. Në skenarin e rënduar janë bërë supozime shumë konservative për kreditimin, duke mbajtur nivelin e pandryshuar, që do të thotë se supozohet të mos ketë rritje të kreditimit.

Rezultatet e stres-testit tregojnë se sistemi bankar ka një nivel të lartë qëndrueshmërie ndaj tronditjeve makroekonomike dhe financiare, edhe nën skenarin e rënduar. Kjo qëndrueshmëri mbështetet kryesisht në fitimet e realizuara dhe të mbajtura gjatë viteve, si dhe në nivelin e lartë të provizioneve të ndara, të cilat mundësojnë që disa banka të vazhdojnë të operojnë me fitim edhe në kushte të vështira. Përveç këtyre faktorëve, struktura e bilancit luan një rol kyç: pjesëmarrja e lartë e aseteve që gjenerojnë të ardhura interesi u jep bankave mundësinë të përfitojnë nga rritja e normave

të interesit. Si pasojë, rritja e normave të interesit përmirëson margjinën neto të të ardhurave për disa banka, duke zvogëluar ndjeshmërinë e kapitalit ndaj tronditjeve dhe duke forcuar stabilitetin e sektorit bankar.

Megjithatë, edhe pse shumica e bankave disponojnë nivel dhe cilësi të mjaftueshme kapitali për të përballuar humbjet e pritura, duke përfshirë kërkesat për shtesat makroprudenciale që pritet të hyjnë në fuqi nga qershori 2025²¹, në katër banka parashikohet nevoja për rikapitalizim për të mbuluar mungesën e kapitalit nën supozimet e skenarit të rënduar, ku janë bërë parashikime hipotetike të realizimit të profitit dhe akumulimit të kapitalit. Nga këto, dy banka do të kenë nevojë për rritje të kapitalit të klasit të parë (Tier 1). Totali i kapitalit të nevojshëm për të arritur kufirin minimal rregullator prej 15.5 përqind (duke përfshirë shtesat makroprudenciale të kapitalit) është 24.4 milionë euro, prej të cilave 11.9 milionë euro janë për kapital të klasit të parë. Në fund të periudhës projektuese, mungesa totale e kapitalit mund të arrijë në 49.9 milionë euro në skenarin e rënduar, që për qëllime të këtij ushtrimi është vlerësuar, megjithëse përfaqëson supozim pa ndonjë indikacion apo pritje që diçka e tillë të paraqitet.


Në situata krize, duke pasur parasysh natyrën e lirueshme (releasable) të shtesave makroprudenciale të kapitalit, lirimi i tyre do të reduktojë ndjeshëm presionin mbi bankat. Në këtë rast, vetëm dy banka do të përballen me vështirësi në përmbushjen e nivelit minimal rregullator prej 12 përqind të kapitalit. Mungesa e kapitalit të klasit të parë (Tier 1) do të ulet në 8.3 milionë euro në vitin 2025 dhe 33.1 milionë euro në vitin 2027, ndërsa mungesa e gjithsej kapitalit do të reduktohet në 11.7 milionë euro në vitin 2025 (nga 24.4 milionë euro në skenarin me shtesa) dhe 36.1 milionë euro në vitin 2027.

Në **skenarin e rënduar**, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit, do të zbrës lehtësisht për 1.0 pikë përqindje në 16.4 përqind për vitin 2025 nga niveli aktual i vitit

²¹ Shtesa neutral kundërciklike në 2.0% dhe O-SII në max 1.5%.

2024 prej 17.4 përqind. Në dy vitet pasuese, norma e kapitalit parashikohet të rritet gradualisht deri në 17.8 përqind, si rezultat i supozimit për përmirësimin e disa variablave makrofinanciare pas vitit 2025, duke ndikuar pozitivisht në reduktimin e humbjeve të pritura dhe në përmirësimin e të hyrave neto nga interesi për këtë periudhë.

Grafk 59. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit, sipas skenarëve



Burimi: BQK.

Kapitali bazë i klasit të parë (CET 1) në nivel sektori në skenarin e rënduar do të zbriste në 14.3 përqind dhe 15.7 përqind në fund të periudhës projektuese nga niveli aktual prej 15.4 përqind (grafik 59).



Burimi: BQK.

Në grafikët më poshtë 60A1 dhe 60A2 (skenari bazë dhe skenari i rënduar) janë paraqitur kategoritë kontribuese që ndikojnë në nivelin e kapitalit të bankave. Provizionet dhe shpenzimet administrative kanë ndikim negativ në kapitalin e projektuar për vitin 2025, ndërsa neto të hyrat nga interesi kanë efekt pozitiv, duke zbutur ndikimin negativ të parametrave tjerë. Në grafikun 61B janë paraqitur vlerat e kategorive kryesore të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit, për tre vitet projektuese.

Me nivel të lartë ndjeshmërie kanë rezultuar **raporti i kredive jo-performuese** që në


nivel sektori rezulton në 11.2 në vitin 2027 përqind nga niveli aktual prej 1.9 përqind. Ndërsa vlera kumulative e kredive jo-performuese për të gjithë sektorin do të rritej për gjashtë herë në 666,2 milionë euro nga 111.3 milionë në nivelin fillestar, në fund të periudhës projektuese. Në nivel të bankave raporti i kredive jo-performuese do të varionte në mes të intervalit më të ulët në fund të vitit 2027 prej 8.3 përqind deri në 43.6 përqind.



Burimi:

Përfundimisht, niveli fillestar i ulët i probabilitetit të dështimit të kredive në pothuajse të gjitha bankat, së bashku me pjesëmarrjen relativisht të lartë të aseteve me norma interesi më të larta krahasuar me detyrimet, ka ndikuar që – nën skenarët e ndërtuar makroekonomik dhe financiar – niveli i kapitalit të bankave të shfaqë ndjeshmëri të ulët.

Grafik 61B. Kategoritë kryesore të ndikimit në raportin e kapitalit, në vlera



Burimi: BQK.

Më konkretisht, humbjet e pritshme zbuten ose kompenzohen nga rritja e të ardhurave nga interesi, e nxitur nga koeficientët e reagimit të normave të projektuara të interesit sipas modeleve satelitore, duke mos ndikuar ndjeshëm në nivelin e kapitalit. Megjithëse vlera e kapitalit bie në skenarin e rënduar për 4.4 përqind në fund të vitit 2027, raporti i kapitalit rritet për shkak të rënies më të lartë të aseteve të peshuara me rrezik (RWA) për 6.6

përqind, të cilat do të ndikohen nga rritja e provizioneve për humbjet e pritura.

Stress Test për Rrezikun e Likuiditetit

Në raportin e kaluar të stabilitetit financiar u prezantua korniza e re e stres testit për rrezikun e likuiditetit, e bazuar në LCR si instrument me prespektive mikro- e makroprudenciale. U shqyrtua edhe konteksti historik i LCR dhe supozimet për peshat/marzhat reduktuese të pozicioneve të likuiditetit, të cilat për rastet hipotetike do të përdoren edhe për vitin 2024, në këtë raport.

Megjithëse niveli rregullator prej 100 përqind i LCR bazohet në përvojën e krizës globale, kriza bankare e marsit 2023 tregoi se ky nivel mund të jetë i pamjaftueshëm në kushtet e tërheqjeve masive, të përshpejtuara nga dixhitalizimi dhe përhapja e panikut përmes informacionit të menjëhershëm.

Kjo nënvizon kufizimet e mbështetjes vetëm në supozime historike dhe nevojën për të forcuar kapacitetin reagues të bankave. Rrjedhimisht, modeli i stres testit synon të vlerësojë ndjeshmërinë ndaj skenarëve ekstremë dhe të identifikojë mungesat potenciale të likuiditetit për qëllime të ndërhyrjeve dhe monitorimit të hershëm. Në vijim do të prezantohen: **skenari i parë bazë**, i konsideruar më realist, i bazuar në metodën parametric VaR si funksion i lëvizjeve ditore të depozitave. Pastaj skenari i rënies së vlerës së mjeteve likuide dhe skenari i tërheqjeve masive të depozitave në dy nivele të goditjeve: **rënduar dhe ekstreme**, i mbështetur edhe me një analizë sensitiviteti për vlerësimin e nevojës për asistencë nga fondi për likuiditet emergjent. Në fund **skenari i tretë fokusohet në tërheqjet e parakohshme** nga pesë depozituesit më të mëdhenj të secilës bankë (tabela 4).

1. Skenari bazë

Skenari bazë, si skenari më realist, simulon ndikimin vetëm në komponentën e daljeve (outflows), duke u bazuar në luhatjet ditore të depozitave të secilës bankë. Për këtë qëllim përdoret metoda Parametric VaR, e cila vlerëson rrezikun e tërheqjeve të depozitave si funksion i luhatshmërisë së tyre ditore.

Ndërsa, për komponentën e mjeteve likuide (liquid assets - liquidity buffer) dhe hyrjet (inflows), aplikohen të njëjtat peshat/marzha reduktuese që janë përdorur në llogaritjen e LCR-së nga vetë bankat.

Parametri Value at Risk (VaR) në këtë skenar përdoret për të vlerësuar ndryshimet në nivelin e depozitave (volatilitetin e tyre), brenda një periudhe kohore prej 30 ditësh dhe me një nivel besueshmërie prej 99 përqind (përkatësisht Z-score ≈ 2.33). Llogaritjet bazohen në të dhënat historike ditore të depozitave që nga viti 2020 dhe aplikohen në mënyrë individuale për secilën bankë, për të reflektuar specifikat dhe dallimet ndërmjet bankave.

$$\text{VaR}_{p,t} = \mu \cdot \delta t - Z_{\alpha} \cdot \sigma \cdot \sqrt{\delta t}$$

Ku:

- **VaR_{p,t}** është Value at Risk për periudhën δt , që tregon rëniet maksimale të pritshme të depozitave për një nivel besueshmërie të caktuar.
- **μ** (mu) është mesatarja e ndryshimeve (drift) ditore të depozitave.
- **δt** është periudha kohore për të cilën llogaritet VaR (në këtë rast 30 ditë).
- **Z_{α}** është vlera kritike nga shpërndarja normale standarde (normal distribution) për nivelin e besueshmërisë α (këtu për 99% konfidencë, $Z_{\alpha} \approx 2.33$).
- **σ** (sigma) është devijimi standard i ndryshimeve/rritjeve/rënive ditore, për të matur volatilitetin.
- **$\sqrt{\delta t}$** është rrënja katrore e periudhës kohore, duke rritur ose zvogëluar volatilitetin proporcionalisht me kohën, që do të thotë se devijimi standard i kthimeve (returns) gjatë disa ditëve nuk rritet në mënyrë lineare, por rritet sipas rrënjës katrore të kohës.

Parametric VaR është përzgjedhur krahas dy metodave tjera VaR - asaj historike dhe Monte Carlo, për shkak të thjeshtësisë dhe efikasitetit të saj në vlerësimin e rrezikut nga luhatjet e depozitave në periudha afatshkurtra. Kjo metodë bazohet në mesataren dhe devijimin standard të depozitave, duke llogaritur rëniet maksimale të pritshme me një probabilitet të caktuar, nën supozimin e shpërndarjes normale të luhatjeve dhe pa pasur nevojë për të dhëna historike komplekse.

Krahas këtij skenari bazë, janë zhvilluar edhe dy skenarë shtesë, të natyrës hipotetike, por që kanë bazë në përvoja reale të ndodhura në sisteme bankare të vendeve të tjera.

2. Skenari i rënduar dhe ekstrem

Skenarët e goditjeve në pozitën e likuiditetit bazohen në supozime për një krizë të mundshme gjeopolitike me efekt zinxhir në ekonominë dhe sektorin financiar të Kosovës, si dhe në rrezikun idiosinkratik të një banke që përhapet në sektorin bankar. Magnituda e këtij shoku supozohet të amplifikohet nga faktorë si niveli i ulët i sigurimit të depozitave dhe mekanizmat e kufizuar për ndihmë emergjente me likuiditet. Efektet e këtyre

skenarëve hipotetik janë ndarë në dy kategori rezultuese: rreziku i tregut dhe reputacional dhe dy nivele: i rënduar dhe ekstrem me peshë specifike (haircut) për pozicionet kryesore.

2.1) Rreziku i tregut: Rritja e normave të interesit ul vlerën e instrumenteve më likuide, si ato qeveritare, duke dobësuar vlerën e këtyre aseteve likuide të bankave dhe aftësinë për të përmbushur detyrimet afatshkurtra.

2.2) Rreziku reputacional: Tërheqjet masive të depozitave, të nxitura nga paniku, dobësojnë besimin në sektorin bankar dhe ushtrojnë presion mbi likuiditetin e bankave për t'u përballur me kërkesat e papritura.

Tabela 4. Skenarët dhe peshat (haircut) të përdorura në secilin skenar për kategoritë kryesore të TML - LCR

KATEGORITË KRYESORE TË TREGUESIT TË MBULIMIT ME LIKUIDITET (TML-LCR)	Standard weight	Skenari bazë kombinuar me VaR të luhatjeve ditore të depozitave (për outflows)	Skenari i rënduar	Skenari ekstrem	Skenari i tërheqjeve të parakohshme të pesë depozitorëve më të mëdhenjë	Peshat e aplikuar nga bankat
REZERVA E LIKUIDITETIT (LIQUIDITY BUFFER)	99.6%	98.5%	93.5%	87.4%	98.5%	98.5%
Aktivitet e qeverisë qendrore (Central government assets)	100%	100%	90%	80%	100%	100%
Aktivitet e qeverive rajonale (Regional government)	100%	100%	90%	80%	100%	100%
Aktivitet e njohura të qeverisë qendrore dhe bankave qendrore në monedha të brendshme dhe të huaja (Recognisable domestic and foreign currency central government and central bank assets)	100%	85%	90%	80%	85%	85%
RRJEDHA DALËSE (OUTFLOWS)	15.6%	13.1%	23.8%	32.1%	25.1%	15.5%
Depozitat e ekonomive familjare (Retail deposits)	8.7%	9.2%	16.7%	23.4%	8.6%	8.6%
depozita që i nënshtrohen rrjedhave më të larta dalëse (deposits subject to higher outflows)	16%	41%	18%	26%	15%	15%
depozita të qëndrueshme (stable deposits)	5%	9%	7%	12%	5%	5%
të tjera të ekonomive familjare (other retail deposits)	10%	8%	25%	35%	10%	10%
Depozita operacionale (Operational deposits)	15%	26%	21%	30%	25%	25%
të mbajtura për pastrim (clearing), kujdestari (custody), menaxhim parash ose shërbime të tjera të krahasueshme në kontekstin e një marrëveshjeje operacionale të vendosur (maintained for clearing, custody, cash management or other comparable services in the context of an established operational relationship)	25%	56%	35%	49%	25%	25%
Depozita jo-operacionale (Non-operational deposits)	29%	13%	32%	38%	52%	52%
nuk mbulohehen me skemën për mbrojtje të depozitave (not covered by DGS)	40%	23%	45%	60%	40%	40%
Produkte dhe shërbime të tjera (Other products and services)	17%	23%	32%	49%	17%	17%
RRJEDHA HYRËSE (INFLOWS)	77.7%	77.7%	67.3%	55.2%	77.7%	77.7%
rrjedhat hyrëse nga klientët jo-financiarë (përveç bankave qendrore) (monies due from non-financial customers (except for central banks))	54%	54.1%	47.2%	31.4%	54.1%	54%
rrjedhat hyrëse nga ekonomitë familjare (monies due from retail customers)	50%	50.0%	45.0%	30.0%	50.0%	50%
rrjedhat hyrëse nga korporatat jo-financiare (monies due from non-financial corporates)	50%	50.0%	40.0%	20.0%	50.0%	50%
rrjedhat hyrëse nga bankat qendrore dhe klientët financiarë (monies due from central banks and financial customers)	100%	99.6%	84.7%	69.7%	99.5%	100%
rrjedhat hyrëse nga klientët financiarë (monies due from financial customers)	100%	100.0%	85.0%	70.0%	100.0%	100%
marreveshjet kreditore pa një datë përfundimi të përcaktuar (loans with an undefined contractual end date)	20%	20.0%	10.0%	0.0%	20.0%	20%

Burimi: Model i simuluar/hipotetik i BQK.

Të dy situatat - rënia e vlerës së obligacioneve qeveritare dhe tërheqja e depozitave, bazohen në përvoja të vendeve tjera dhe aplikohen njëkohësisht për të goditur pozitën e likuide të bankave. Nuk parashihen burime alternative rifinancimi apo riinvestimi, duke reflektuar

pamundësinë për të zëvendësuar financimin që maturohet në kohë krize (Tabela 4). Më poshtë janë elaboruar komponentët e treguesit LCR të goditur sipas marzhave reduktuese specifike për secilën kategori.

2.1. Goditjet në shtesën e likuditetit (Liquidity Buffer) dhe të hyrave rrjedhëse (Inflows)

Skenari bazohet në udhëzimet e Autoritetit Bankar Evropian (EBA) mbi rënien e vlerës së kolateralit të letrave me vlerë të qeverisë, që ul rezervat e likuditetit dhe aftësinë e bankave për të përmbushur detyrimet. Duke pasur parasysh pjesëmarrjen e lartë të këtyre instrumenteve në rezervat likuide (mesatarisht 41.3 përqind, dhe deri në 90 përqind për disa banka), një haircut mbi to pritet të ketë ndikim domethënës në pozitën likuide të bankave.

Kombinimi i faktorëve me probabilitet të lartë ndodhjeje, si rritja e normave të interesit, rritja e primit të rrezikut të vendit dhe ngadalësimi ekonomik, mund të ndikojnë negativisht në vlerën e kolateralit në formë të letrave qeveritare për financime REPO.

Në këtë skenar janë ndërtuar dy nivele goditjesh:

Skenari i rënduar: Parashikon një haircut prej 10 përqind mbi obligacionet qeveritare me

cilësi të lartë, duke reflektuar kufizimet në përdorimin e tyre si kolateral në bankë qendrore. Ky skenar shoqërohet me reduktime të moderuara në rrjedhat hyrëse: 85 përqind nga klientët financiarë (nga 100 përqind), 18.3 përqind nga klientët jo-financiarë dhe 10 përqind nga marrëveshjet kreditore pa afat të përcaktuar.

Skenari ekstrem: Parashikon një haircut më të lartë prej 20 përqind, që ul nivelin e përgjithshëm të rezervave me cilësi të lartë nga 99.6 përqind në 87.4 përqind. Në këtë skenar, rrjedhat hyrëse nga klientët financiarë supozohen të realizohen në 70 përqind, ndërsa për klientët jo-financiarë (ekonomitë familjare/individët dhe korporatat), të hyrat reduktohen në 30 përqind dhe 20 përqind, përkatësisht.

Të gjitha pozicionet e tjera mbeten të pandryshuara dhe në përputhje me kufizimet rregullative të standardizuara të LCR (tabela 4).

Pozicionet	Vlerat e pozicioneve e fillestare	SKENARËT E MARZHAVE REDUKTUESE					VLERAT AKTUALE	REZULTATET				
		Peshat/marzhat e aplikuar nga bankat	1. Skenari bazë, VaR të luanshmërisë reale të depozitave	2.1. Skenari i rënduar	2.2. Skenari ekstreme	3. Skenari i tërheqjes së 5 depozitorëve më të mëdhenjë		Vlerat sipas marzhave/peshave rregullatore	1. Vlerat sipas skenarit bazë - VaR të luanshmërisë reale të depozitave	2.1. Vlerat sipas skenarit të rënduar	2.2. Vlerat sipas skenarit ekstreme	3. Vlerat sipas skenarit të tërheqjes së 5 depozitorëve më të mëdhenjë
REZERVA E LIKUIDITETIT	1,272,708	98.5%	98.5%	93.5%	87.4%	98.5%	1,253,595	1,268,176	1,253,595	1,190,458	1,112,740	1,253,595
RRJEDHA DALËSE (OUTFLOWS)	7,332,772	15.5%	13.1%	23.8%	32.1%	25.1%	1,139,307	1,140,831	961,620	1,741,700	2,351,469	1,839,094
RRJEDHA HYRËSE (INFLOWS)	743,983	77.7%	77.7%	67.3%	55.2%	77.7%	577,878	577,787	398,542	500,606	410,850	577,878
LCR Ratio							210.9%	225.2%	222.6%	95.9%	57.3%	99.4%
LCR weighted average ratio							227.3%	230.4%	573.7%	96.3%	57.8%	106.5%

Tabela 5. Skenaret dhe rezultatet përkatëse

Burimi: BQK.

2.2. Tërheqjet e depozitave (goditje në rrjedhën dalëse Outflows) - Rreziku reputacional²²

Kriza bankare e marsit 2023 dhe rasti i dështimit të bankës Credit Suisse, i shkaktuar nga tërheqja masive e depozitave dhe përshpejtuar nga përhapja e shpejtë e

²² Situaata "dash for cash²²" bazuar në eksperiencën e krizës bankare në Amerikë dhe Zvicërr në mars 2023

informacionit dhe dixhitalizimi, shërbeu si bazë për përcaktimin e peshave të rrjedhave dalëse në skenarin e shokut idiosinkratik në Kosovë.

Depozitat e ekonomive familjare, zakonisht më të qëndrueshme, vlerësohen me peshë më të lartë të tërheqjeve prej 7–12 përqind për shkak të mbulimit të ulët nga skema e sigurimit të depozitave. Për kategorinë “other retail deposits”, të cilat përbëjnë kategorinë kryesore të daljeve janë supozuar tërheqje 25 përqind në skenarin e rënduar dhe 35 përqind në atë ekstrem. Për pjesën e depozitave të ekonomive familjare që trajtohen nga korniza LCR si subjekt i tërheqjeve më të larta, është supozuar se do të ketë tërheqje në nivelin me interval prej 18-26 përqind për të dy skenarët, krahasuar me 15 përqind që bankat kanë përdorur në raportimin e tyre.

Në rastin e *depozitave të korporatave jo-financiare*, karakteri dinamik dhe më i luhatur i këtyre subjekteve i bën ato më të ndjeshme, dhe më reaguese ndaj tronditjeve, prandaj supozohen tërheqje në intervalin 21–38 përqind për të dy skenarët dhe për të dy kategoritë e depozitave: ato për qëllime operacionale dhe jo-operacionale, që përafrohet përvojës së tërheqjeve para krizës bankare të mars 2023 dhe ngjashëm me peshën sipas standardit rregullator.

3. Skenari i tërheqjeve të parakohshme të pesë depozitorëve më të mëdhenjë nga secila bankë

Skenari i tretë bazohet në supozimin e tërheqjes së parakohshme të pesë depozitorëve më të mëdhenjë të secilës bankë, duke goditur vetëm komponentën e daljeve (outflows).

Rezultatet sipas skenarëve të ushtrimit të qëndrueshmërisë - Stress Test për rrezikun e likuiditetit

Në skenarin e rënduar dhe ekstrem dhe të tërheqjes së depozitorëve më të mëdhenjë, analiza është e bazuar në skenarë hipotetik që matin se si do të reagojë sektori bankar përballë situatave të pafavorshme të rënies së likuiditetit. Prandaj, në këtë kontekst, skenarët dhe rezultatet e elaboruara përkatësisht për skenarin e dytë dhe të tretë të shpjeguar më lartë nuk duhet të kuptohen si parashikim apo situatë e pritur, por vetëm si një vlerësim/ushtim i reagimit të pozicionit të likuiditetit të bankave ndaj goditjeve negative në pozitëen e likuiditetit.

Peshat standarde (haircuts) të përcaktuara me rregullore udhëzojnë bankat për të stresuar/goditur pozicionet financiare, duke caktuar intervale brenda të cilave ato mund të operojnë, por pa devijime të theksuara nga peshat e aplikuara. Në përgjithësi, bankat kanë aplikuar peshat e referuara sipas standardeve, me variacione të vogla ndërmjet tyre. Rezervat e likuiditetit sipas këtyre peshave²³ janë 99.6 përqind, ndërsa bankat aplikojnë pesha pak më konservatore, në 98.5 përqind, kryesisht për shkak të disa bankave me ekspozime në instrumente të kategorizuara në grupin e likuiditetit të nivelit të dytë, vlerësuar 50 përqind likuide (niveli 2B) dhe 85 përqind (niveli 2A). Për sa i përket tërheqjeve të depozitave dhe të hyrave rrjedhëse, janë përdorur pothuajse të njëjtat pesha të rekomanduara. Niveli i përgjithshëm i tërheqjeve është 15.6 përqind, krahasuar me 15.5 përqind që sektori raporton. Për hyrjet, sektori ka aplikuar peshë 77.7 përqind që është në nivelin e njëjtë me atë të rekomanduar më kornizën LCR.

Treguesi i Mbulimit me Likuiditet (TML-LCR) sipas peshave standarde rezulton të jetë 225.2 përqind ndërsa bankat kanë raportuar LCR prej 210.9 përqind, për shkak të haircuts më të larta të përdorura në disa raste (Tabela 4 dhe 5).

Në **skenarin bazë**, ndikohet vetëm komponenta e daljeve (outflows), duke u


²³ Peshat standarde dhe peshat e aplikuara nga bankat janë përlogaritur në raport me peshën e bilanceve në periudhën raportuese dhjetor 2024, për kategoritë përkatëse.

bazuar në luhatjet ditore të depozitave të secilës bankë, përmes metodës parametric VaR. Bazuar në këtë metodë volatiliteti/luhatshmëria e depozitave rezulton më e lartë tek depozitat e personave juridik dhe niveli i përgjithshëm i daljeve rezulton 13.1 përqind – nivel jo shumë i ndryshëm nga marzha reduktuese prej 15.5 përqind e raportuar nga bankat në kuadër të LCR. Megjithatë, ekzistojnë dallime shumë të theksuara ndërmjet bankave, veçanërisht midis atyre që kanë rezultuar me nivel të lartë të luhatjeve ditore rrjedhimisht goditje më të larta dhe atyre që kanë qenë më konservatore në përcaktimin e peshave të daljeve outflows në raportimin e LCR, ndërsa realisht kanë luhatshmëri shumë të ulët depozitash e që rrjedhimisht do të rezultonin me raport shumë të lartë të LCR.

Raporti i mbulimit me likuiditet (LCR), në nivelin e mesatares së barazpeshuar për të gjithë sektorin, do të ishte 573.7 përqind. Siç u përmend në paragrafin paraprak, disa banka raportojnë në TML (LCR) vlera më të larta të daljeve (outflows) sesa tregojnë të dhënat historike për lëvizjet/daljet ditore të depozitave të tyre (tabela 4 dhe 5, grafik 62). Nëse këto nivele historike të daljeve ditore të depozitave (outflows) do të konsideroheshin në llogaritjen e TMLsë, atëherë niveli i TML do të rezultonte shumë më i lartë se ai që është raportuar aktualisht.

2.1. Në skenarin e rënduar, niveli i tërheqjeve për sektorin arriti në 23.8 përqind²⁴, ndërsa shkalla e realizimit të të hyrave për periudhën 30-ditore, sipas supozimeve në tabelën 4, rezultoi 67.3 përqind. Rezervat e likuiditeti rezultojnë me marzhë reduktuese 93.5 përqind. Si rrjedhojë, Treguesi i Mbulimit me Likuiditet (TML-LCR) zbrit në 96.3 përqind, nga niveli prej 210.9 përqind në dhjetor 2024, duke rënë nën kufirin rregullator prej 100 përqind (tabela 4 dhe 5, grafik 62).

Grafik 62. Treguesi i mbulimit me likuiditet LCR



Burimi: BQK.

2.2. Në skenarin ekstrem, rezervat e likuiditetit supozohen në nivelin 87.4 përqind, ndërsa tërheqjet arrijnë 32.1 përqind, si rezultat i aplikimit të peshave më rigorozë në grupet kryesore. Shkalla e realizimit të të hyrave llogaritet në 55.2 përqind. Si pasojë, Treguesi i Mbulimit me Likuiditet zbrit në 57.8 përqind (tabela 4 dhe 5, grafik 62).

2.3. Analiza e sensitivitetit për asistencën me likuiditet emergjent.

Për të vlerësuar kapacitetin absorbues të humbjeve përmes likuiditetit emergjent, është simuluar një analizë sensitiviteti, respektivisht analizë e pragut të zbritjes së rezervave dhe nevojave përkatëse për likuiditet, në raport me vlerën e asistencës me likuiditet emergjent (ELA). Nëqoftëse niveli i rezervës që do të mund të tërhiqej do të rritej duke përfshirë 4.0 përqind²⁵ të minimumit të rezervës së detyrueshme (2), në skenarin e rënduar mungesa e likuiditetit për të arritur nivelin rregullator do të zvogëlohej nga 111.8 milionë euro në 42.9 milionë euro. **Në skenarin ekstrem, nevojat për likuiditet do të ishin më të larta, duke tejkalluar fondin e ELA-së.**

3. Në skenarin e tërheqjes së pesë depozitorëve më të mëdhenjë në secilën bankë, niveli i tërheqjeve do të arrij në 25.1 përqind dhe raporti i mbulimit me likuiditet (LCR) do të zbriste në 106.5 përqind (tabela 4 dhe 5, grafik 62).

²⁴ në afersi me përvojën e Credit Suisse (21.0%).

²⁵ Njëra ndër kriteret për dhënie e Ndhmës Emergjente për Likuiditet është edhe ulja e reserves së detyrueshme, më konkretisht pika 1.3 e

nenit 4 që përcakton se “Ulja maksimale e rezervës minimale të një banke që mund të miratohet është katër pikë përqindje”

Kutia 4. Mekanizmi i Korrigjimit të Kufirit të Karbonit (ang. CBAM):

Ndikimet në Ekonominë e Kosovës dhe Stabilitetin e Sektorit Bankar


Mekanizmi i Rregullimit të Kufirit të Karbonit (Carbon Border Adjustment Mechanism – CBAM) paraqet dimension të ri të përfshirë në këtë Raport të Stabilitetit Financiar, në kuadër të analizës së implikimeve të ndryshimeve klimatike në sistemin financiar të vendit. Për Kosovën, një vend me ekonomi të vogël dhe të hapur ndaj BE-së, zbatimi i CBAM mbart ndikim të drejtpërdrejtë për ekonominë e vendit dhe të tërthortë për sistemin financiar, e vecanërisht sektorin bankar. Kjo kuti analitike synon të elaborojë konceptin e CBAM si një instrument rregullator, identifikojë sektorët më të prekur nga zbatimi i tij, vlerësojë rëndësinë për ekonominë vendore, si dhe, analizojë shkallën e ekspozimit të sektorit bankar ndaj aktiviteteve që do të preken përmes kreditimit.

të lartë të emetimeve, duke synuar barazi të trajtimit midis prodhuesve vendas dhe atyre të jashtëm. Për vendet jo-anëtare të BE-së dhe të Sistemit të Tregtimit të Emetimeve të BE-së (EU ETS)²⁷, kjo përkthehet në kosto shtesë për eksportet e sektorëve të prekur, me pasoja të mundshme për konkurrueshmërinë e tyre në tregun e BE-së dhe për strukturën ekonomike të vendeve eksportuese.

Mekanizmi CBAM aktualisht mbulon disa sektorë me intensitet të lartë të emetimeve, përfshirë hekurin dhe çelikun, aluminin, çimenton, plehrat kimike, hidrogjenin dhe energjinë elektrike. Gjithashtu, përfshin edhe emetimet indirekte që lidhen me përdorimin e energjisë elektrike në procesin e prodhimit, përveç rasteve kur mallrat përfitojnë nga kompensimi i kostove indirekte sipas Direktivës për Tregtimin e Emetimeve të BE-së (EU ETS).

Zbatimi i CBAM është parashikuar të zhvillohet në faza të njëpasnjëshme. Iniciativa është propozuar në vitin 2021 si pjesë e paketës legjislative “Fit for 55” dhe ka hyrë në fuqi në maj 2023 pas miratimit institucional nga BE-ja. Faza kalimtare ka nisur në tetor 2023 dhe do të zgjasë deri në fund të vitit 2025. Gjatë kësaj periudhe, subjektet përkatëse (importuesit dhe eksportuesit drejt BE-së) kanë detyrimin të raportojnë në baza tremujore emetimet e gazeve serrë të përfshira në mallrat e tyre, pa implikime financiare në këtë fazë. Nga janari i vitit 2026, CBAM do të hyjë në fazën përfundimtare të zbatimit, ku do të kërkohet që pagesat për emetimet e raportuara të realizohen përmes blerjes së

Diagram 1: Kronologji e zbatimit të CBAM



Nga perspektiva e BE-së, CBAM është një instrument qendror i Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane që synon të ruajë efektivitetin e politikave klimatike të BE-së dhe të parandalojë “rrjedhjen e karbonit” (ang. carbon leakage).²⁶ Ky mekanizëm vendos një çmim karboni mbi importet e mallrave me intensitet


²⁶ “Rrjedhja e karbonit” i referohet një situatë ku përpjekjet e një vendi ose rajoni për të reduktuar emetimet e gazeve serrë përmes politikave të rrepta klimatike rezultojnë në rritjen e emetimeve në një zonë tjetër që nuk ka politika të tilla. Kur një vend miraton politika ambicioze klimatike, industritë brenda atij vendi mund të përballen me kosto më të larta për shkak të çmimit të karbonit ose rregulloreve të tjera. Për të mbetur konkurruese dhe për të shmangur disavantazhet e kostos, disa industri mund të zhvendosen në rajone me politika klimatike më pak të rrepta, ku mund të operojnë me kosto më të ulëta të pajtueshmërisë. Kjo zhvendosje mund të çojë në rritjen e emetimeve në rajonet me rregullore më të dobëta, duke neutralizuar reduktimet e emetimeve të arritura nga vendi me politika klimatike ambicioze.

²⁷ EU ETS apo në gjuhën Shqipe ‘Sistemi i Tregtimit të Emetimeve të BE-së’ është tregu i pare i karbonit dhe ndër më të mëdhenjtë globalisht, i nisur në vitin 2005. I themeluar që ndotësit të paguajnë për emetimet e tyre, duke mbuluar rreth 40% të emetimeve të BE-së nga energjia, industria, aviacioni dhe që nga 2024 edhe transporti detar. Operon në BE dhe vendet e EEA. Ky sistem ka kontribuar në uljen e përgjithshme të emetimeve të BE-së, njëkohësisht duke gjeneruar të ardhura për financimin e tranzicionit të gjelbër.

çertifikatave CBAM. Këto pagesa do të përcaktohen në bazë të volumit të emetimeve të gazrave serrë të raportuara për mallrat përkatëse, tarifave të aplikuara në EU ETS, dhe politikat rregullative për emetimet në vendin e origjinës së mallrave. Periudha 2026–2034 është parashikuar të përdoret për një tranzicion të plotë, ku ‘Alokimi Falas’ i lejeve të karbonit brenda kuadrit të EU ETS (ang. Free Allocation within the EU ETS)²⁸ do të zëvendësohet gradualisht nga mekanizmi CBAM (Diagram 1).²⁹

Për Kosovën, e cila nuk është pjesë e EU ETS dhe nuk ka një mekanizëm të brendshëm të çmimit të karbonit, ky ndryshim rregullator pritet të ketë ndikim në tregtinë e jashtme dhe konkurrueshmërinë e ekonomisë së vendit. Kjo ndjeshmëri amplifikohet tutje nga profili i eksporteve të Kosovës, i cili mbetet në masë të madhe i orientuar drejt BE-së. Në vitin 2024, 34.0 përqind e eksporteve u drejtuan për në vendet e BE-së, me Gjermaninë dhe Austrinë si destinacione kryesore, duke reflektuar lidhjen tregtare me bllokun evropian dhe varësinë nga tregjet që tashmë janë të ndikuara drejtpërdrejt nga politikat për menaxhimin/reduktimin e emetimeve të karbonit (grafik 1).

Grafik 1. Struktura e eksporteve sipas vendeve, Dhjetor 2024



²⁸ Alokimi Falas brenda EU ETS është shpërndarja e lejeve të karbonit (lejeve për të emetuar) për industritë e caktuara pa kosto. Kjo politikë synon kryesisht të parandalojë “rrjedhjen e karbonit” duke mbrojtur konkurrueshmërinë e industrive të BE-së që janë në rrezik të zhvendosjes drejt rajoneve me rregullore klimatike më pak kërkuese.

²⁹ Në qershor 2025, Parlamenti Evropian dhe Presidenca e Këshillit të BE-së arritën një marrëveshje paraprake për paketën legjislative ‘Omnibus I’, që synon thjeshtësimin dhe forcimin e zbatimit të CBAM.

Struktura sektoriale e eksporteve nënvizion rrezikun e rritur nga ekspozimi në sektorët e prekur nga CBAM. Gjatë vitit 2024, dinamika e rritjes së eksporteve të mallrave u mbështetet kryesisht nga performanca e sektorit të metaleve bazë. Ky sektor përbën 20.3 përqind të eksporteve dhe ka arritur një vlerë prej 52.9 milionë euro³⁰. Njëkohësisht, kategoritë si ‘Artikuj prej guri, llaçi, qeramike dhe xhami’ dhe ‘Produktet minerale’, që përfshijnë prodhimin e çimentos, përfaqësuan 10.8 përqind të eksporteve me një vlerë prej 7.5 milionë euro.

Marrë parasysh se sektori i metaleve bazë dhe ai i prodhimit të çimentos karakterizohen nga intensiteti i lartë i emetimeve të karbonit, eksportet e Kosovës nga këto segmente mund të përballen me sfida shtesë tregtare dhe kosto më të larta në tregun e BE-së në kuadër të zbatimit të CBAM-it.

Në terma më të gjerë makroekonomikë, industria përpunuese - përfshirë prodhimin e metaleve bazë - mbetet ndër kontribuesit kryesorë në rritjen e BPV-së. Një përkeqësim i kushteve tregtare për këtë industri, si pasojë e tarifave të karbonit që rrisin kostot e prodhimit dhe ndikojnë negativisht në konkurrueshmërinë në tregjet e BE-së, mund të reflektohet në përkeqësim të bilancit tregtar, ulje të të ardhurave fiskale dhe vështirësi në tregun e punës.

Zbatimi i CBAM dhe rreziqet përkatëse ekonomike mund të krijojnë dinamika me ndikim në stabilitetin financiar. Rreziku i tranzicionit, që buron nga kostot shtesë të karbonit dhe sfidat në ruajtjen e konkurrueshmërisë nga ndërmarrjet eksportuese, mund të ndikojë në aftësinë e tyre për të përmbushur obligimet financiare. Në mungesë të një përshtatjeje të mjaftueshme,

Ndryshimet kryesore përfshijnë: përjashtimin e importeve të vogla (≤50 ton/vit), shtyrjen e pagesës së certifikatave deri në shkurt 2027, zgjatjen e afatit për deklarim deri më 31 gusht, uljen e detyrimit për mbajtjen e certifikatave nga 80% në 50%, përjashtimin/modifikimin e disa produkteve në llogaritjen e emetimeve. Kjo marrëveshje paraprake pritet të formalizohet në Shtator 2025.


³⁰ Për më shumë informata në lidhje me eksportet, mund të referoheni në raportin ‘Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë (TM4 2024)’

këto zhvillime mund të reflektohen në përkeqësim të cilësisë së portofolit kreditor, duke rritur nevojën për provizione dhe duke ushtruar presion mbi nivelin e kapitalit bankar. Për më tepër, një pjesë e konsiderueshme e këtyre kredive janë të mbuluara me kolaterale, asete që mund të pësojnë humbje vlere nëse aktivitetet industriale ngadalësohen ose bëhen jofitimprurëse, duke ndikuar kapacitetin absorbues të sektorit në rast të humbjeve nga këto ekspozime.

Në kuadër të përpjekjeve për të adresuar rreziqet që burojnë nga zbatimi i CBAM, BQK ka ndërmarrë një iniciativë për monitorimin e ekspozimeve të sektorit bankar ndaj ndërmarrjeve të përfshira në sektorët përkatës. Duke filluar nga tremujori i dytë i vitit 2024, bankat janë udhëzuar të raportojnë në baza tremujore të dhëna të detajuara lidhur me këto ekspozime. Kjo ka mundësuar ndërtimin e një pasqyre më të plotë mbi natyrën dhe përmasat e rrezikut potencial.

Të dhënat e mbledhura tregojnë se 38.9 përqind e ekspozimeve ndaj sektorëve të prekur nga CBAM i përkasin ndërmarrjeve eksportuese në tregun e BE-së. Megjithatë kjo përqindje paraqet një rënie të lehtë krahasuar me periudhat e mëparshme, ajo mbetet një tregues i rëndësishëm i varësisë së sektorit bankar nga performanca e aktiviteteve me intensitet të lartë të emetimeve të karbonit (Grafik 2).

Grafik 2. Ekspozimet në sektorët e CBAM



Nga ana tjetër, mbulimi me kolateral për këto ekspozime vlerësohet të jetë relativisht i lartë, me një raport prej 151.9 përqind, duke nënkuptuar se vlera e kolateraleve tejkalon vlerën e ekspozimeve përkatëse.

Në terma të përgjithshëm, ekspozimi i sektorit bankar ndaj sektorëve të prekur nga CBAM përfaqëson rreth 2.5 përqind të portofolit të përgjithshëm të kredisë, ose rreth 4.0 përqind të portofolit të kredisë për ndërmarrje. Ky nivel i ulët përqendrimi sugjeron një rrezik të kufizuar me natyrë sistemike për sektorin bankar në lidhje me ndikimet e CBAM.

Megjithatë, për të mundësuar një monitorim dhe vlerësim më të saktë të rreziqeve që burojnë nga politikat klimatike - përfshirë CBAM, nevojitet përmirësim i mëtejshëm i cilësisë së të dhënave dhe adresimi i hendeqeve ekzistuese të informacionit. Duke qenë se kjo fushë analize është ende në fazat e para të mbledhjes së informacionit dhe disponueshmëria e serive kohore është e kufizuar, BQK synon të intensifikojë përpjekjet për avancimin e mbledhjes dhe analizës së të dhënave përkatëse.


Tutje, integrimi i rreziqeve klimatike në kuadrot e menaxhimit të rrezikut nga sektori bankar është një hap i rëndësishëm për të forcuar qëndrueshmërinë financiare. Njëherazi, koordinimi ndër-institucional - ndërmjet sektorit privat, autoriteteve mbikëqyrëse dhe institucioneve publike - do të luante rol kyç në mbështetjen e një tranzicioni të qëndrueshëm dhe në zbutjen e ndikimeve potenciale ekonomike e sociale.

6. Institucionet financiare jo-bankare

6.1 Sektori Pensional

Sektori pensional shënoi rritje të përshpejtuar vjetore të aseteve prej 17.7 përqind nga 12.1 përqind një vit më parë, duke arritur vlerën totale prej 3.2 miliardë euro (Grafik 63).


Grafik 63. Asetet e sektorit pensional



Burimi: BQK.

Në vitin 2024, fondet pensionale përfituan nga zhvillimet pozitive në tregjet ndërkombëtare, me kthime të larta nga investimet që arritën në 248.4 milionë euro, krahasuar me 88.5 milionë euro një vit më parë.

Grafik 64. Performanca financiare e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës




Burimi: BQK.

Kjo performancë u mbështet nga përmirësimi i kushteve makroekonomike globale, politika më lehtësuese monetare, si dhe rritja e sektorit të teknologjisë, veçanërisht në fushën e inteligjencës artificiale. Njëkohësisht,

arkëtimet nga kontributet mbetën burim i qëndrueshëm i rritjes së aktiveve, me rritje vjetore prej 10.4 përqind, duke arritur në 316.5 milionë euro. Si rezultat, çmimi i njësishë së aksioneve u rrit nga 1.67 në 1.82 euro për FKPK-në dhe nga 1.96 në 2.15 euro për FSKP-në, duke reflektuar përmirësim në vlerën e kursimeve të kontribuuesve (Grafik 64 dhe 65).³¹

Grafik 65. Struktura e investimeve të sektorit pensional



Burimi: BQK.

Ekspozimi ndërkombëtar i Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës u zgjerua në vitin 2024, duke arritur në 2.5 miliardë euro apo 79.2 përqind të gjithsej portofolit, nga 74.5 përqind një vit më parë (Grafik 65). Pothuajse krejtësisht këto investimeve u përqëndruan në fonde të përbashkëta (99.9 përqind). Rritja e pjesëmarrjes në tregjet ndërkombëtare sjell përfitime nga aspekti i kthimeve afatgjata, por në të njëjtën kohë rritë ndjeshmërinë e sektorit pensional ndaj luhatshmërisë së tregjeve globale dhe rreziqeve gjeopolitike.


Brenda vendit, FKPK ka reduktuar dukshëm mbajtjen e mjeteve në para të gatshme dhe depozita në BQK (rënie vjetore prej me 45.2 dhe 92.8 përqind respektivisht), ndërsa është vërejtur rritje e investimeve në instrumente të borxhit të Qeverisë së Kosovës, përkatësisht në obligacione dhe certifikata depozite (11.4 përqind dhe me 68.8 përqind). Ky riorientim është nxitur nga kushtet e tregut, ku kërkesa e shtuar e sektorit bankar për likuiditet ka

³¹ Sektori dominohet nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK), që përfaqëson 99.7 përqind të aseteve, ndërsa Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP) përfaqëson 0.3 përqind.

krijuar mundësi për fondin pensional që të rrisë fuqinë negociuese për norma më të favorshme të kthimit në këto instrumente afatshkurtra, duke përmirësuar gjithashtu edhe efikasitetin e përdorimit të mjeteve të lira brenda sistemit financiar vendor.

Fondi Slloven i Kursimeve Pensionale (FSKP) vazhdoi të ketë një përbërje të portofolit të dominuar nga aksionet ndërkombëtare (96.7 përqind), ndërsa investimet vendore mbeten të fokusuara kryesisht në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës. Ritmi i rritjes vjetore të kontributeve të këtij fondi u ngadalësua në 0.7 përqind nga 9.6 përqind, dhe kontributet mbetën në nivel të ulët prej 0.67 milionë euro, me ndikim marginal në zhvillimet e sektorit financiar në vend (Grafik 66).

Grafik 66. Performanca financiare e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve



Burimi: BQK.

Në vitin 2025, pasiguritë në ekonominë globale mbeten të theksuara, me ndikim potencial në performancën e sektorit pensional për shkak të ekspozimit të lartë ndaj tregjeve ndërkombëtare. Tensionet tregtare, të nxitura nga masat tarifore të reja të shpallura nga administrata amerikane në prill 2025, kanë ndikuar në rënien e besimit të konsumatorëve dhe në ngadalësimin e aktivitetit ekonomik në disa ekonomi të zhvilluara. Megjithëse këto efekte vlerësohen të jenë kryesisht afatshkurtra, ato mund të kontribuojnë në rritjen e paqëndrueshmërisë së tregjeve financiare ndërkombëtare dhe, rrjedhimisht, në volatilitet të kthimeve të investimeve. Në këtë kontekst, është e rëndësishme që fondet


³² Struktura e aseteve dominohet nga sigurimet jo-jetë, me pjesëmarrjes 91.6 përqind, ndërkohë sigurimet 'jetë' përfaqësojnë pjesën prej 8.4 përqind të aseteve.

pensionale të vazhdojnë të jenë proaktiv në përshtatje të strategjisë së investimit dhe menaxhim rreziku, për të ruajtur stabilitetin afatgjatë dhe për të mbrojtur interesat e kontribuesve. Përballë këtyre zhvillimeve, struktura e portofolit të investimeve të FKPK-së, e ndarë sipas grupmoshave (konservativ, balancuar dhe standard), luan një rol të rëndësishëm mbrojtës ndaj luhatjeve afatshkurtra në tregje. Kontribuesit më të moshuar janë të alokuar në portofolin konservativ, i cili përmban përqindje më të lartë të investimeve me rrezik të ulët duke minimizuar ekspozimin ndaj rënieve të mundshme në tregjet e aksioneve. Kjo qasje e diferencuar sipas moshës rritë efektivitetin e menaxhimit të rrezikut dhe ruan stabilitetin afatgjatë të fondeve pensionale në kushte të pasigurta ekonomike.

6.2 Sektori i Sigurimeve

Përgjatë vitit 2024, sektori i sigurimeve vazhdoi zgjerimin, i mbështetur kryesisht nga rritja e primeve të segmentit jo-jetë.³² Kjo reflektoi në rritjen gradual të penetrimit të sigurimeve, me raportin e primeve të shkruara bruto ndaj BPV-së që u rrit në 1.64 nga 1.51 përqind dhe densitetin e sigurimeve – primet për kokë banori - në 104.9 euro nga 92.3 euro një vit më parë (Grafik 67).

Grafik 67. Indikatorët e zhvillimit të sektorit të sigurimeve




Burimi: BQK.

Tregu ruajti një strukturë të qëndrueshme konkurruese me ndryshime të vogla në

indikatorët e përqendrimit³³, dhe një shpërndarje relativisht të balancuar të pronësisë mes kapitalit vendor dhe atij të huaj (Grafik 68).

Grafik 68. Struktura e asetëve të sektorit të sigurimeve, sipas pronësisë (dhjetor 2024)




Burimi: BQK.

Asetet e sektorit shënuan rritje vjetore prej 10.0 përqind (grafik 75) dhe struktura e asetëve mbeti e përqendruar kryesisht në instrumente me rrezik të ulët dhe likuiditet të lartë, përkatësisht në depozita bankare dhe në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës.

Kjo përbërje pasqyron orientimin tradicional të sektorit drejt sigurimit të kthimeve të qëndrueshme për përballimin e detyrimeve afatshkurtra. Gjatë vitit 2024, depozitat bankare shënuan rritje prej 16.0 përqind, nxitur nga normat relativisht më të larta të interesit.

Grafik 69. Asetet e sektorit të sigurimeve




Burimi: BQK.

Edhe investimet në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës u rritën, megjithëse në një shkallë

më të moderuar prej 3.7 përqind, ndërsa, investimet në prona dhe asetet tjera shënuan rënie (Grafik 69).

Megjithëse struktura e përgjithshme e investimeve mbetet e përqendruar në instrumente me rrezik të ulët dhe likuiditet të lartë, vërehen dallime të vogla në mënyrën e alokimit të mjeteve ndërmjet kompanive me kapital vendor dhe atyre me kapital të huaj. Kompanitë vendore shfaqin prirje më të theksuar drejt mbajtjes së mjeteve në depozita bankare, në krahasim me kompanitë me kapital të huaj që kanë pjesëmarrje më të madhe të mjeteve në letra me vlerë.

Grafik 70. Struktura e asetëve ndaj totalit (dhjetor 2024)



Burimi: BQK.

Në anën e detyrimeve, struktura vazhdon të dominohet nga provizionet teknike, të cilat përfaqësojnë 66.7 përqind të gjithsej detyrimeve dhe kapitalit, pasuar nga kapitali i aksionarëve.

Provizionet teknike shënuan rritje vjetore prej 10.9 përqind, ndërsa kapitali i aksionarëve u rrit me 9.9 përqind, të dyja me ritme më të moderuara krahasuar me një vit më parë (Grafik 70).


Pavarësisht peshës së ulët të sektorit në sistemin financiar dhe ekspozimit direkt relativisht të kufizuar ndërmjet sektorëve financiar, prania e theksuar në instrumente të borxhit të sektorit publik (letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës) dhe në bankat komerciale nënkupton një ndjeshmëri të moderuar ndaj zhvillimeve në këta sektorë, duke krijuar një

³³ Indeksi Herfindahl për primet bruto të shkruara shënoi rritje modeste në 1000 pikë nga 992, ndërsa ai për asetet në 957 pikë nga

954. Indeksi CR5 tregoi ulje të lehtë për primet në 59.1 përqind nga 59.6 përqind, dhe rritje për asetet në 56.1 përqind nga 55.5 përqind.


kanal të mundshëm – ndonëse të kufizuar – të transmetimit të rrezikut.

Grafik 71. Detyrimet dhe kapitali i sektorit të sigurimeve (dhjetor 2024)



Primet e shkruara bruto të sektorit shënuan rritjen më të lartë vjetore në pesë vitet e fundit (Grafik 72)³⁴, e nxitur kryesisht nga rritja e lartë prej 33.1 përqind e numrit të policave të sigurimit jo-jetë.

Grafik 72. Primet bruto të arkëtuara




Segmenti i sigurimeve jo-jetë vazhdon të dominohet nga sigurimet e detyrueshme të autopërgjegjësive, të cilat përbëjnë 55.5 përqind të totalit të primeve bruto, megjithatë pjesëmarrja e tyre po zbutet gradualisht për shkak të rritjes së vazhdueshme të sigurimeve vullnetare (Grafik 73).

Sigurimet jetë gjithashtu shënuan rritje të përsheptuar vjetore, por mbetën një segment më i vogël me 4.5 përqind të totalit të primeve.


Ndërkohë, dëmet e paguara u rritën më ngadalë, me 5.3 përqind, si pasojë e bazës së lartë krahasuese të vitit paraprak që u ndikua nga pagesa e një dëmi vullnetarë me vlerë të lartë.

Grafik 73. Sigurimet e detyrueshme dhe vullnetare



Struktura e dëmeve reflekton përbërjen e primeve, me dominimin e dëmeve nga sigurimet detyruese MTPL (48.3 përqind) dhe një rritje graduale të pjesëmarrjes së kategorisë “aksident dhe shëndet”, në përputhje me ndërgjegjësimin më të lartë të konsumatorëve dhe zhvillim ekonomik.

Grafik 74. Primet e pranuar dhe dëmet e paguara



Rritja e të hyrave nga primet, e kombinuar me një ritëm më të moderuar të rritjes së dëmeve të paguara, çoi në uljen e raportit të dëmeve për 3.9 pikë përqindje krahasuar me vitin (Grafik 74). Me rënie u karakterizuar edhe raporti i kombinuar, i cili po shënon rënie graduale ndër vite duke sugjeruar për rritje të

³⁴ Përfashtuar vitin 2021 ku rritja ishte si rezultat i lirimit të masave ndaj COVID 19 dhe rritjes së tarifave të produktit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia.


efikasitetit të sektorit. Këto zhvillime mbështetën përmirësimin e pozitës financiare, me fitim neto prej 14.7 milionë euro (nga 11.0 milionë euro në vitin 2023), rritje të kapitalit dhe ulje të humbjeve të akumuluar në 34.7 milionë euro (nga 43.6 milionë në vitin 2020). Kthimi nga asetet dhe kapitali u përmirësuan në 4.03 përqind dhe 17.38 përqind, përkatësisht. Treguesit e përdorimit të kapitalit - raportit të primeve neto dhe bruto të shkruara ndaj kapitalit – mbetën në nivel të ngjashëm (PSHN në 1.87 dhe PShB në 2.26), brenda niveleve të pranueshme për tregje të vogla.³⁵

Pozicioni i likuiditetit u përmirësua lehtë, me rritje të raporteve të parasë ndaj rezervave teknike dhe detyrimeve totale, ndërsa treguesit e adekuatshmërisë së kapitalit shënuan rënie por në nivel të sektorit mbetën në përputhje me kërkesat ligjore për mbulueshmëri të rezervave teknike, fondit garantues dhe aftësisë paguese.

6.3. Sektori mikrofinanciar dhe financiar jo-bankar. Sektori i ndihmësve financiar.

Sektori mikrofinanciar dhe financiar jo-bankar vazhdoi zgjerimin e aktivitetit me ritëm të shpejtë.

Grafik 75. Asetet e sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK.

³⁵ Krahasuar me praktikat ndërkombëtare, një PSHN nën 3.0 zakonisht konsiderohet brenda kufijve të pranueshëm të rrezikut për siguresit që operojnë në tregje të vogla e me strukturë conservative.

³⁶ Nga nëntor 2023, dy institucione financiare janë riklasifikuar nga ndihmës financiar në ndërmjetës tjerë financiar (IMF dhe IFJB). Ky

Asetet e sektorit u rritën për 20.5 përqind (Grafik 75)³⁶, mbështetur kryesisht nga rritja e lartë e aktivitetit kreditues, ndërkohë që aktiviteti i lizingut shënoi ngadalësim të trendit të rritjes (Grafik 76).


Grafik 76. Struktura e asetëve të sektorit mikrofinanciar (dhjetor 2024)



Burimi: BQK.

Ky sektor vazhdon të mbështetet kryesisht në huamarrje nga burime të jashtme me pjesëmarrje mbi 60 përqind të burimeve të financimit. Kjo e bën sektorin veçanërisht të ekspozuar ndaj luhatjeve të normave të interesit globale dhe ngushtimit të kushteve financiare. Ndërsa financimi përmes kapitalit vetanak dhe huamarrjeve vendore – kryesisht nga sektori bankar – mbetet në nivele më të ulëta pavarësisht rritjes së lehtë gjatë periudhës raportuese.

Grafik 77. Kreditë e sektorëve ekonomik sipas maturitetit




Burimi: BQK.

riklasifikim ka ndikuar që të rrisë vlerën e asetëve në sektorin mikrofinanciar dhe financiar jo-bankar, konkretisht në zërin e bilancit me bankat tjera, dhe të afektojë pasqyrën e të hyrave, rritje të theksuar të të ardhurave nga shërbimet.


Në aspektin e pronësisë, 73.9 përqind e aseteve mbesin në pronësi të huaj, ndërsa në aspekt të koncentrimit, është shënuar një përmirësim i lehtë, me rënie të indeksit Herfindahl dhe ulje të pjesëmarrjes së aseteve të institucioneve më të mëdha në 53.3 përqind.

Grafik 78. Struktura e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve ekonomik (dhjetor 2024)



Kreditimi i ekonomisë nga sektori mikrofinanciar dhe financiar jo-bankar mbeti në shkallë të lartë prej 24.6 përqind, që ishte lehtësisht më i ulët se viti paraprak.


Grafik 79. Rritja e kredive të sektorit mikrofinanciar ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK.

Rritja është mbështetur si nga kreditimi për ekonomitë familjare – rritje vjetore prej 20.1 përqind, dhe pjesëmarrje që mban peshën dominuese në portofol me 58.9 përqind, ashtu edhe nga kreditimi për korporatat jofinanciare – rritje vjetore prej 28.6 përqind. Rritja ishte e shpërndarë në të gjithë sektorët ekonomikë me sektorin e tregtisë që kishte rritjen më të lartë gjatë kësaj periudhe (Grafik 79). Sektori i bujqësisë vazhdon të ketë pjesëmarrje të lartë kreditimi i cili mbështetet edhe nga skema e garancive për huadhënie nga FKGK (Grafik 79).


Grafik 80. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK.

Lizingjet ruajtën peshë të konsiderueshme në strukturën e aseteve, por ritmi i rritjes u ngadalësua dukshëm në 6.9 përqind nga 30.8 përqind në vitin paraprak. Ngadalësim u shënuar veçanërisht për korporatat jofinanciare që dominojnë pjesëmarrjen në kuadër të gjithsej lizingjeve (Grafik 80).

Grafik 81. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK.


Kushtet e financimit në sektorin mikrofinanciar dhe financiar jo bankar mbetën të ndikuara nga zhvillimet në tregjet ndërkombëtare, me norma të interesit relativisht të larta. Norma mesatare e interesit për kredi ndaj ekonomive familjare u rritë tutje gjatë vitit 2024 (Grafik 81).

Ndërkohë, normat e interesit për kreditë ndaj korporatave jofinanciare, veçanërisht në sektorin e bujqësisë dhe industrisë, shënuan rënie (Grafik 82).

Sektori mikrofinanciar dhe ai jobankar shënoi dyfishim të shkallës vjetore të rritjes së fitimit neto në 12.5 përqind, si rezultat i rritjes së të ardhurave nga

zgjjerimi i aktivitetit kreditues si dhe rritjes së normës së kreditimit.


Grafik 82. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK.

Megjithatë, rritja e lartë e shpenzimeve për interesa dhe provizione reflekton ndikimin e vazhdueshëm të kushteve të pafavorshme të financimit në tregjet ndërkombëtare dhe pritjeve potenciale për rritje të rrezikut kreditor (Grafik 83).

Grafik 83. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK.

Dyfishimi i provizioneve, ndonëse ndihmon në forcimin e qëndrueshmërisë, sinjalizon perceptim më të lartë të rrezikut, përkundër rënies së lehtë të nivelit të kredive joperformuese në 1.6 përqind. Sidoqoftë, mbulueshmëria e KJP-ve me provizione mbetet në nivel të lartë përkundër tendencës së lehtë rënëse, duke ofruar një masë mbrojtëse në rrethana të rritjes së pasigurive (Grafik 84).

Si rezultat i rritjes relative më të lartë të shpenzimeve krahasuar me të hyrat, raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave është përkeqësuar. Rrjedhimisht, indikatorët kryesorë të profitabilitetit si Kthimi mesatar

nga asetet (KMA) dhe kthimi mesatar nga kapitali (KMK) zbritën zbritën përkatësisht në 3.6 dhe 13.3 përqind.

Grafik 84. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditorë



Burimi: BQK.

Sektori i ndihmësve financiarë, i përbërë nga byrotë e këmbimit dhe agjencionet për transferim të parave (ATP), mbetet me ndikim të kufizuar në sistemin financiar, duke përfaqësuar vetëm 0.1 përqind të gjithsej aseteve në fund të vitit 2024. Megjithëse numri i institucioneve është i lartë, aktiviteti financiar i këtij sektori është modest dhe mbështetet kryesisht në kapitalin vetanak me pjesëmarrje prej më shumë se 65 përqind në gjithsej bilancin e gjendjes së sektorit. Në aspektin e performancës financiare, sektori shënoi përgjysmim të fitimit neto krahasuar me vitin paraprak, për shkak të rritjes më të shpejtë të shpenzimeve krahasuar me të hyrat. Rritja e kostove, sidomos në paga dhe shpenzime operative, ndikoi negativisht në performancën financiare, duke sinjalizuar presione mbi qëndrueshmërinë e sektorit sidomos marrë parasyshë digitalizimin e shërbimeve të pagesave dhe transfereve dhe rënies së kostos së shërbimeve të ofruara nga këto ishtitucione.

7. Infrastruktura financiare në Kosovë

7.1. Sistemi i pagesave

Gjatë vitit 2024, sistemi i pagesave ndërbankare në Kosovë ka vazhduar të funksionojë me një nivel të lartë të qëndrueshmërisë, sigurisë dhe efikasitetit, duke mbështetur funksionimin e pandërprerë të sektorit financiar dhe duke kontribuar në

stabilitetin sistematik. Rritja e aktivitetit në këtë sistem – me një rritje vjetore prej 9.5 përqind në numrin e transaksioneve dhe 16.3 përqind në vlerë, që arriti në 25.4 miliardë euro – dëshmon për përmirësim të infrastrukturës së pagesave dhe thellim të përfshirjes financiare (Tabela 6). Po ashtu, numri i llogarive bankare³⁷ u rrit për 4.2 përqind dhe arriti në 2.6 milionë.

Tabela 6. Pjesëmarrja e instrumenteve të pagesave në gjithsej transaksionet e SPN-së, në përqindje

Përshkrimi	Numri i gjithsej transaksioneve		Vlera e gjithsej transaksioneve	
	2023	2024	2023	2024
Të rregullta	14.8%	17.3%	12.6%	13.1%
Prioritare	3.3%	3.3%	44.2%	43.4%
Të rregullta - masive (pagesat nga tatimet, taksat, dogana, etj)	31.4%	30.5%	6.0%	5.6%
Prioritare - masive (pagat dhe pensionet nga qeveria)	46.5%	44.7%	8.7%	8.6%
Pagesat xhiro	3.8%	4.1%	7.8%	7.5%
Letrat me vlerë	0.0%	0.0%	2.7%	2.9%
Debitim direkt	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
Bankë-bankë	0.0%	0.0%	18.0%	18.9%
Te kthyera	0.2%	0.1%	0.1%	0.0%


Burimi: BQK.

Digjitalizimi i pagesave ka vazhduar ritmin e shpejtë të rritjes edhe gjatë vitit 2024, si në sektorin bankar ashtu edhe nëpërmjet institucioneve financiare jobankare (IFJB), duke reflektuar përparim të dukshëm në përfshirjen financiare dhe efikasitetin e sistemit të pagesave, por njëkohësisht duke shtuar rëndësinë e monitorimit të rreziqeve kibernetike dhe operacionale.

Përdorimi i instrumenteve digjitale u intensifikua më tej, i reflektuar në rritjen vjetore prej 21.0 përqind të llogarive të lidhura me e-banking, të cilat arritën në mbi 1 milion (Tabela 7). Po ashtu, numri i gjithsej kartelave shënoi rritje, në veçanti kartelat me funksion krediti u rritën për 8.2 përqind pas rënies një vit më parë. Pagesat në pikat e shitjes (POS) u rritën me 39.4 përqind në numër dhe 31.8 përqind në vlerë, ndërsa edhe transaksionet

përmes ATM-ve shënuan rritje të moderuar. Kjo tregon një orientim të theksuar drejt kanaleve digjitale dhe automatike për transaksionet financiare të përditshme, duke përkrahur formalizimin e mëtejshëm të ekonomisë.

Grafik 85. Numri dhe vlera e pagesave të parasë elektronike




Burimi: BQK.

Kontribut në rritjen e digjitalizimit kanë dhënë edhe IFJB-të e licencuara për emetim të parasë elektronike. Në fund të vitit 2024, këto

³⁷ Numri i gjithsej llogarive bankare përfshinë: numrin e llogarive rrjedhëse, të kursimit dhe të tjera në bankë.

institucione raportuan mbi 79 mijë llogari aktive të parasë elektronike, që përkon me rritje vjetore prej 75.9 përqind (Grafik 86). Këto institucione së bashku kanë kryer një volum prej 2.2 milionë pagesa me para elektronike, me një vlerë prej rreth 860 milionë euro (Grafik 85).

Grafik 86. Numri i llogarive të parave elektronike (E-money accounts)



Burimi: BQK.

Tabela 7. Rrjeti i sektorit bankar

Përshkrimi	2020	2021	2022	2023	2024
Numri i degëve bankare	50	43	49	50	56
Numri i nëndegëve bankare	149	145	141	152	160
Numri i ATM-ve	513	516	534	583	635
Numri i POS-ve	13,421	13,836	14,769	17,187	20,828
Numri i llogarive 'e-banking'	411,346	537,733	688,891	851,645	1,030,357


Burimi: BQK.

Zhvillimet në këtë segment jo vetëm rrisin përfshirjen dhe efikasitetin për përdoruesit, por nënkuptojnë edhe nevojën për mbikëqyrje të shtuar të rreziqeve të reja, sidomos në fushën e sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së të dhënave. Në këtë kuadër, rritja e investimeve në siguri kibernetike si dhe forcimi i kapaciteteve për menaxhimin e rrezikut operacional, paraqiten si kushte të domosdoshme për të siguruar që digjitalizimi të përkthehet në përfitim të qëndrueshëm për sistemin financiar.

8. Shtojca Statistikore


Shtojca 1. Harta e Stabilitetit Financiar - Dinamika e ndryshimit të rrezikut të treguesve dhe kontributi në rrezik nga komponentët përkatës

Figura 1. Ekonomia e jashtme




Burimi: BQK.

Figura 2. Ekonomia e brendshme




Burimi: BQK.

Figura 3. Ekonomitë familjare




Burimi: BQK.

Figura 4. Ndërmarrjet




Burimi: BQK.

Figura 5. Qeveria



Burimi: BQK.

Figura 6. Struktura e sektorit bankar



Burimi: BQK.

Figura 7. Kapitalizimi dhe profitabiliteti




Figura 8. Likuiditeti dhe financimi




Tabela 1. Indikatorët e qëndrueshmërisë financiare, në përqind

Sektori bankar	Grupi bazë i indikatorëve	Dhjetor 2020	Dhjetor 2021	Dhjetor 2022	Dhjetor 2023	Dhjetor 2024
Mjaftueshmëria e kapitalit	Kapitali rregullativ ndaj asetëve të peshuara ndaj riskut	16.5	16.1	15.5	16.5	17.4
	Kapitali i klasit të parë ndaj asetëve të peshuara ndaj riskut	14.7	14.4	13.5	14.6	15.5
	Kreditë jo-performuese neto ndaj kapitalit	4.6	3.4	3.4	3.2	3.3
Cilësia e asetëve	Kreditë joperformuese ndaj totalit të kredive	2.5	2.1	1.9	1.9	1.9
Shpërndarja sektoriale e kredive ndaj totalit të kredive	Korporatat tjera financiare	0.2	0.3	0.3	0.4	0.8
	Korporatat publike jofinanciare	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
	Korporatat tjera jofinanciare	63.3	62.3	62.1	60.2	58.8
	Ekonomitë familjare	36.4	37.4	37.6	39.2	40.2
	OJSHF	0.03	0.02	0.01	0.02	0.04
	Jo-rezidente	0.1	0.0	0.1	0.2	0.1
	Gjithsej	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0
Profitabiliteti	Kthimi në asete (KNA)	1.7	2.1	2.6	2.5	2.6
	Kthimi në kapital (KNK)	14.0	17.3	20.7	19.8	19.7
	Margjina e interesit ndaj të hyrave bruto	79.2	76.5	76.4	79.4	80.6
	Shpenzimet e jo-nteresit ndaj të hyrave bruto	46.1	45.4	43.8	44.0	45.7
Likuiditeti	Asetet likuide (bazë) ndaj totalit të asetëve	30.1	28.8	26.8	25.1	23.8
	Asetet likuide (baza e gjërë) ndaj totalit të asetëve	23.2	23.7	21.5	20.0	19.7
	Asetet likuide (bazë) ndaj detyrimeve afatshkurtëra	31.1	30.6	29.3	27.6	27.0
	Asetet likuide (baza e gjërë) ndaj detyrimeve afatshkurtëra	40.4	37.2	36.5	34.7	32.7
Senzitiviteti ndaj riskut të tregut	Pozicionet neto të hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit	3.5	1.5	1.8	0.6	0.4
Grupi i zgjeruar i indikatorëve						
	Kapitali ndaj asetëve	11.7	11.1	9.4	10.4	11.1
	Ekspozimi kreditor ndaj kapitalit	89.5	89.8	78.2	61.7	56.4
	Shpenzimet e personelit ndaj shpenzimeve nga jointerеси	43.3	43.2	44.4	44.3	43.0
	Dallimi në mes të normës së interesit për kredi dhe depozita	4.7	4.5	3.9	3.2	2.5
	Depozitat e klientëve ndaj totalit të kredive (jo ndërbankare)	133.9	130.9	127.9	124.8	119.0
	Detyrimet në valutë të huaj ndaj gjithsej të detyrimeve	4.2	4.3	3.0	3.3	3.4

Të dhënat nga janari 2022 janë në përputhje me metodologjinë e re të rekomanduar për FSI-të (Udhëzuesi FSI 2019).



Rruga Garibaldi, Nr.33, Prishtinë,
Republika e Kosovës
Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763
Web: www.bqk-kos.org